

LIGJI NR. 08/L-304

PËR BANKAT

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Mbështetur në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR BANKAT

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**NËNKAPITULLI I
DISPOZITAT HYRËSE**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj rregullon aktivitetin bankar dhe financiar të bankës në Republikën e Kosovës, në funksion të nxitjes dhe mbarëvajtjes së një sistemi të qëndrueshëm financiar duke siguruar një nivel të duhur të mbrojtjes së interesave të depozitorëve përmes rregullimit të:

- 1.1. kritereve për themelimin dhe licencimin e bankave;
- 1.2. veprimit, organizimit dhe menaxhimit të shëndoshë të bankave;
- 1.3. mbikëqyrjes prudenciale të bankave, dhe
- 1.4. rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit të bankave.

2. Ky ligj është në harmoni me aktet Acquis të Bashkimit Evropian si në vijim:

- 2.1. Rregullorja mbi kërkesat prudenciale për institucionet kreditore dhe shoqëritë investuese (Rregullore 575/2013/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Rregulloren 648/2012/EU);
- 2.2. Direktiva për qasje në veprimtarinë e institucionit kreditor dhe mbikëqyrja prudenciale e institucionit kreditor dhe shoqërisë investuese (Direktiva 2013/36/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Direktivën 2002/87/EC, dhe duke shfuqizuar Direktivën 2006/48/EC dhe 2006/49/EC);
- 2.3. Direktiva për themelimin e kornizës së rimëkëmbjes dhe përmbylljes së institucioneve kreditore dhe shoqërive investuese (Direktiva 2014/59/EU, duke

ndryshuar dhe plotësuar Direktivën 82/891/EEC, 2001/24/EC, 2002/47/EC, 2004/25/EC, 2005/56/EC, 2007/36/EC, 2011/35/EU, 2012/30/EU dhe 2013/36/EU, si dhe Rregulloren 1093/2010/EU dhe 648/2012/EU.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky ligj zbatohet për të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, aksionarët e tyre, bordin e drejtorëve, menaxherët e lartë, punonjësit, agjentët dhe filialet e tyre, si dhe zbatohet për aspektet e kontabilitetit dhe sistemit të raportimit financiar të bankave, përfshirë kërkesat e auditimit.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. Filial – një subjekt i varur i bankës, personi juridik i së cilës bankë është subjekt i varur ose person juridik që është nën kontroll të përbashkët me këtë bankë;

1.2. Instrumenti i ndarjes së aseteve – mekanizmi për të kryer transferimin e aseteve, të drejtave ose detyrimeve të një banke në kuadër të përmbylljes tek një person juridik për menaxhimin e pasurisë në pajtueshmëri me nenin 110 të këtij Ligji;

1.3. Shërbimet financiare ndihmëse – kanë kuptimin sikurse janë përkufizuar në nenin 11 të këtij Ligji;

1.4. Instrumenti i rikapitalizimit nga brenda – mekanizmi për ushtrimin e kompetencës (fuqisë) për të zvogëluar vlerën apo për të konvertuar detyrimet e bankës në kuadër të përmbylljes në pajtueshmëri me nenin 111 të këtij Ligji;

1.5. Bankë – një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur ose degë të bankës së huaj;

1.6. Agjent bankar – nënkupton një person fizik apo juridik që vepron në emër të një banke në kryerjen e shërbimeve sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;

1.7. Veprimtari bankare dhe financiare – një veprimtari e identifikuar si veprimtari bankare dhe financiare në nenin 11 të këtij Ligji;

1.8. Person i ndërlidhur me bankën - çdo person që ka së paku njërin nga marrëdhëniet e mëposhtme me bankën:

1.8.1. çdo menaxher i lartë ose drejtor i bankës dhe çdo aksionar kryesor i bankës;

1.8.2. çdo person që është i afërt me menaxherin e lartë ose drejtorin apo me aksionarin kryesor të bankës deri në shkallën e përcaktuar me nën-paragrafin 1.54. të këtij neni;

1.8.3. çdo person juridik në të cilin menaxheri i lartë ose drejtori apo aksionari kryesor i bankës është po ashtu aksionar kryesor;

1.8.4. çdo person që ka interes të konsiderueshëm në personin juridik ku banka po ashtu ka interes të konsiderueshëm;

1.8.5. çdo filial i bankës, dhe

1.8.6. çdo person tjetër, që përcaktohet me rregullore nga BQK-ja për të qenë person i ndërlidhur me bankën.

1.9. Transaksionet e personit të ndërlidhur me bankën – përfshijnë ekspozimet kreditore dhe kërkesat bilancore dhe jashtëbilancore, si dhe marrëveshjet të tilla si kontratat për shërbime, blerjet dhe shitjet e aseteve, kontratat e ndërtimit, marrëveshjet e lizingut, transaksionet derivative, huazimet dhe shlyerjet nga bilanci. Termi transaksion duhet të interpretohet gjerësisht për të përfshirë jo vetëm transaksionet që janë të realizuara me personin e ndërlidhur, por gjithashtu edhe situatat në të cilat një person jo i ndërlidhur (ndaj të cilit banka aktualisht është e ekspozuar) më pastaj bëhet person i ndërlidhur;

1.10. Banka në proces të përmbylljes– një bankë në të cilën është ndërmarrë procesi i përmbylljes;

1.11. Grup bankar – një bankë dhe filialet e saja dhe çdo subjekt tjetër të cilat BQK-ja i përcakton me rregullore apo urdhëresë se duhet të merren parasysh për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar;

1.12. Degë - një vend i veprimtarive afariste i cili formon një degë ligjërish të varur të bankës e pa themeluar me vete, përmes së cilës banka mund të lejohet që të angazhohet në veprimtari bankare;

1.13. Institucion urë – një person juridik që i plotëson kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3. të nenit 109 të këtij Ligji;

1.14. Instrumenti i institucionit urë – mekanizmi për transferimin e aksioneve ose instrumenteve tjera të pronësisë të emetuara nga një bankë në kuadër të procesit të përmbylljes; ose pasurive, të drejtave ose detyrimeve të një banke në kuadër të procesit të përmbylljes tek një institucion urë, në pajtueshmëri me nenin 109 të këtij Ligji;

1.15. Instrumente borxhi - obligacionet dhe format tjera të borxhit të transferueshëm, instrumente që krijojnë apo pranojnë një borxh dhe instrumentet që japin të drejta për të përvetësuar instrumente borxhi;

1.16. Detyrimet e garantuara - detyrimet ku e drejta e kreditorit në pagesë apo një formë tjetër e performancës sigurohet nga një pagesë, garanci apo peng mbajtje, apo marrëveshje kolaterale duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga riblerja e transaksioneve dhe marrëveshjet e tjera kolaterale të transferimit të titullit;

1.17. Veprimtari bankare - veprimtaria e pranimit të depozitave nga publiku dhe përdorimi i fondeve qoftë tërësisht apo pjesërisht me qëllim të dhënies së kredive;

1.18. Shpërndarje e kapitalit - shpërndarja e parave të gatshme ose pasurive tjera nga një bankë për aksionarët e saj dhe në llogari të asaj pronësie, që përbëhet vetëm nga aksionet e bankës apo të drejtat për të blerë këto aksione por duke mos përfshirë dividendën;

1.19. Kushtet për realizimin e përmbylljes – kushtet që i referohen nenit 106 të këtij Ligji;

1.20. Kontroll - raporti kur një person apo grup personash, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi:

1.20.1. posedojnë shumicën e aksioneve të personit juridik;

1.20.2. kanë kompetencë për të caktuar apo larguar shumicën e bordit të drejtorëve të personit juridik, apo

1.20.3. Kanë mundësi për të ushtruar ndikim të konsiderueshëm në menaxhimin apo politikat e personit juridik.

1.21. Linjat kryesore të biznesit – nënkupton linjat biznesore dhe shërbimet shoqëruese që përfaqësojnë burime materiale të të hyrave, fitimit ose vlerës së franshizës për një bankë ose për një grup bankar të cilës i takon banka;

1.22. Funksionet kritike – veprimtaritë, shërbimet ose operacionet, ndërprerja e të cilave mund të rezultojë në ndërprerjen e shërbimeve thelbësore për ekonominë reale ose të çrregullojë stabilitetin financiar për shkak të madhësisë, pjesëmarrjes në treg, ndërlidhshmërisë së jashtme dhe të brendshme, kompleksitetit ose veprimtarive jashtë vendit (ndërkufitare) të një banke ose grupi bankar duke pasur parasysh veçanërisht zëvendësueshmërinë e këtyre veprimtarive, shërbimeve ose operacioneve;

1.23. Rreziku i vendit – është rreziku që kushtet dhe ngjarjet ekonomike, sociale dhe politike të një vendi të huaj që mund të ndikojnë në gjendjen financiare aktuale ose të parashikuar, apo në qëndrueshmërinë e një banke;

1.24. Depozitë - shumë e parasë që i paguhet një banke nga një person fizik ose juridik, me kusht që të kthehet në tërësi nga banka, me ose pa interes apo prim, qoftë me kërkesë ose në kohën e dakorduar me atë person fizik ose juridik;

1.25. Drejtor - person i emëruar nga aksionarët për të shërbyer si anëtar i bordit të drejtorëve të bankës dhe i miratuar nga BQK;

1.26. Masat e ndërhyrjes së hershme – masat e miratuara nga BQK në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës, në zbatim të nenit 88 të këtij Ligji;

1.27. Detyrimet e pranueshme – detyrimet dhe instrumentet e kapitalit që nuk kualifikohen si kapital rregullator i një banke, dhe që nuk janë të përjashtuara nga fushëveprimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda sikurse përcaktohet me rregullore përkatëse të BQK-së;

1.28. Mbështetja emergjente për likuiditet (“MEL”) – nënkupton mbështetjen për likuiditet nga BQK të ofruar ndaj një banke me anë të një reduktimi të përkohshëm të rezervave minimale, ose me një kredi ndaj një banke të licencuar nga BQK-ja, ose një kombinim i të dyjave kur banka është solvente, por që nevojitet MEL për të plotësuar nevojat për likuiditet afatshkurtër;

1.29. Interes në kapital – çdo e drejtë e pronësisë në personin juridik;

1.30. Ekspozim – çdo aset (pasuri) ose zë jashtëbilancor;

1.31. Mbështetja e jashtëzakonshme financiare publike – nënkupton mbështetjen financiare publike në nivel kombëtar ose më gjerë, me qëllim të ruajtjes apo kthimit të qëndrueshmërisë, likuiditetit apo solvencës (aftësisë paguese) të bankës apo e një grupi bankar;

1.32. Institucione financiare – ka kuptimin e dhënë me Ligjin mbi BQK-në;

1.33. Veprimtari financiare – një veprimtari e identifikuar si veprimtari bankare dhe financiare në nenin 11 të këtij Ligji;

1.34. Degë e bankës së huaj – një person juridik i inkorporuar në vend të huaj dhe posedon licencë për t’u angazhuar në veprimtarinë bankare në një juridiksion të huaj, dhe është e regjistruar dhe licencuar si degë sipas ligjit për të operuar në Republikën e Kosovës me veprimtari bankare dhe financiare;

1.35. Mbikëqyrës nga vendi amë – autoriteti kompetent rregullator në juridiksionin e huaj në të cilin është e inkorporuar banka mëmë e bankës ose e degës;

1.36. Josolvencë bankare (paaftësi paguese) - situata kur banka nuk është duke i paguar detyrimet, ose vlera e detyrimeve tejkalon vlerën e aseteve (pasurive) të saj. Vlera e aseteve, detyrimeve dhe kapitalit rregullator të bankës përcaktohet në përputhje me standardet e vlerësimit dhe procedurat e përcaktuara nga BQK-ja. Në përcaktimin e vlerës së aseteve dhe detyrimeve të bankës për një datë të ardhshme, merren parasysh të hyrat dhe shpenzimet e ardhshme të bankës të parapara në mënyrë të arsyeshme deri në atë datë;

1.37. Instrumente të pronësisë – nënkupton aksione, instrumente tjera që transferojnë pronësinë, instrumente që janë të konvertueshme në aksione apo instrumente tjera të pronësisë, apo japin të drejta për t'i blerë, dhe instrumente që përfaqësojnë interesa në aksione ose instrumente tjera të pronësisë;

1.38. Grup i personave/klientëve të ndërlidhur - ka njërin nga këto kuptime:

1.38.1. dy ose më shumë persona fizikë ose juridik që nëse nuk përcaktohet ndryshe, përbëjnë një rrezik të vetëm për shkak se njëri prej tyre në mënyrë direkte ose indirekte ka kontroll mbi tjetrin ose të tjerët;

1.38.2. dy ose më shumë persona fizik ose juridik ndërmjet të cilëve nuk ka marrëdhënie kontrolli siç përshkruhet në nën nën-paragrafin 1.38.1., të këtij neni por që duhet të konsiderohen se përbëjnë një rrezik të vetëm për shkak se janë aq të ndërlidhur që, nëse njëri prej tyre do të kishte probleme financiare, në veçanti vështirësi të financimit ose të ripagimit, tjetri ose të gjithë të tjerët gjithashtu do të mund të hasin vështirësi financiare ose të ripagimit;

1.38.3. pavarësisht nga nën nën-paragrafët 1.38.1 dhe 1.38.2. i këtij neni, kur një qeveri e nivelit qendror ka kontroll të drejtpërdrejtë ose është e ndërlidhur drejtpërdrejtë me një ose më shumë persona fizik ose juridik, grupi i përbërë nga qeveria e nivelit qendror dhe të gjithë personat fizik ose juridik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kontrolluar nga ai në përputhje me nën nën-paragrafin 1.38.1. të këtij neni, ose të ndërlidhura me të në përputhje me nën nën-paragrafin 1.38.2. të këtij neni, mund të konsiderohen se nuk përbën një grup klientësh të ndërlidhur. Në vend të kësaj, ekzistenca e një grupi të klientëve të ndërlidhur, të formuar nga qeveria e nivelit qendror dhe personat e tjerë fizikë ose juridikë, mund të vlerësohen ndaras për secilin prej personave direkt të kontrolluar prej saj në përputhje me nën nën-paragrafin 1.38.1. të këtij neni, ose të ndërlidhur direkt me të në përputhje me nën nën-paragrafin 1.38.2. të këtij neni dhe të gjithë personave fizikë dhe juridikë të cilët kontrollohen nga ai person sipas nën nën-paragrafit 1.38.1. të këtij neni ose të ndërlidhur me atë person në përputhje me nën nën-paragrafin 1.38.2. të këtij neni, duke përfshirë qeverinë e nivelit qendror. E njëjta vlenë edhe për rastet e qeverive të nivelit rajonal ose lokal;

1.39. Ekspozim i madh - çdo ekspozim ndaj një personi të vetëm apo grupi të personave të ndërlidhur që tejkalon përqindjen e kapitalit të klasës së parë të specifikuar nga BQK-ja në nenin 24 të këtij ligji;

1.40. Person juridik - term i përgjithshëm që nënkupton çdo organizatë, duke përfshirë edhe një shoqëri tregtare që ka sipas ligjit identitet juridik të ndarë dhe dallon nga anëtarët, pronarët a aksionarët e saj;

1.41. Licencë – autorizim diskrecional i lëshuar nga BQK-ja për dhënien e të drejtës për t'u marrë me veprimtaritë e specifikuara sipas autorizimit;

1.42. Fondi kombëtar i përmbylljes – marrëveshja e financimit e cila vendoset sipas nenit 124 të këtij ligji për qëllim të sigurimit të zbatimit efektiv nga BQK të instrumenteve të përmbylljes dhe kompetencave të dhëna në Kapitullin III të këtij Ligji;

1.43. Procedurat e rregullta të likuidimit – regjimi i likuidimit sipas Kapitullit III të këtij ligji, apo ndonjë procedurë kolektive e likuidimit që përfshinë shkarkimin e pjesshëm ose të plotë të menaxhmentit të bankës dhe emërimin e një likuidatori apo një administratori normalisht të zbatueshëm për bankat ose personat juridikë në përgjithësi, duke përfshirë regjimin e likuidimit të përcaktuar në Kapitullin III të këtij ligji;

1.44. Urdhëresë – urdhër me shkrim që nxirret nga BQK-ja për zbatimin e këtij ligji apo të një rregulloreje të miratuar nga BQK-ja;

1.45. Kapital rregullator – nënkupton kapitalin rregullator të bankës sipas përcaktimit të BQK-së, për qëllim të nenit 21 të këtij ligji;

1.46. Kapital i paguar - fondet e pranuar nga banka nga aksionarët në shkëmbim të interesit të tyre në kapital;

1.47. Banka mëmë – një bankë që zotëron ose kontrollon në ndonjë formë bankat tjera brenda grupit bankar dhe që nuk është e kontrolluar nga një person tjetër juridik. Kjo përfshin bankën kryesore në krye të grupit bankar ose bankën më të lartë ndërmjetësuese që është subjekt i mbikëqyrjes prudenciale;

1.48. Person – i referohet personit fizik ose juridik;

1.49. Aksionar kryesor - personi që posedon në mënyrë direkte apo indirekte, së bashku ose në bashkëveprim me persona tjerë, dhjetë për qind (10%) ose më tepër të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote të një banke ose shoqërie apo dhjetë për qind të interesit në kapital në një bankë ose shoqëri;

1.50. Pranuesi – personi ose entiteti të cilit i transferohen aksionet, instrumentet e tjera të pronësisë, instrumentet e borxhit, asetet (pasuritë), të drejtat apo detyrimet, apo çdo kombinim i këtyre zërave nga një bankë që është në kuadër të procesit të përmbylljes;

1.51. Plani i rimëkëmbjes – një plan i rimëkëmbjes i hartuar dhe i përditësuar nga një bankë në pajtueshmëri me nenin 87 të këtij ligji;

1.52. Rregullore - akt nënligjor i nxjerrë nga BQK-ja për zbatimin e këtij ligji ose ligjeve tjera përkatëse;

1.53. Ministria - ministria përgjegjëse për financa;

1.54. Individë të ndërlidhur – bashkëshorti/ja , fëmijët ose të birësuarit, fëmijët e fëmijëve, nëna, babai, vëllezërit, motrat, personat në kujdestarinë e tij apo persona të tjerë që përcaktohen nga BQK me rregullore te veçantë;

1.55. Instrumente të ndërlidhura të kapitalit – nënkupton instrumentet e kapitalit shtesë të klasës së parë, instrumentet e kapitalit të klasës së dytë dhe instrumente tjera shtesë të kapitalit që përcaktohen me rregullore të BQK-së;

1.56. Zyrë përfaqësuese - veprimtari afariste e licencuar nga BQK, si një degë ligjërishit e varur e bankës e pa themeluar në vetvete, me veprimtari të kufizuar në ofrimin e informatave dhe veprimtarive të ndërlidhjes si dhe studimit të tregjeve dhe mundësive të investimit, ku dhe nuk lejohet angazhimi në veprimtari bankare;

1.57. Përmbyllje– zbatimi i instrumentit përmbyllës i referuar në paragrafin 2. të nenit 107 të këtij ligji në mënyrë që të arrihen një ose më shumë objektiva të përmbylljes të referuar në nenin 100 të këtij ligji;

1.58. Veprim përmbyllës – vendimi për ta vendosur një bankë nën procesin e përmbylljes, sipas nenit 106 të këtij ligji, zbatimi i instrumentit përmbyllës apo ushtrimi i një apo më shumë kompetencave përmbyllëse;

1.59. Objektivat e përmbylljes – objektivat sipas nenit 100 të këtij ligji;

1.60. Plan i përmbylljes – një plan i përmbylljes për një bankë, i hartuar në përputhje me nenin 104 të këtij ligji;

1.61. Kompetenca e përmbylljes – një kompetencë sipas nenit 121 të këtij ligji;

1.62. Instrument i përmbylljes – një instrument i përmbylljes sipas paragrafit 2. të nenit 107 të këtij ligji;

1.63. Menaxhim i rrezikut – nënkupton procesin dhe metodat për t'i identifikuar, matur, vlerësuar, mbajtur dhe monitoruar rreziqet, duke përfshirë raportimin e rreziqeve ndaj të cilave banka është e ekspozuar ose mund të jetë e ekspozuar gjatë veprimit të saj afarist;

1.64. Instrument i shitjes së veprimtarive tregtare – mekanizmi i BQK-së për inicimin e transferimit të aksioneve ose instrumenteve tjera të pronësisë të emetuara nga banka nën procesin e përmbylljes, ose transferimin e asetëve (pasuritë), të drejtat dhe detyrimet e bankës nën procesin e përmbylljes tek një blerës që nuk është institucion urë, në përputhje me nenin 108 të këtij ligji;

1.65. Kundërpalë qendrore - nënkupton personat juridikë që ndërhyjnë ndërmjet palëve në kontratat e tregtuara në një ose më shumë tregje financiare, duke u bërë blerësi për çdo shitës dhe shitësi për çdo blerës, ndaj të cilës nuk mund të aplikohet pezullimi në pagesë;

1.66. Menaxher i Lartë - kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor për financa, zyrtari kryesor i operacioneve, zyrtari kryesor për risk dhe çdo person përveç drejtorit, i cili (i) i raporton drejtpërsëdrejti bordit ose merr pjesë ose ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të bankës, pavarësisht nëse ai person ka titull zyrtar apo merr kompensim për veprimet e tilla, dhe (ii) është miratuar si menaxher i lartë nga BQK-ja. Në rastin kur një bankë e huaj licençohet për të operuar me një ose më shumë degë në Republikën e Kosovës, menaxheri i degës kryesore në Kosovë dhe çdo menaxher tjetër apo zëvendësmenaxher i një dege në Kosovë do të konsiderohet të jetë anëtar i menaxhmentit të lartë;

1.67. Interes i pronësisë – nënkupton të drejtat në kapitalin e personave të tjerë juridikë, pavarësisht nëse janë apo nuk janë të përfaqësuara me certifikata, të cilat të drejta duke krijuar lidhje të qëndrueshme me këta persona juridikë, synojnë të kontribuojnë në veprimtaritë e bankës dhe klasifikohen si në vijim:

1.67.1. interes i kualifikuar ekziston kur një person ka:

1.67.2. të drejtë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ose mundësi për të ushtruar pesë përqind (5%) ose më shumë të të drejtave të votimit në një person juridik, dhe/ose pronësi direkte ose indirekte prej pesë për qind (5%) ose më shumë të kapitalit të një personi të tillë juridik, ose

1.67.3. mundësi për të ushtruar ndikimin efektiv mbi menaxhmentin e personit juridik ose mbi politikat e biznesit të një personi të tillë juridik;

1.67.4. interes i konsiderueshëm ekziston kur një person ka:

1.67.5. të drejtë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ose mundësi për të ushtruar njëzet për qind (20%) ose më shumë të të drejtave të votimit në një person juridik, dhe/ose pronësi direkte ose indirekte prej njëzet për qind (20%) ose më shumë të kapitalit të një personi të tillë juridik, ose

1.67.6. mundësi për të ushtruar ndikimin efektiv mbi menaxhmentin e personit juridik ose mbi politikat e biznesit të një personi të tillë juridik;

1.67.7. interes kontrollues ekziston kur një person ka:

1.67.8. të drejtë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ose mundësi për të ushtruar pesëdhjetë për qind (50%) ose më shumë të të drejtave të votimit në një person juridik, dhe/ose pronësi direkte ose indirekte prej pesëdhjetë për qind (50%) ose më shumë të kapitalit të një personi të tillë juridik; ose

1.67.9. mundësinë për të zgjedhur së paku gjysmën e anëtarëve të bordit menaxhues ose njësi tjera menaxheriale në një person të tillë juridik, ose

1.67.10. mundësi për të ushtruar ndikimin efektiv mbi menaxhmentin e personit juridik ose mbi politikat e biznesit të një personi të tillë juridik.

1.68. Menaxher special – menaxheri i bankës nën procesin e përmbylljes i emëruar nga BQK, si autoritet i përmbylljes, sipas paragrafit 7. të nenit 107 të këtij ligji;

1.69. Subjekt i varur - çdo person juridik në të cilin një person tjetër ose grup personash që veprojnë së bashku zotërojnë drejtpërdrejtë apo tërthortë:

1.69.1. pesëdhjetë për qind (50%) ose më lartë të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote, ose

1.69.2. një interes të konsiderueshëm, që ua mundëson këtyre personave të tjerë ose grup personash të ushtrojnë një kontroll mbi personin juridik në të cilin zotërohen ato aksione.

1.70. Ndhimja shtetërore – ka kuptimin e dhënë në ligjin përkatës të ndihmës shtetërore;

1.71. Krizë sistemike – nënkupton ndërprerjen e veprimtarisë në sistemin financiar e cila mund të ketë pasoja të rënda negative për tregun financiar dhe ekonominë reale. Të gjithë llojet e ndërmjetësuesve financiar, tregjet dhe infrastruktura financiare mund të jenë potencialisht me rëndësi sistemike deri në një masë;

1.72. Kapitali i klasës së parë dhe të dytë – ka kuptimin e përcaktuar nga BQK me rregullore të veçantë për qëllim të nenit 21 të këtij ligji;

1.73. Rreziku i transferit – nënkupton mundësinë e humbjes për shkak të kufizimeve të konvertimit (këmbimit) të valutës të vendosura nga një qeveri e huaj, që e pamundëson lëvizjen e parave jashtë vendit;

1.74. Aksione me të drejtë vote - aksione të zakonshme në kapitalin e personit dhe aksione të tjera të çfarëdo caktimi ose përshkrimi, që i japin personit të drejtën për të votuar për çfarëdo vendimi në një mbledhje të zakonshme ose të jashtëzakonshme të emetuesit;

1.75. Netimi - do të thotë kthimi në një pretendim neto ose në një detyrim neto të kërkesave dhe detyrimeve që rezultojnë nga urdhëresat për transfer në të cilin pjesëmarrësi apo pjesëmarrësit në sistemin e shlyerjes lëshojnë ose marrin nga një a më shumë pjesëmarrës në atë sistem, në mënyrë që të mbetet vetëm kërkesa neto ose obligimi neto;

1.76. Vlera neto e shkëputjes - shuma neto e marrë pas përcaktimit të detyrimeve reciproke ndërmjet palëve në një kontratë të lejueshme financiare në përputhje me dispozitat e saj;

1.77. Likuidim – likuidimi i aseteve të një banke;

1.78. Kompetenca e zvogëlimit të vlerës dhe e konvertimit – kompetencat e referuara në nenin 112 të këtij ligji;

1.79. Depozitë Ekuivalente me Kapitalin (“DEK”) - pjesa e kapitalit fillestar minimal të dhënë dhe të paguar në para të gatshme nga banka mëmë për ushtrimin e veprimtarisë nga dega e saj në Republikën e Kosovës;

1.80. Depozitë me fonde një burimore - nënkupton një person juridik ose personi i ndërlidhur me të në mënyrë direkte ose indirekte, si pronar i fundit përfitues ose shuma e përgjithshme e të gjithë shfrytëzuesve të të hyrave publike nga organet qeveritare të cilat klasifikohen si organizata buxhetore të Kosovës, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga BQK-ja;

1.81. Bankë Participuese – bankë që kryen veprimtari bankare sipas parimeve të bankimit islamik, alternativ apo participues të përcaktuar me rregullore nga BQK-ja, në pajtueshmëri me standardet e aplikueshme ndërkombëtare;

1.82. Klient i shërbimeve financiare – nënkupton çdo person fizik dhe juridik që pranon shërbime financiare sipas rregullores të BQK-së;

1.83. BQK - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

NËNKAPITULLI II AUTORITETI KOMPETENT

Neni 4 Autoriteti i licencimit

1. BQK-ja është autoriteti i vetëm kompetent dhe përgjegjës për licencimin e bankave në pajtim me këtë ligj dhe ligjin përkatës për BQK-në.

2. BQK-ja ka autoritetin e vetëm diskrecional për lëshimin e licencave për të gjitha bankat dhe lejet për themelimin e zyrave përfaqësuese.

3. BQK-ja mban një regjistër qendror të disponueshëm për inspektim nga publiku, për evidentimin e bankave që veprojnë në Republikën e Kosovës, me të dhënat si në vijim:

3.1. emrin;

3.2. adresën e zyrës qendrore dhe zyrës së degëve, faqen e internetit, dhe

3.3. kopjet aktuale të statutit apo dokumentacionit themelues ekuivalent dhe akteve nënligjore.

4. Një listë e të gjitha bankave me licenca të revokuara do të mbahen gjithashtu në regjistër, por dokumentacioni i themelimit dhe aktet nënligjore të tyre do të largohen nga regjistri.

Neni 5 **Autoriteti mbikëqyrës**

1. BQK-ja është autoriteti i vetëm kompetent dhe përgjegjës për mbikëqyrjen makroprudenciale përmes përcaktimit të masave me qëllim të zbutjes së rrezikut makroprudencial ose sistematik të lidhur me bankat dhe në kuptimin e përcaktimit të kërkesave të kapitalit shtesë në masën dhe mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.

2. BQK-ja është autoriteti kompetent dhe përgjegjës për mbikëqyrjen mikroprudenciale të bankave në përputhje me këtë ligj.

3. Në kryerjen e detyrave mbikëqyrëse dhe ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse në pajtim me këtë ligj, BQK-ja sigurohet që subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes veprojnë në përputhje me legjislacionin përkatës, përfshirë ligjin përkatës për BQK-në dhe rregulloret e nxjerra nga BQK.

4. Përveç paragrafit 3. të këtij neni, bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të si veprojnë në përputhje me:

4.1. udhëzimet e rregulloreve, rekomandimet dhe aktet e tjera përkatëse ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës;

4.2. standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet lidhur me veprimtarinë e bankave dhe mbikëqyrjen e kujdeshme të bankave, për sa kohë që ato nuk janë në konflikt me kornizën ligjore dhe rregullative të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

5. Në asistimin e kryerjes së detyrave mbikëqyrëse, BQK në bashkëpunim me Ministrinë themelojnë Komitetin për Stabilitetin Financiar, si trupë ndër-instituconale me qëllim të menaxhimit të krizave dhe stabilitetit financiar. Kushtet e veprimit dhe operacionalizimi i këtij Komiteti do të rregullohet përmes një memorandumit të mirëkuptimit në mes të institucioneve përkatëse.

Neni 6 **Autoriteti i mbrojtjes së konsumatorëve**

1. BQK-ja është autoriteti kompetent dhe përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorit lidhur me produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare.

2. Gjatë kryerjes së detyrave mbikëqyrëse dhe ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse në aspektin e mbrojtjes së konsumatorit, BQK-ja duhet të sigurojë që subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes veprojnë në pajtim me këtë ligj, me ligjin e BQK-së dhe përshtatshëmrisht me ligjin përkatës për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 7

Autoriteti i përmbylljes

1. BQK-ja është autoriteti i vetëm i përmbylljes të bankave në Republikën e Kosovës, dhe e autorizuar të zbatojë instrumentet e përmbylljes, si dhe të ushtrojë kompetencat e përmbylljes të parashikuara me këtë ligj.
2. Funkzioni i përmbylljes i BQK-së është funksionalisht i pavarur dhe i ndarë nga funksione të tjera brenda BQK-së. BQK-ja zbaton rregullimet organizative përkatëse në respektim të këtij paragrafi.
3. Përveçse kur përcaktohet ndryshe, referencat në BQK në Kapitullin III të këtij ligji interpretohen në lidhje me kushtet e BQK-së që vepron në cilësinë e saj si autoritet i përmbylljes.

Neni 8

Instrumentet rregullative

1. BQK-ja nxjerr instrumente rregullative që përmbajnë rregulla të përgjithshme dhe më të hollësishme për interpretimin dhe zbatimin e njëjtë të neneve të këtij ligji dhe për formulimin e praktikave më të mira.
2. Instrumentet rregullative të BQK-së publikohen në faqen e internetit të BQK-së, në pajtim me Ligjin për BQK-në, dhe kanë karakter detyrues.

KAPITULLI II

LICENCIMI DHE MBIKËQYRJA

NËNKAPITULLI I

LICENCIMI I BANKAVE

Neni 9

Leja për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare

1. Veprimtaritë bankare dhe financiare në Republikën e Kosovës, të lejuara me këtë ligj, kryhen nga:
 - 1.1. një bankë e licencuar nga BQK për të ushtruar veprimtari në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. një subjekt i varur dhe një degë e një banke të huaj e licencuar nga BQK për të vepruar në Republikën e Kosovës.

Neni 10

Ndalesat e përgjithshme dhe përjashtimet

1. Asnjë person nuk mund të angazhohet në veprimtari bankare ose të ushtrojë veprimtari financiare pa një licencë të vlefshme të lëshuar nga BQK-ja sipas këtij ligji, ligjit përkatës të BQK ose ndonjë ligji të veçantë në fuqi.

2. Asnjë bankë e huaj nuk lejohet të angazhohet në veprimtari bankare ose të ushtrojë veprimtari financiare në Kosovë përveç nëse banka e huaj ka marrë një licencë të lëshuar nga BQK-ja për të ushtruar një veprimtarinë e tillë nëpërmjet një dege në Kosovë apo ka themeluar një bankë të varur në Kosovë për të cilën BQK-ja ka lëshuar licencë.

3. Fjala “bankë” ose ndërlidhshmëritë me këtë fjalë, nëse mbahen në emrin e shoqërisë, mund të regjistrohen në regjistrin e shoqërive tregtare ose të përdoren në transaksione ligjore vetëm nga:

3.1. një person juridik i autorizuar nga BQK-ja si bankë;

3.2. bankat që ofrojnë shërbime sipas këtij ligji, dhe

3.3. anëtarët e një grupi bankar.

4. Bankat e licencuara në vende të huaja mund të përdorin në territorin e Republikës së Kosovës të njëjtin emër që përdorin në vendin amë. Përjashtimisht, në situatën kur tashmë ekziston një bankë që vepron në territorin e Republikës së Kosovës nën emrin e njëjtë ose të ngjashëm, BQK-ja, për qëllime të sqarimit, mund të kërkojë që emri i bankës së një vendi të huaj të shoqërohet nga disa shpjegime të caktuara.

5. Asnjë person nuk duhet të përdorë fjalën "bankë" ose derivatet e kësaj fjale në lidhje me një biznes, produkt, shërbim ose në biznes promovues pa pasur licencë të lëshuar nga BQK-ja për t'u angazhuar në veprimtarinë bankare, përveç nëse përdorimi i tillë është i përcaktuar ose i njohur me këtë ligj, një marrëveshje ndërkombëtare ose kur konteksti në të cilin përdoret fjala "bankë" nuk ka të bëjë me kryerjen e ndonjë veprimtarie financiare të përcaktuar me këtë ligj.

6. Asnjë zyre përfaqësuese nuk mund të përdorë fjalën “bankë” në emër të saj, përveç rasteve kur fjala “bankë” përbën një pjesë integrale të emrit të bankës së huaj të cilës ato i përkasin, me kusht që, në raste të tilla të shtohet fjala “zyra përfaqësuese”.

7. Asnjë bankë nuk mund të përdorë në emrin e vet fjalë që mund të çojnë në keqkuptime lidhur me kushtet e tyre financiare, statusin ligjor ose asociimin me qeverinë, organizatat ndërkombëtare ose organizata tjera të njohura nga sektori privat.

8. Asnjë person nuk duhet të bëjë deklaratime të pavërteta për fakte materiale ose të bëjë një paraqitje të rreme ose çorientuese apo të ndërmarr veprime për të krijuar një pamje të rreme, mashtruese ose të angazhohet në çfarëdo veprimi manipulues ose praktike për marrjen e depozitave.

Neni 11

Veprimtaritë bankare dhe financiare

1. Bankat përmes licencimit autorizohen për t'u angazhuar në veprimtaritë e mëposhtme bankare dhe financiare, dhe sipas kufizimeve për ekspozime të specifikuara me rregullore ose urdhëresë të BQK-së.

2. Veprimtari bankare konsiderohet pranim i depozitave ose fondeve të tjera të ripagueshme nga banka. Për qëllime të këtij ligji, veprimtaritë si në vijim nuk konsiderohen pranim i depozitave ose fondeve të tjera me detyrim të ripagesës:

2.1. pranimi i fondeve që janë të këmbyeshme menjëherë në para elektronike nga një institucion i parasë elektronike;

2.2. pranimi i fondeve nga institucionet e pagesave përmes shfrytëzuesit të shërbimit të pagesave, me qëllim të ofrimit të shërbimit të pagesave në pajtim me legjislacion të veçantë.

3. Veprimtari financiare konsiderohen:

3.1. dhënia e kredive, duke përfshirë kreditë konsumuese dhe hipotekare;

3.2. faktoringu dhe financimi i transaksioneve tregtare/komerciale;

3.3. ofrimi i shërbimeve të pagesave dhe arkëtimeve;

3.4. ofrimi i shërbimeve të pagesave dhe emetimi i parasë elektronike siç përcaktohet dhe rregullohet me ligjet e aplikueshme dhe/ose nga BQK-ja;

3.5. emetimi dhe administrimi (menaxhimi) i mjeteve të tjera për pagesa që nuk mbulohen me nën-paragrafin 3.4. të këtij neni, duke përfshirë kartelat për kryerjen e pagesave, çeqet e udhëtarëve dhe draftet bankare dhe pagesat përmes telefonisë mobile;

3.6. emetimi dhe menaxhimi i mjeteve për pagesë (duke përfshirë kartelat për kryerjen e pagesave, çeqet e udhëtarëve, draftet bankare dhe pagesat përmes telefonisë mobile), duke përfshirë emetimin e parasë elektronike;

3.7. blerja dhe shitja e valutës së huaj për para të gatshme, për llogari të klientit;

3.8. ofrimin e shërbimeve për blerjen, shitjen dhe ruajtjen e letrave me vlerë dhe sendeve të tjera me vlerë;

3.9. huazimin e fondeve dhe blerjen dhe shitjen për llogari të bankës ose për llogari të klientëve, të instrumenteve të tregut të parasë, letrat me vlerë të borxhit, kontratat e së ardhmes dhe opsionet, dhe instrumentet tjera që lidhen me letrat me vlerë të borxhit, normat e interesit, normat e këmbimit valutor dhe çmimet e mallrave;

- 3.10. të vepruarit si ndërmjetës ndërmjet huamarrësve dhe huadhënësve (komisionimi i parave);
 - 3.11. lizingu financiar;
 - 3.12. ofrimi i shërbimeve të agjentit ose këshilltarit financiar;
 - 3.13. veprimi me ari apo një ose me më shumë valuta përveç valutës në të cilën është denominuar bilanci i bankës, duke përfshirë këtu kontratat për blerjen dhe shitjen e ardhshme të valutave të huaja;
 - 3.14. ofrimi i shërbimeve trust, duke përfshirë investimin dhe menaxhimin e fondeve të pranuar në trust dhe menaxhimin e letrave me vlerë;
 - 3.15. nënshkrimi dhe shpërndarja e letrave me vlerë të borxhit dhe të kapitalit dhe veprimi me letra me vlerë të kapitalit;
 - 3.16. veprimtari bankare sipas parimeve të bankingut alternativ ose participues me pëlqim të BQK-së dhe sipas kushteve dhe në pajtueshmëri me rregulloret që mund të përcaktohen nga BQK-ja;
 - 3.17. dhënia e kredive në formë të bashkëfinancimit nga bankat (kreditë e sindikuara) apo formave tjera të sipas përcaktimeve përkatëse me udhëzues apo rregullore të BQK-së.
4. Çdo veprimtari tjetër e përcaktuar me rregullore të BQK-së në lidhje me veprimtarinë financiare dhe që nuk bie ndesh me dispozitat e këtij ligji.
5. Shërbimet financiare ndihmëse për qëllime të këtij ligji konsiderohen:
- 5.1. ndërmjetësimi në shitjen e policave të sigurimit sipas ligjit përkatës për sigurime;
 - 5.2. administrimin e sistemit të pagesave në Euro si valutë e vetme për pagesë dhe shërbimet e operacioneve;
 - 5.3. shërbimet e kujdestarisë të ofruara nga një bankë në përputhje me ndonjë ligj tjetër dhe shërbime të lidhura me kujdestarinë;
 - 5.4. importi dhe eksporti i parave të gatshme në euro apo valuta të tjera që mund të bëhet vetëm nga bankat e licencura dhe të autorizuara shprehimisht për këtë aktivitet nga BQK-ja.
6. Të hyrat nga shërbimet jofinanciare lejohen deri në dhjetë për qind (10%) të gjithsej të hyrave neto të interesit të vitit të fundit financiar.

Neni 12

Veprimtaritë e ndaluara

1. Bankat ndalohen të hyjnë në transaksione ose të angazhohen në praktika të çdo lloji që do tu jepnin atyre, vetës apo së bashku me të tjerë, një pozicion zotërues në tregjet e parasë, pagesave, kapitalit ose këmbimit valutor, dhe i ndalohet në angazhime manipuluese ose praktika të çmimeve grabitqare që mund të rezultojnë në një avantazh të pandershëm për ata vetë ose për palë të treta.
2. Përveç veprimtarive të identifikuara me këtë ligj dhe/ose të miratuara nga BQK-ja sipas nenit 11 të këtij ligji, bankat nuk mund të angazhohen në industri, tregti apo veprimtari të tjera ekonomike.
3. Bankat nuk duhet të angazhohen në veprimtari që i tejkalojnë autorizimet e specifikuara nga licenca e saj. Bankat që kërkojnë të angazhohen në veprimtari jashtë autorizimeve nga licenca e saj, duhet të marrin miratimin paraprak të BQK-së.
4. BQK-ja mund të ndalojë ose kufizojë bankat nga përfshirja në ndonjë nga veprimtaritë e lejuara të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji. Në një rast të tillë, BQK-ja arsyeton me shkrim vendimin e saj.
5. Banka nuk ka të drejtë të ndërmerr veprime kushtëzuese ndaj personit ashtu që marrëdhënien kontraktuale me bankën ta kushtëzoj me kontraktim shtesë për shërbime financiare, mallra apo shërbim tjetër nga banka ose subjekti i varur i saj.
6. Banka nuk duhet të ketë një ekspozim të siguar me letrat me vlerë të kapitalit të vet ose të huazoj për qëllime të blerjes së këtyre letrave me vlerë.
7. Asnjë bankë nuk duhet të blejë letrat e saj me vlerë të kapitalit ose ndonjë instrument tjetër që cilësohet si kapital rregullator pa autorizim paraprak të BQK-së.

NËNKAPITULLI II

PROCESI I LICENCIMIT

Neni 13

Kërkesat për licencë

1. Kërkesat për licencim të bankës ose një degë të bankës së huaj parashtrohen në formën e përcaktuar nga BQK-ja dhe shoqërohen nga informacionet e mëposhtme:
 - 1.1. dokumentet përbërëse të bankës së propozuar apo të bankës së huaj, duke përfshirë një kopje të noterizuar apo dokumentacionin origjinal sipas të cilit është themeluar, si dhe adresën e propozuar të drejtorisë qendrore;
 - 1.2. emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet dhe përvojën e Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë të bankës së propozuar ose bankës së huaj duke përfshirë gjithë historikun afarist dhe profesional. Në rastin e degës së bankës së huaj ky nën-

paragraf është i zbatueshëm vetëm për Menaxherët e lartë të degës së propozuar në Kosovë;

1.3. shumën e kapitalit të zotuar të bankës së propozuar ose të bankës së huaj, duke përfshirë shumat të cilat janë paguar dhe burimin e ligjshëm të kapitalit;

1.4. planin e biznesit që përfshinë, ndër të tjera, strukturën organizative të bankës së propozuar ose degës së bankës së huaj, duke përfshirë kontrollet e brendshme të propozuara, menaxhimin e rrezikut dhe procesin e qeverisjes korporative, llojin e parashikuar të veprimtarive bankare/financiare, tregun e synuar dhe inovacionin, impaktin në sistemin bankar dhe kontributin e pritur në ekonominë reale dhe pasqyrat e parashikuara financiare për tri (3) vite;

1.5. listën e aksionarëve që mbajnë apo do të mbajnë pesë për qind (5%) a më shumë të aksioneve të bankës së propozuar ose bankës së huaj (që planifikon të hapë një degë në Kosovë), dhe pronarëve përfitues të këtyre aksioneve, duke specifikuar emrat e tyre, adresën dhe posedimin përkatës të aksioneve;

1.6. emrin, nacionalitetin, vendbanimin, historikun afarist dhe profesional për pesë (5) vitet e fundit dhe pasqyrat financiare të audituara për tri (3) vitet e fundit (nëse ekzistojnë) të çdo aksionari kryesor të bankës së propozuar. Në rastin e degës së bankës së huaj pasqyrat e audituara financiare të bankës së huaj;

1.7. për çdo Drejtor, Menaxher të Lartë apo aksionar kryesor të bankës së propozuar, dëshminë zyrtare nga gjykata në vendin ku personi është rezident që shpalosë evidencën penale, dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit, apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organi tjetër sipërmarrës që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese, nëse ka. Në rastin e degës së bankës së huaj kriteri në këtë nën-paragraf është i aplikueshëm vetëm për Menaxherët e lartë të degës së propozuar në Kosovë;

1.8. në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës është një bankë e huaj që propozon themelimin e një banke si subjekt i varur ose të një dege në Kosovë, duhet të sigurohet: (i) një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit të amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të veprimtarive të propozuara në Kosovë, (ii) ky mbikëqyrës ushtron mbikëqyrje globale bankare të konsoliduar të veprimtarisë ndaj bankës së huaj; dhe (iii) banka i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore kryesore në vendin amë dhe në vendet tjera ku vepron dhe nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes së shtuar ose dënimeve. Në rastin e degës së bankës huaj një deklaratë nga banka mëmë me të cilën pranon përgjegjësinë për të siguruar shëndetshmërinë financiare të degës;

1.9. informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të nevojshme nga BQK-ja.

2. BQK-ja mund të kërkojë kërkesa shtesë lidhur me informacionin dhe dokumentacionin e licencimit, dhe të specifikojë procedurat e aplikimit dhe afatet për rishikim.

3. Dokumentacioni i ofruar sipas këtij neni duhet të dorëzohet në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose në një kopje të noterizuar.

Neni 14 **Miratimi paraprak**

1. Brenda tre (3) muajve nga data kur kërkesa për licencë konsiderohet e kompletuar nga BQK, kërkesa miratohet në formë paraprake ose refuzohet dhe paraqitësi i kërkesës njoftohet me shkrim për vendimin. Njoftimi për refuzim të licencës përcakton arsyet mbi bazë të së cilave është refuzuar kërkesa për licencim.

2. BQK-ja refuzon licencën nëse:

2.1 kushtet e licencimit të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji të nxjerra nga BQK-ja nuk janë plotësuar;

2.2. BQK konsideron se mbikëqyrja nga mbikëqyrësi i vendit amë ose mbikëqyrja globale e konsoliduar e grupit bankar nuk është adekuate;

2.3. paraqitësi i kërkesës, sipas vlerësimit të BQK-së, është angazhuar në praktika të pasigurta, të paqëndrueshme ose grabitqare në juridiksionin amë ose në ndonjë juridiksion tjetër në të cilin vepron;

2.4. BQK-ja gjykon se veprimtaritë e propozuara të bankës ose kushtet për të cilat synon të ofrojë produktet dhe shërbimet e saj nuk do të kontribuonin pozitivisht në tregjet financiare dhe ekonominë e Kosovës;

2.5. përveç paragrafit 2. të këtij neni, BQK-ja refuzon kërkesën për licencim nëse, në gjykimin e arsyeshëm, lëshimi i një licence të tillë do të:

2.6. shkaktonte rrezik në qëndrueshmërinë financiare të bankës së propozuar ose të sistemit bankar në përgjithësi;

2.7. rrezikonte interesat e depozitorëve të mundshëm të bankës së propozuar;

2.8. zvogëlonte në mënyrë substanciale konkurrencën, apo

2.9. ngërthen aspekte të rrezikimit të sigurisë kombëtare.

3. BQK-ja paraprakisht miraton një kërkesë për licencim vetëm nëse:

3.1. plani i biznesit bazohet në analiza të sakta mbi supozime të arsyeshme;

3.2. struktura organizative e bankës së propozuar, filialeve të saj dhe subjekteve të varura do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive në bazë të konsoliduar;

3.3. banka e propozuar ose dega e bankës së huaj do të veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e këtij ligji;

3.4. drejtorët dhe Menaxherët e lartë duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 55 të këtij ligji;

3.5. aksionarët kryesorë të bankës së propozuar duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm siç përcaktohet në nenin 55 të këtij ligji, dhe

3.6. struktura e pronësisë së bankës nuk do të pengojë mbikëqyrjen efektive ose zbatimin e masave përmirësuese në të ardhmen;

3.7. kushtet e tjera të përcaktuara me rregulloret dhe aktet nënligjore të nxjerra nga BQK-ja.

4. Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 3. të këtij neni, miratimi paraprak i kërkesës për licencim lidhur me një subjekt të varur ose degë të bankës së huaj bëhet vetëm nëse:

4.1. banka e huaj është e autorizuar për t'u angazhuar në veprimtarinë e pranimi të depozitave ose fondeve në formë depozitash në juridiksionin ku gjendet zyra e saj qendrore;

4.2. autoritetet kompetente që mbikëqyrin bankën e huaj në zyrën qendrore të saj kanë dhënë pëlqimin e tyre me shkrim për dhënien e licencës së këtillë;

4.3. BQK-ja në gjykimin e saj përcakton se banka e huaj mbikëqyrjet në mënyrë adekuate në bazë të konsoliduar globale nga mbikëqyrësi në vendin amë. Mbikëqyrësi nga vendi amë duhet ta pranojë me shkrim se është në dijeni të dhënies së licencës së re dhe pajtohet që t'i ofrojë informatat BQK-së sipas kërkesës;

4.4. nuk cenohet siguria kombëtare apo nuk ka ekspozim ndaj një rreziku të lartë lidhur me të.

5. Në rast të miratimit paraprak të një kërkesë për licencë, BQK-ja përcakton të gjitha kushtet për fillimin e operacioneve për të cilat lëshohet licenca. Kushte e këtilla mund të përfshijnë:

5.1. pagesën e minimumit të kapitalit të paguar që aksionarët duhet të bëjnë për bankën;

5.2. punësimin dhe trajnimin e personelit të bankës;

5.3. marrjen me qira (lizingun) ose blerjen e objektit të bankës, pajisjeve operative dhe përcaktimin e sistemeve operative;

5.4. angazhimin e një auditori të jashtëm në përputhje me nenin 68 të këtij ligji, dhe

5.5. çdo kusht tjetër që BQK-ja e konsideron të nevojshme.

6. Pas miratimit paraprak të kërkesës për licencim, bankat nuk mund të angazhohen në veprimtari bankare deri në dhënien e licencës.

7. Nëse brenda një (1) viti një bankë nuk vepron në përputhje me kushtet për marrjen e licencës të përcaktuara në këtë nen, miratimi paraprak i kërkesës për licencim revokohet.

Neni 15 **Dhënia e licencës**

1. Nëse BQK-ja përcakton se janë plotësuar kushtet sipas nenit 13 dhe 14 të këtij ligji, lëshon licencën dhe banka anëtarësohet në Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës në pajtim me ligjin përkatës mbi sistemin e sigurimit të depozitave për institucionet financiare depozitë-marrëse në Kosovë.

2. Licenca lëshohet me shkrim për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk është e transferueshme. Licenca specifikon veprimtaritë bankare dhe financiare në të cilat banka autorizohet në pajtim me nenin 11 të këtij Ligji.

3. Vendimi për dhënien e licencës publikohet nga BQK-ja në faqen e internetit të BQK-së.

4. Pas licencimit fillestar, bankat kanë të drejtë të aplikojnë në BQK për t'u angazhuar në veprimtari shtesë në përputhje me nenin 11 të këtij Ligji.

Neni 16 **Lejet për zyrën përfaqësuese**

1. Një bankë e huaj mund të regjistroj dhe/ose të funksionalizojë një zyrë përfaqësuese në Kosovë vetëm me leje nga BQK-ja.

2. BQK-ja mund të japë leje për një zyrë përfaqësuese në Kosovë, më kusht që BQK-ja sigurohet se banka e huaj do t'i kufizojë veprimtaritë e saja të zyrës përfaqësuese në ofrimin e informatave dhe veprimtarive ndërlidhëse dhe studimit të tregjeve dhe mundësive për investim, dhe se banka e huaj nuk do të angazhohet në veprimtari bankare/financiare në Kosovë nëpërmjet zyrës përfaqësuese.

3. Kërkesat nga një bankë e huaj për leje për të themeluar dhe operuar me një zyrë përfaqësuese duhet të bëhen në mënyrën e përcaktuar nga BQK-ja dhe shoqërohet me informatat e kërkuara nga BQK-ja.

Neni 17 **Transformimi nga dega në një subjekt të varur**

1. BQK-ja mund të kërkojë një degë të një banke të huaj që është e licencuar për të operuar në Republikën e Kosovës të shndërrohet në një subjekt të varur të bankës së huaj nëse:

1.1. ka një ndryshim material në pronësinë ose menaxhmentin e bankës së huaj për të cilën BQK-ja ka baza të arsyeshme për shqetësim;

1.2. ekziston një rënie materiale në gjendjen financiare të bankës së huaj ose banka e huaj është subjekt i sanksioneve nga mbikëqyrësi i vendit amë për shkelje materiale të ligjit ose rregulloreve ose praktikave të pasigurta ose të paqëndrueshme;

1.3. BQK-ja konsideron se operacionet e degës mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të sektorit bankar ose të jenë të dëmshme për interesat e depozitorëve;

1.4. BQK-ja konsideron se operacionet e degës janë bërë me rëndësi sistemike për sistemin financiar në Kosovë për shkak të madhësisë së saj apo ndonjë veçori tjetër, siç përcaktohet nga BQK-ja;

1.5. BQK-ja konsideron se dega e bankës së huaj nuk po arrin të krijojë vlerë dhe impakt në sistemin financiar dhe ekonominë e vendit, pas kalimit të një afati nga licencimi të arsyeshëm sipas vlerësimit të BQK-së;

1.6. BQK konsideron që mbikëqyrja është vështirësuar ose mbikëqyrja nga vendi amë është joadekuate.

2. Banka e huaj mund të kërkojë transformimin e degës së saj në një subjekt të varur e cila i nënshtrohet miratimit nga BQK-ja.

3. BQK-ja mund të refuzojë transformimin nëse e konsideron që:

3.1. ka ndikim negativ në ekonominë kombëtare, në konkurrencën e drejtë apo në interesat shtetërore;

3.2. ka ndikim negativ në stabilitetin financiar të vendit;

3.3. rrezikon shëndetin e saj financiar dhe nëse banka e transformuar nuk mund të sigurojë pajtueshmëri të plotë me normat rregullatore dhe mbikëqyrëse të BQK-së.

4. Procesi i transformimit të degës së huaj në një subjekt të varur është i detyrueshëm kur përcaktohet si i nevojshëm me vendim të BQK-së, në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni. Afati për realizimin e transformimit në secilën situatë nuk duhet të jetë më i gjatë se tre (3) vite.

5. Me transformim, subjekti i varur i bankës së huaj trashëgon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga operacionet dhe veprimtaritë e degës së bankës së huaj, duke përfshirë edhe depozitat e akumuluar.

6. BQK-ja mund të rregullojë më tej procedurën e transformimit nga një degë në subjekt të varur nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 18 **Revokimi i licencës**

1. Licenca e një banke apo dege të bankës së huaj mund të revokohet me vendim të BQK-së, për njërin apo disa nga arsytet e mëposhtme:

- 1.1. nëse BQK-ja ka miratuar planin që banka të përfundojë veprimtarinë në Kosovë;
- 1.2. nëse banka ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ndonjë urdhëresë ose rregullore të BQK-së, apo ndonjë kusht ose kufizim që ndërlidhet me autorizimin e lëshuar nga BQK-ja;
- 1.3. nëse banka është angazhuar në praktika të pasigurta, të pa shëndosha ose agresive sipas gjykimit të BQK-së ose në praktika grabitqare;
- 1.4. nëse licenca është marrë në bazë të informacionit të rrejshëm të paraqitur në kërkesën për licencim ose që ka të bëjë me paraqitësin e kërkesës;
- 1.5. nëse banka nuk ka filluar veprimtarinë brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas marrjes së licencës apo brenda një periudhe vijuese të caktuar nga BQK-ja dhe nëse ka pushuar të merret me veprimtarinë e pranimit të depozitave për më shumë se tre (3) muaj;
- 1.6. nëse licenca e bankës mëmë (që ka interes të konsiderueshëm në këtë bankë) është revokuar;
- 1.7. nëse ka ndodhur bashkimi, blerja ose shitja e pjesës më të madhe të asetëve (pasurisë) të bankës pa aprovimin e BQK-së;
- 1.8. nëse veprimtaritë e bankës ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga ato të paraqitura në kërkesën për licencë dhe, sipas vlerësimit të BQK-së, ndryshimi i tillë nuk është arsyetuar e as nuk është dhënë miratimi nga BQK-ja për ndryshimet e tilla;
- 1.9. nëse ka pasur ndryshim të konsiderueshëm në pronësinë e bankës siç përcaktohet në nenin 57 të këtij Ligji, pa miratimin paraprak të BQK-së.

2. Përveç shkaqeve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, licenca e bankës revokohet me vendim të BQK-së kur konstatohen se banka nuk i plotëson më kërkesat prudenciale, duke përfshirë kërkesat rregullatore për kapital dhe likuiditet dhe kërkesat për ekspozimet e mëdha, ose nuk mund të mbështetet më për të përmbushur detyrimet e saj ndaj kreditorëve të saj, dhe, në veçanti, nuk ofron siguri për asetet (pasuritë) që i janë besuar nga depozitorët e saj.

3. Vendimi i BQK-së për t'ia revokuar licencën duhet t'i komunikohet me shkrim bankës, duke dhënë arsyet e vendimit dhe duhet të hyjë në fuqi në datën e përcaktuar në vendim.

4. Vendimi me të cilin revokohet një licencë publikohet në një apo më shumë gazeta të qarkullimit të përgjithshëm kudo që ndodhen zyrat e bankës dhe në faqen e internetit të BQK-së.

NËNKAPITULLI III KËRKESAT PËR KAPITAL DHE LIKUIDITET

Neni 19

Kapitali minimal i paguar për bankat

1. Çdo bankë duhet të ketë në çdo kohë kapital të paguar jo më pak se dhjetë milion euro (10.000.000) në para të gatshme, apo një shumë më të madhe të specifikuar me rregullore apo urdhëresë të BQK-së.
2. Kapitali minimal i paguar për qëllime të marrjes së licencës bankare duhet të depozitohet në BQK në një llogari depozite, në formën e një garancie pa interes dhe duhet të ngrihet (bllokohet) deri në marrjen e licencës. Depozitimi duhet të kryhet përmes një rrjeti në llogari.
3. Kapitali i paguar nuk mund të trajtohet si i tillë nëse fondet rrjedhin nga:
 - 3.1. kreditë e dhëna nga publiku;
 - 3.2. kreditë e dhëna nga bankat;
 - 3.3. paratë e paguara paraprakisht nga palët e treta dhe personat juridik.
4. Aksionet e emetuara në këmbim të shërbimeve nuk do të trajtohen si kapital të paguar.

Neni 20

Burimi i kapitalit

1. Çdo aksionar i bankës duhet të japë informacion mbi burimet e kapitalit fillestar të paguar për themelimin e bankës, si dhe çdo shtim të kapitalit gjatë rrjedhës së veprimtarisë bankare në përputhje me kriteret e përcaktuara nga BQK-ja.
2. Çdo pagesë e kapitalit fillestar dhe çdo shtim në strukturën e kapitalit të bankës duhet të shoqërohet me dorëzimin në BQK të informacionit në lidhje me burimin e krijimit të kapitalit të tillë, si në vijim:
 - 2.1. Për personat juridik:
 - 2.1.1. dëshmia e burimit të krijimit të fondeve të dorëzuara në një formë ligjërishit të pranueshme që përfshin por nuk kufizohet në raportin e auditorit të autorizuar, bilancin vjetor kontabël, dhurata ose burime të tjera të destinuara për t'u përdorur për blerjen e aksioneve të bankës;
 - 2.1.2. certifikatat nga autoritetet kompetente të cilat ofrojnë të dhëna për gjendjen e kompanisë dhe pajtueshmërinë me detyrimet tatimore.
 - 2.2. Për personat fizik:

2.2.1. dëshmitë e burimit të fondeve të paraqitura në një formë ligjërish të pranueshme që përfshin por nuk kufizohet në, dhuratë, paga, depozita monetare në bankë ose dëshmi të tjera të burimit të fondeve;

2.2.2. certifikatat e autoriteteve shtetërore kompetente që evidentojnë pagesën e detyrimeve tatimore.

3. Metodatat dhe procedurat për dorëzimin e dokumentacionit përcaktohen nga BQK-ja.

Neni 21

Kërkesat minimale për kapitalin rregullator

1. Çdo bankë në çdo kohë duhet të sigurojë një shumë të kapitalit që është proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të saj, si dhe ndaj rreziqeve që është ose mund të jetë e ekspozuar gjatë aktivitetit bankar ose financiar.

2. Çdo bankë duhet në çdo kohë të mbajë kapitalin rregullator, të përcaktuar në bazë të përshtatjes ndaj rrezikut sikurse specifikohet nga BQK-ja.

3. BQK-ja përcakton me instrumente rregullatore:

3.1. kushtet e detajuara dhe mënyrën e llogaritjes së mjeteve (aseteve) të peshuara me rrezik;

3.2. qasjet që banka mund t'i shfrytëzojë për llogaritjen e mjeteve (aseteve) të tilla;

3.3. kushtet dhe procedurat që një bankë duhet të plotësojë për të marrë miratimin e BQK-së për përdorimin e një metode specifike, dhe

3.4. kërkesat shtesë të kapitalit rregullator, duke përfshirë vendosjen e raportit të leverazhit.

4. Kapitali i bankës përbëhet nga kapitali i klasës së parë dhe kapitali i klasës së dytë, si dhe të çdo forme tjetër të kapitalit të përcaktuar nga BQK-ja.

5. BQK-ja përcakton mënyrën se si kërkesat e kapitalit rregullator të këtij neni zbatohen në baza grupore nga një grup bankar.

6. BQK-ja përcakton me instrumente rregullatore përdorimin e vlerësimeve kreditore të përcaktuara nga institucionet për vlerësim kreditor për qëllim të llogaritjes së mjeteve (aseteve) të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor

7. BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme, mund në çdo kohë të kërkojë nga bankat të mbajnë nivelin e kapitalit më lartë se kërkesat minimale të specifikuara me akte ligjore, nënligjore apo urdhëresa.

Neni 22

Adekuatshmëria e kapitalit të brendshëm

1. Bankat duhet të kenë dhe të zbatojnë strategji dhe procedura të përshtatshme, efektive dhe gjithëpërfshirëse për të vlerësuar dhe mbajtur në mënyrë të vazhdueshme shumat, llojet dhe shpërndarjen e kapitalit të tyre të brendshëm.
2. BQK-ja mund të kërkojë në baza individuale dhe të konsoliduara procedurat e vlerësimit, përfshirë metodën dhe afatet kohore për raportimin e adekuatshmërisë së kapitalit të brendshëm të bankës si dhe llogaritjen e kapitalit të brendshëm.

Neni 23

Raporti i leverazhit

1. Raporti i leverazhit vepron si një masë plotësuese e besueshme ndaj kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik, për të kufizuar rritjen e leverazhit në sektorin bankar për të evituar proceset destabilizuese të deleverazhit që mund të dëmtojnë sistemin më të gjerë financiar dhe ekonominë.
2. Bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të llogarisin raportin e leverazhit në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga BQK-ja.

Neni 24

Kufizimet në ekspozimet e mëdha dhe koncentrimin e depozitave për bankat

1. Shuma e përgjithshme maksimale e principalit të ekspozimeve kreditore, e shprehur si përqindje e kapitalit të klasës së parë, që një bankë lejohet të jetë zotuar ose ketë aktive në ose për përfitim të ndonjë personi të vetëm apo të një grupi të personave të ndërlidhur nuk duhet të jetë më e lartë se njëzetë e pesë për qind (25%).
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, bankat për të lejuar ekspozime mbi pesëmbëdhjetë për qind (15%) të kapitalit të klasës së parë duhet të marrin aprovim paraprak nga BQK në nivel të bankës, varësisht nga profili i rrezikut, pozicionit në tregun financiar, në proporcion me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të saj, si dhe ndaj rreziqeve që është ose mund të jetë e ekspozuar gjatë dhënies së kredive sikurse përcaktohet nga BQK me rregullore të veçantë.
3. Ekspozimi i bankës ndaj një personi të vetëm ose grupi të personave të ndërlidhur do të konsiderohet si ekspozim i madh nëse është i barabartë ose më i madh sesa dhjetë për qind (10%) e kapitalit të klasës së parë.
4. Shuma e përgjithshme maksimale e ekspozimeve të mëdha e shprehur si përqindje e kapitalit të klasës së parë, nuk duhet të jetë më e lartë se treqind për qind (300%) në çdo kohë ose një përqindje më të vogël siç përcaktohet me rregullore nga BQK.
5. Shuma e përgjithshme e investimeve për llogari të bankës në instrumente financiare si letra me vlerë, fonde investive, depozita që fitojnë interes ose të ngjashme, e që rregullohen nga një juridiksion tjetër prej atij të Republikës së Kosovës, nuk mund të jetë më e lartë se

njëqind për qind (100%) e kapitalit të klasës së parë. Përjashtimet nga ky limit mund të bëhen vetëm me aprovim paraprak nga BQK-ja për llogaritë nostro dhe asetet e peshuara me rrezik zero për qind 0% sipas kërkesave të BQK.

6. BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore përjashtimet nga kufizimet e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni.

7. Politikat e bankës për rrezikun kreditor si minimum duhet të kërkojnë miratimin e bordit për çdo ekspozim të madh.

8. Një bankë nuk mund të mbajë depozita nga çfarëdo fonde një burimore në shumë më të madhe se njëzet për qind (20%) të depozitave të saj të përgjithshme.

9. Pavarësisht nga përcaktimet e këtij neni, BQK-ja rezervon të drejtën që në çdo kohë sipas gjykimit të saj të kërkojë nga bankat që të zbresin ekspozimet në limite më të ulëta.

10. BQK-ja përcakton me rregullore në mënyrë të detajuar mënyrën e trajtimit të ekspozimeve të mëdha nga bankat dhe grupet bankare.

Neni 25

Ekspozimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën

1. Asnjë bankë nuk duhet të hyjë në transaksione me ose për përfitim të një personi që është i ndërlidhur me bankën, nëse në një transaksion të tillë do të hyhej në kushte dhe afate më pak, ose fare të pafavorshme, me ose për përfitim të personave që nuk janë të ndërlidhur me bankën.

2. Banka zbaton kufizimet e mëposhtme për ekspozimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën, në baza individuale dhe të konsoliduara:

2.1. gjithsej ekspozimi i bankës ndaj personave të ndërlidhur me bankën, duke përfshirë ekspozimin ndaj subjekteve të varura të saj, që operojnë në Republikën e Kosovës dhe që i nënshtrohen mbikëqyrjes së konsoliduar të BQK-së, nuk mund të tejkalojnë shumën prej dhjetë për qind (10%) të kapitalit të klasës së parë të bankës në nivel të përgjithshëm (agregat). Përjashtimet nga ky limit mund të bëhen vetëm për ekspozimet ndërbankare në llogaritë nostro të nevojshme për procesimin e pagesave dhe shlyerjeve, sipas kërkesave të BQK;

2.2. gjithsej shuma e ekspozimeve të një banke ndaj subjekteve të varura të saj që operojnë në Republikën e Kosovës dhe që i nënshtrohen mbikëqyrjes së konsoliduar të BQK-së nuk mund të tejkalojë njëzet e pesë për qind (25%) të kapitalit të klasës së parë të bankës në nivel të përgjithshëm (agregat);

2.3. gjithsej ekspozimi ndaj një personi që është anëtar i Bordit të Drejtorëve, komiteteve të bordeve ose menaxhmentit të lartë, duke përfshirë anëtarët që lidhen me ta sipas përkufizimit të përcaktuar me nenin 3. nën-paragrafin 1.54 të këtij ligji, nuk mund të tejkalojë një për qind (1%) të kapitalit të klasës së parë dhe nuk mund të

tejkalojë pesë për qind (5%) të kapitalit të klasës së parë në nivel të përgjithshëm (agregat);

2.4. banka nuk mund të miratojë hua për aksionarët e saj gjatë tre (3) viteve të para të veprimtarisë së saj, përveç nëse me shkrim BQK aprovon një afat tjetër.

3. BQK-ja ushtron liri veprimi për të vendosur nga rasti në rast, kufizime më të ashpra për ekspozimet ndaj personave të ndërlidhur dhe/ose për të zbritur ekspozimet e tilla nga kapitali gjatë vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

4. Ekspozimet e çdo banke ndaj çdo personi të ndërlidhur me bankën duhet t'i nënshtrohen kushteve të tilla shtesë ose kufizimeve siç përcaktohen me rregullore ose urdhër nga BQK-ja.

Neni 26

Ekspozimet për punonjësit e bankave

Banka nuk duhet të ekspozohet ndaj një punonjësi të saj, ose për përfitimin e tij, duke tejkualuar kufizimet e përcaktuara nga BQK-ja me rregullore.

Neni 27

Ekspozimet në valutë të huaj

BQK-ja mund të përcaktojë ekspozimet maksimale të bankave në valutë të huaj. Maksimumi mund të zbatohet për ekspozimet në valutë të huaj në përgjithësi, ndaj një valute të caktuar ose valutave të caktuara, ose për të dyja në formë të kombinuar.

Neni 28

Klasifikimi i asetëve financiare dhe zhvlerësimi

1. Çdo bankë duhet të mbajë rezerva adekuate për amortizimin ose zhvlerësimin e asetëve të saj.

2. Çdo bankë duhet të zhvillojë dhe mbajë politika dhe procedura të shkruara lidhur me klasifikimin dhe vlerësimin e asetëve dhe ndarjen e provizioneve që duhet të bëhen në bazë të klasifikimeve dhe vlerësimeve të tilla.

3. Të gjitha bankat duhet të klasifikojnë të gjitha ekspozimet kreditore dhe të ndajnë rezerva për humbjet kreditore në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") ashtu siç kërkohet me rregullore nga BQK-ja.

Neni 29

Kërkesat për degët e bankave të huaja

1. Çdo degë e bankës së huaj që operon në Kosovë duhet t'i mbajë kërkesat më të larta sesa detyrimet në raport me banorët e Kosovës në shumën e specifikuar me rregullore ose urdhëresë të BQK-së.

2. Çdo degë e bankës së huaj që operon në Kosovë, duhet të mbajë një Depozitë Ekuivalente me Kapitalin jo më pak se dhjetë milion (10.000.000) Euro në para të gatshme, apo një shumë më të madhe siç specifikohet me rregullore apo urdhëresë të BQK-së. Kjo depozitë duhet të mbahet në BQK.
3. Depozita duhet të mbetet në kujdestari të BQK-së përderisa banka e huaj operon një degë në Kosovë përveç nëse BQK-ja ka miratuar një marrëveshje tjetër.
4. Kërkesat për minimumin e kapitalit rregullator të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji nuk zbatohen për degët e bankave të huaja në Kosovë.
5. Shuma e përgjithshme maksimale e ekspozimeve, e shprehur si përqindje e Depozitit Ekuivalent të Kapitalit, që një degë e bankës së huaj lejohet të japë ose të ketë në ose për përfitim të ndonjë personi të vetëm apo të një grupi të personave të ndërlidhur duhet të jetë e kufizuar në pesëmbëdhjetë për qind (15%) ose në përqindje tjetër siç përcaktohet me rregullore të BQK-së. Degët e bankave të huaja për të lejuar ekspozime deri në njëzet e pesë për qind (25%) të Depozitit Ekuivalent të Kapitalit duhet të marrin aprovim paraprak nga BQK.
6. Shuma e përgjithshme maksimale e ekspozimeve të mëdha e shprehur si përqindje e Depozitit Ekuivalent të Kapitalit nuk duhet të jetë më e lartë se treqind për qind (300%) në çdo kohë, ose një përqindje më të vogël siç përcaktohet me rregullore.
7. Ekspozimi i degës së bankës së huaj ndaj një personi të vetëm ose grupi të personave të ndërlidhur do të konsiderohet si ekspozim i madh nëse është i barabartë ose më i madh sesa dhjetë për qind (10%) e Depozitit Ekuivalent të Kapitalit.
8. Një degë e bankës së huaj nuk mund të mbajë depozita nga çfarëdo fonde një burimore në shumë më të madhe se njëzet për qind (20%) të depozitave të saj të përgjithshme.
9. Pavarësisht nga përcaktimet e këtij neni, BQK-ja rezervon të drejtën që në çdo kohë sipas gjykimit të saj të kërkojë nga degët e bankave të huaja, që të zbresin ekspozimet në limite më të ulëta.
10. BQK-ja do të përcaktojë me rregullore në mënyrë të detajuar mënyrën e trajtimit të ekspozimeve të mëdha nga degët e bankave të huaja.

Neni 30

Dividentët dhe shpërndarjet tjera të kapitalit

1. Asnjë bankë nuk duhet të paguajë ndonjë dividendë apo të bëjë ndonjë shpërndarje tjetër të kapitalit pa miratimin e BQK-së. Në asnjë rrethanë nuk jepet miratimi, nëse sipas vlerësimit të BQK-së, pas kësaj shpërndarje, banka do të bie nën kapitalin minimal të paguar të përcaktuar me nenin 19 të këtij ligji ose nën kapitalin rregullator që kërkohet sipas nenit 21 të këtij ligji apo me rregullore ose urdhëresë të BQK-së.
2. Përveç kriterëve të parapara në paragrafin 1. të këtij neni, banka nuk mund të paguajë dividendë apo të bëjë ndonjë shpërndarje tjetër të kapitalit për rastet si në vijim:

2.1. nëse banka dështon të plotësojë kërkesat e likuiditetit sikurse përcaktohen me rregullore të BQK-së;

2.2. nëse për arsye të pagesës së dividendës apo ndonjë shpërndarje tjetër të kapitalit, banka nuk do të jetë në gjendje të plotësojë kërkesat e likuiditetit sikurse përcaktohen me rregullore të BQK-së;

2.3. nëse banka ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me urdhëresat e BQK-së për të eliminuar parregullsitë rregullative dhe ligjore;

2.4. nëse pasqyra e të ardhurave të bankës për periudhën raportuese paraqet rezultat negativ (humbje);

2.5. nëse fitimet e bankës nuk janë në përputhje dhe nuk mbështesin rreziqet e marra nga banka për profilin e biznesit të bankës sipas gjykimit të BQK-së.

2.6. nëse sipas gjykimit të BQK-së banka ka nevojë të kapitalizohet, rrisë reziliencën dhe qëndrueshmërinë financiare, si shtesë të kapitalit apo ngjashëm.

3. Asnjë degë e bankës së huaj nuk duhet të paguajë ndonjë dividendë apo të bëjë ndonjë shpërndarje tjetër pa miratimin e BQK-së.

4. Dega e bankës së huaj nuk mund të paguajë dividendë apo të bëjë ndonjë shpërndarje tjetër të kapitalit për rastet si në vijim:

4.1. Nëse dështon të plotësojë kërkesat e likuiditetit sikurse përcaktohen me rregullore të BQK-së;

4.2. Nëse për arsye të pagesës së dividendës apo ndonjë shpërndarje tjetër të kapitalit, nuk do të jetë në gjendje të plotësojë kërkesat e likuiditetit sikurse përcaktohen me rregullore të BQK-së;

4.3. Nëse ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me urdhëresat e BQK-së për të eliminuar parregullsitë rregullative dhe ligjore;

4.4. Nëse pasqyra e të ardhurave për periudhën raportuese paraqet rezultat negativ (humbje);

4.5. Nëse fitimet nuk janë në përputhje dhe nuk mbështesin rreziqet e marra nga dega e bankës së huaj për profilin e biznesit të saj sipas gjykimit të BQK-së;

4.6. Nëse pagesa e dividendës apo ndonjë shpërndarje tjetër do të ndikonte që vlera e DEK të jetë nën kërkesat fillestare të kërkuara prej dhjetë (10) milionë euro apo ndonjë shume tjetër rregullative të përcaktuar nga BQK-ja;

4.7. Nëse sipas gjykimit të BQK-së dega e bankës së huaj duhet të konvertohet në një subjekt të varur dhe ka nevojë të kapitalizohet, rrisë reziliencën dhe qëndrueshmërinë financiare.

Neni 31 **Kërkesat për likuiditet**

1. BQK-ja përcakton me rregullore ose urdhëresë kërkesat për likuiditet për bankat dhe grupet bankare.
2. Kërkesat për likuiditet përfshijnë shumën e përgjithshme minimale të aseteve (pasurive) likuide apo të kategorive specifike të aseteve (pasurive) që mbahen nga banka.
3. Çdo bankë dhe çdo grup bankar duhet të zhvillojë politika dhe procedura me shkrim për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
4. Kur veprimtaria e bankës në valutë të huaj është e konsiderueshme ose kur rreziku i vendit dhe rreziku i transferimit të një valute është i konsiderueshëm, për këto valuta duhet të zbatohen analiza dhe monitorime të veçanta të përcaktuara nga BQK-ja.
5. Një kopje e politikave dhe procedurave nga paragrafi 3. i këtij neni duhet të rishikohet për çdo vit nga drejtorët e bankës dhe duhet t'i dorëzohet BQK-së. Versionet e përditësuara të politikave dhe procedurave po ashtu i dorëzohet BQK-së.
6. BQK-ja mund të kërkojë në baza individuale dhe të konsoliduara, procedurat e vlerësimit, përfshirë metodën dhe afatet kohore për raportimin mbi adekuatshmërinë e likuiditetit të brendshëm të bankës dhe llogaritjen e likuiditetit të brendshëm.

NËNKAPITULLI IV **QEVERISJA KORPORATIVE DHE PRONËSIA E BANKAVE**

Neni 32 **Organizimi**

1. Të gjitha bankat, me përjashtim të degëve të bankave të huaja, duhet fillimisht të regjistrohen si shoqëri aksionare në agjencinë përkatëse përgjegjëse për regjistrin tregtar, përfshirë regjistrimin e aksionarëve dhe pronarëve përfitues. Aksioni në një shoqëri aksionare është pronë e aksionarit.
2. Me qëllim të funksionimit si bankë sipas këtij ligji, BQK-së duhet t'i paraqitet dëshmia e regjistrimit sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe ndërsa aspektet e rregullimit të qeverisjes korporative bëhet vetëm sipas këtij ligji, ligjit përkatës për BQK-në dhe instrumenteve tjera rregullatore të BQK-së.

Neni 33

Akti i Themelimit dhe Statuti

1. Të gjitha bankat që operojnë në Kosovë duhet ta kenë aktin e themelimit dhe/ose statutin, një kopje e të cilave është miratuar nga BQK. Asnjë bankë, përveç bankës së huaj të licencuar për të operuar më një ose më shumë degë në Kosovë, nuk mund të ndryshojë aktin e saj të themelimit ose aktet nënligjore pa miratimin paraprak me shkrim të BQK-së.
2. Banka e huaj me degë ose subjekt të varur të licencuar në Kosovë duhet ta njoftojë BQK-në për çdo ndryshim në aktin e saj të themelimit apo në dokumentacionin ekuivalent të themelimit ose statutin brenda tridhjetë (30) ditëve nga data efektive e ndonjë ndryshimi.
3. Çdo bankë, përfshirë degët e bankave të huaja, në dokumentacionin e dorëzuar në BQK duhet gjithmonë të kenë një kopje të vërtetuar të aktit të themelimit apo dokumentacionit ekuivalent të themelimit, statutin dhe listën e zyrtarëve të bankës bashkë me ekzemplarin e nënshkrimeve dhe përshkrimin e kufizimeve të kompetencave të tyre, të cilët janë të autorizuar ndërmarrin veprime në emër dhe për llogari të bankës për veprimtaritë përkatëse.

Neni 34

Pavarësia

1. Bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të menaxhohen dhe qeverisen bazuar në parimet e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë dhe të ndershme. Asnjë person përfshirë autoritetet publike nuk mund të ndërhyjnë në formë të pa autorizuar për të ndikuar në menaxhimin ose strukturat qeverisëse të bankës apo të degës së bankës së huaj, përveç rasteve kur një ndërhyrje e tillë është në pajtueshmëri me kërkesat e kornizës ligjore të BQK-së, ekzekutimit të vendimeve nga organet gjyqësore apo BQK-së në pajtim me këtë ligj.
2. Ndjekja e udhëzimeve ose praktikave të grupeve bankare ndërkombëtare që funksionojnë në kuadër të legjislacionit të Bashkimit Evropian, nuk përbën ndërhyrje në kuptim të paragrafit 1. të këtij neni, përderisa janë në pajtim me këtë ligj, rregullativën dhe kërkesat e BQK-së ose ligjeve tjera relevante të Kosovës.

Neni 35

Struktura Organizative

1. Banka duhet të krijojë dhe mbaj një strukturë të qartë organizative që konsiston në linja të definuara mirë, të qëndrueshme dhe transparente të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies, të krijuara në mënyrë që të parandalohen konfliktet e mundshme të interesit, si dhe të:
 - 1.1. mundësojë komunikimin dhe bashkëpunimin efektiv në të gjitha nivelet organizative, duke përfshirë shpërndarjen e duhur të informacionit brenda bankës;
 - 1.2. parandalojë dhe adresoj në formë dhe kohë të duhur konfliktin e interesit;
 - 1.3. sigurojë transparencë dhe dokumentim të duhur të proceseve vendimmarrëse.

2. BQK mund të përcaktoj kërkesa shtesë për strukturën organizative të bankave përmes instrumenteve tjera rregullative.

Neni 36 **Organet e Bankës**

1. Organet e bankës janë:

1.1. Kuvendi i Përgjithshëm i Aksionarëve;

1.2. Bordi i Drejtorëve, dhe

1.3. Menaxhmenti i Lartë.

2. Kompetencat e organeve të bankës përcaktohen në këtë ligj dhe në statut të bankës.

Neni 37 **Përbërja e kuvendit të aksionarëve**

1. Kuvendi i Aksionarëve të bankës përbëhet nga aksionarët e bankës.

2. Aksionarët ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në mënyrë direkte apo përmes përfaqësuesve të tyre.

3. Çdo aksionar i cili është vendosur në listën e aksionarëve në Regjistër, tridhjetë (30) ditë para datës së seancës së Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve kanë të drejtë vote në Kuvendin e Përgjithshëm të Aksionarëve.

Neni 38 **Kompetencat e Kuvendit të Aksionarëve**

1. Kuvendi i Aksionarëve ka kompetencat si në vijim:

1.1. themelimin e Kapitalit të paguar të bankës përmes emetimit ose rritjes së vlerës së aksioneve të zakonshme ose të preferuara;

1.2. emërimin e auditorit të jashtëm;

1.3. aprovimin e raportit vjetor financiar, së bashku me raportet e auditorit të jashtëm dhe Bordit të Drejtorëve;

1.4. shpërndarjen e fitimit dhe pagesën e dividendës;

1.5. mënyrën e mbulimit të humbjeve;

1.6. konsolidimin me ndërmarrjet tjera dhe bashkimin dhe përvetësimin e ndërmarrjeve tjera me bankën, duke përfshirë konsolidimin ose bashkimin dhe përvetësimin e subjekteve të varura;

- 1.7. ndarjen dhe përfundimin e veprimtarive të bankës;
- 1.8. blerjen, shkëmbimin tregtar, lizingun dhe transaksionet tjera të lidhura me pronën, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet subjekteve të varura, brenda vitit afarist, deri në shkallën që tejkalon njëzet për qind (20%) të vlerës në libra të aseteve të bankës;
- 1.9. zgjedhjen dhe shkarkimin nga detyra të anëtarëve të bordit të drejtorëve;
- 1.10. themelimin, riorganizimin dhe likuidimin e detyruar të subjekteve të varura dhe miratimin e akteve të tyre përkatëse të themelimit;
- 1.11. kompensimet për anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe anëtarëve të jashtëm të Bordit të Drejtorëve;
- 1.12. miratimin, ndryshimet dhe plotësimet e akteve të themelimit dhe/ose statutit, dhe
- 1.13. çështjet tjera me rëndësi për funksionimin e veprimtarisë së bankës në përputhje me këtë ligj dhe aktin e themelimit dhe/ose statutit të bankës.

Neni 39 **Kuvendi i përgjithshëm i Aksionarëve**

1. Organizimi i Kuvendit të përgjithshëm të aksionarëve të bankës bëhet si në vijim:
 - 1.1. kryesohet nga Kryesuesi, i cili zgjidhet në fillim të seancës së Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve;
 - 1.2. emëron anëtarët e Komitetit Votues të Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve;
 - 1.3. kryesuesi dhe shumica e anëtarëve e Bordit të Drejtorëve dhe së paku një anëtar i Menaxhmentit të Lartë duhet të jenë të pranishëm gjatë seancës së Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve;
 - 1.4. anëtarët e Bordit të Drejtorëve në një bankë që përbëhet nga pesë (5) a më pak aksionarë nuk janë të obliguar të jenë prezent në seancën e Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve;
 - 1.5. në një bankë me një aksionar të vetëm, kompetencat e Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve ushtrohen nga aksionari i vetëm;
 - 1.6. duhet të mbahet së paku një (1) herë në vit, dhe
 - 1.7. duhet të publikohet së paku në njëerën nga gazetatat ditore në formën e printuar apo elektronike brenda Kosovës, jo më vonë se dhjetë (10) ditë para datës së përcaktuar për mbajtjen e mbledhjes. Ky paragraf nuk aplikohet në rastet kur banka ka vetëm një aksionar të vetëm.

2. Shumica e anëtarëve të bordit të drejtorëve mund të votojnë për të mbajtur kuvend të përgjithshëm të jashtëzakonshëm të aksionarëve në pajtim me këtë nen. Megjithatë, çdo aksionar duhet të njoftohet për Kuvendin e Përgjithshëm të Jashtëzakonshëm të Aksionarëve, duke përfshirë qëllimin e saj dhe rendin e propozuar të ditës. Përveç kësaj, çdo veprim i ndërmarrë në Kuvendin e Përgjithshëm të Jashtëzakonshëm të Aksionarëve duhet të miratohet nga dy të tretat (2/3) e numrit të aksioneve të përfaqësuara.

3. Kërkesa për caktimin e Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve mund të paraqitet nga:

3.1. aksionari ose grupi i aksionarëve që përfaqëson më shumë se dhjetë për qind (10%) të numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote;

3.2. dy (2) e më shumë anëtarë të Bordit të Drejtorëve, apo

3.3. komiteti i Auditimit të Bordit.

4. Kuvendi i Përgjithshëm i Aksionarëve mund të marrë vendime vetëm nëse votohet nga aksionarët që përfaqësojnë më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të aksioneve me të drejtë vote përfaqësohen personalisht apo nëpërmjet të autorizuarve.

5. Votimit në Kuvendin e Përgjithshëm të Aksionarëve bëhet në formën e mëposhtme:

5.1. Kuvendi i Përgjithshëm i Aksionarëve merr vendime me shumicë aksionesh me të drejtë vote;

5.2. Komiteti Votues përcakton rezultatet e votimit, dhe

5.3. procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi i Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve dhe personi përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit.

Neni 40

Vendimmarrja me autorizim

1. Vendimmarrja nëpërmjet të autorizuarit të aksionarit bëhet si në vijim:

1.1. i autorizuari i aksionarit duhet të ketë autorizim për përfaqësim të nënshkruar nga aksionari që është person fizik ose përfaqësues i aksionarit që është person juridik;

1.2. autorizimi me shkrim i dorëzohet Bordit Votues;

1.3. komiteti Votues konfirmon vlefshmërinë e autorizimit dhe identitetin e të autorizuarit.

2. Nëse një aksionar ose i autorizuari i tij, brenda pesë (5) ditëve nga dita e Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve, ia dorëzon Komitetit Votues deklaratën e vërtetuar të aksionarëve, dokumentin publik ose ndonjë dëshmi tjetër të verifikuar që mohon

vlefshmërinë e autorizimit për Komitetin Votues, votat e bazuara në atë autorizim deklarohen si të pavlefshme dhe informohet me shkrim Bordin e Drejtorëve.

3. Me rastin e informimit, Bordi i Drejtorëve pezullon zbatimin e vendimit, miratimi i të cilit kategorikisht është ndikuar nga votat e pavlefshme dhe thërret Kuvendin e Përgjithshëm të Aksionarëve për përsëritjen e vendimmarrjes lidhur me këto çështje jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të njoftimit të Komitetit Votues për votat e pavlefshme.

Neni 41

Procesverbali i Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve

1. Procesverbali i Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve:

1.1. duhet të përmbajë së paku informata për rendin e ditës, vendimet, të dhënat e votimit dhe kundërshtimet e aksionarëve dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ndaj vendimeve të Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve;

1.2. Bordi i Drejtorëve sigurohet se procesverbali nxirret jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e organizimit të Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve.

Neni 42

Kontestimi i vendimeve të Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve

1. Një vendim i Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve është i pavlefshëm nëse:

1.1. Kuvendi i Përgjithshëm i Aksionarëve nuk është thirrur sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji;

1.2. nuk është evidentuar në procesverbal të miratuar;

1.3. pavlefshmëria përcaktohet me vendim të gjykatës.

2. Procedura për kontestimin e vlefshmërisë së vendimit të Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve në gjykatë, mund të iniciohet nga:

2.1. aksionari apo aksionarët që përfaqësojnë minimumin prej tridhjetë e tre për qind (33%) të pronësisë dhe i cili apo të cilët kanë marrë pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm të Aksionarëve, kundërshtimi i të cilit apo të cilëve ndaj vendimit është evidentuar në procesverbal, ose nuk është evidentuar në formë të saktë, apo

2.2. aksionari i cili nuk ka qenë prezent në Kuvendin e Përgjithshëm të Aksionarëve për shkak të caktimit të Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve në kundërshtim me dispozitat e nenit 39 të këtij ligji;

2.3. Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Lartë dhe çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të Lartë, nëse zbatimi i vendimit do të paraqiste një vepër penale apo do t'i shkaktonte dëm bankës.

3. Procedurat e parapara sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni mund të iniciohen jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve.

4. Në procedurat e parapara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, banka përfaqësohet nga Kryeshefi Ekzekutiv ose nga ndonjë anëtar tjetër i Menaxhmentit të Lartë, sipas autorizimit të dhënë nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 43 **Bordi i Drejtorëve**

1. Çdo bankë administrohet nga Bordi i Drejtorëve, dhe i nënshtrohet kërkesave të mëposhtme:

1.1. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga numri tek prej jo më pak se pesë (5) anëtarë me të drejtë vote. Së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë drejtorë të pavarur dhe së paku njëri prej tyre, duhet të jetë banor dhe shtetas i Kosovës;

1.2. Bordi i Drejtorëve zgjedhet nga aksionarët e bankës në Kuvendin e Përgjithshëm të Aksionarëve dhe është përgjegjës për krijimin e politikave të tij dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

1.3. Bordi i Drejtorëve zgjedh kryesuesin nga radhët e anëtarëve të vet dhe vetëm Kryeshefi Ekzekutiv nuk mund të jetë kryesues;

1.4. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve përfshirë Kryeshefin Ekzekutiv zgjedhen për mandat katër (4) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të cilët rizgjedhen për dy (2) mandate vijuese ose shërbejnë për më shumë se dymbëdhjetë (12) vite, nuk do të konsiderohen të pavarur sipas përcaktimeve të këtij neni;

1.5. Kryeshefi Ekzekutiv shërben në Bord sipas detyrës zyrtare dhe pa të drejtë vote, për aq kohë sa ai ose ajo e mban atë post, ndërsa anëtarët tjerë ekzekutiv apo punëtorët tjerë të bankës nuk mund të shërbejnë në Bordin e Drejtorëve. Kryeshefi Ekzekutiv duhet të jetë banor i Kosovës;

1.6. Bordi i Drejtorëve nuk mund t'ia delegoj përgjegjësitë e veta të tjerëve;

1.7. Emrat e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve mbahen në një regjistër të BQK-së;

1.8. Anëtarët e Bordit konsiderohen me mandat efektiv kur ata aprovohen nga BQK-ja. Procesi i aprovimit është i zbatueshëm për çdo ri-emërim apo vazhdim të mandatit.

2. Kompensimi i anëtarëve të Bordit, së bashku me kompensimin e Menaxhmentit të Lartë të bankës merret parasysh si pjesë e ekzaminimit të gjendjes së bankës nga BQK-ja, në pajtim me nenin 80 të këtij Ligji, për të shqyrtuar nëse kompensimi paraqet një praktikë të pasigurt dhe të pamatur të bankës.

3. Drejtori konsiderohet i pavarur për qëllimet e këtij neni, nëse është i pavarur nga menaxhmenti dhe aksionarët, dhe gjykimin e ushtron vetëm në dobi të bankës, pa ndonjë konflikt të interesit që lind nga raportet e tij me bankën dhe me palët e ndërlidhura me bankën dhe nëse nuk ka shërbyer për më shumë se tri(3) mandate ose dymbëdhjetë (12) vite. Drejtori i pavarur mund të mbajë aksione drejtpërsëdrejti në bankë sipas kufizimit për posedim të aksioneve që mund të caktohet nga BQK-ja.

4. Aksionari ose një grup aksionarësh me së paku pesë për qind të (5%) të aksioneve me të drejtë vote mund ta nominojë një kandidat për anëtar të Bordit të Drejtorëve, apo të bëjë kërkesë në kuvendin e aksionarëve për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Drejtorëve.

5. Çdo propozim i bërë sipas paragrafit 4. të këtij neni dorëzohet me shkrim jo më vonë se tetë (8) ditë nga dita e publikimit të njoftimit për caktimin e Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve që ka në rendin e saj të ditës zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

6. Kandidatët për anëtarë të Bordit të Drejtorëve japin deklaratë me shkrim para votimit për pranimin e nominimit të tyre.

7. Në zgjedhjen apo shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, çdo aksionar mund të hedhë një votë për çdo aksion me të drejtë vote. Të gjithë aksionarët me të drejtë vote mund t'i hedhin të gjitha votat për një person ose t'i shpërndajnë votat e tyre për një a më shumë persona.

8. Bordi i Drejtorëve do të hartojë politika të kompensimit që janë në përputhje dhe promovojnë menaxhim të shëndoshë dhe efektiv të rrezikut dhe që nuk inkurajojnë marrjen e rrezikut që tejkalon nivelin e toleruar të rrezikut të bankës me përfitim në shpërblime apo kompensime për Bordin apo menaxhmentin e lartë. BQK do të përcaktojë me rregullore kriteret që lidhen me kompensimin e Bordit të Drejtorëve, Menaxhmentit të lartë dhe personelit sipas funksioneve përkatëse të bankës.

9. Ky nen nuk zbatohet për degët e bankave të huaja, përveç nëse BQK e kërkon këtë përmes ndonjë instrumenti rregullativ.

Neni 44 **Kompetencat e Bordit të Drejtorëve**

1. Bordi i Drejtorëve të bankës ka këto kompetenca:

1.1. miraton strategjinë e bankës dhe mbikëqyrë operacionet afariste të bankës;

1.2. mbikëqyrë punën e Menaxhmentit të Lartë;

1.3. miraton raportin e menaxhmentit të lartë rreth veprimtarive afariste të bankës në bazë të bilancit gjysmë-vjetor, pasqyrës së fitimit dhe humbjes, bilancit vjetor të gjendjes dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;

1.4. paraqet raportin vjetor në kuvendin e përgjithshëm të aksionarëve rreth veprimtarisë afariste të bankës, i cili përfshinë raportet e auditimit të brendshëm dhe

të jashtëm, raportin e punës së bordit të drejtorëve si dhe planin e veprimtarisë afariste për vitin e ardhshëm afarist;

1.5. emëron Menaxhmentin e Lartë të bankës;

1.6. propozon shpërndarjen dhe mënyrën e shfrytëzimit të fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve;

1.7. miraton blerjen, shitjen, shkëmbimin, lizingun dhe transaksionet tjera pronësore drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet subjekteve të varura gjatë vitit afarist që janë të barabarta me ose tejkalojnë dhjetë për qind (10%) të kapitalit të bankës;

1.8. siguron themelimin dhe mbarëvajtjen e kontrolleve të brendshme të duhura në bankë;

1.9. siguron kryerjen e duhur të auditimeve të brendshme dhe të jashtme;

1.10. siguron politika adekuate të caktimit të provizioneve për humbjet nga kreditë, si dhe bën themelimin e rezervave të nevojshme nga fitimi neto i bankës dhe deklarimin e dividendës;

1.11. krijon komisione ad-hoc dhe përcakton përbërjet dhe detyrat e tyre;

1.12. thërret Kuvendin e Përgjithshëm të Aksionarëve;

1.13. miraton aktet e brendshme për veprimtaritë biznesore dhe politikave tjera të bankës, dhe

1.14. vendos për çështjet që në mënyrë specifike adresohen me këtë ligj, ligjet e tjera të aplikueshme dhe/apo statutin e tyre.

2. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me interesin e aksionarëve dhe të bankës dhe nuk mund të kryejnë ndonjë veprimtari tjetër që do të ishte në konkurrencë me veprimtaritë e bankës.

3. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve i raportojnë bordit të drejtorëve për çdo interes personal apo financiar brenda personit juridik, me të cilin banka ka hyrë ose ka ndërmend të hyjë në marrëdhënie afariste. Në një rast të tillë, ata mund të marrin pjesë në diskutime ose të marrin vendim për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e bankës dhe personave tjerë juridik me të cilët kryesuesi dhe anëtari i Bordit të Drejtorëve ka interes direkt ose indirekt financiar.

4. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve janë përgjegjës individualisht ose kolektivisht për dëmet e shkaktuara që rezultojnë nga shkelja e këtij neni.

5. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve kanë të drejtë t'i kërkojnë të gjitha të dhënat rreth veprimtarive afariste dhe prezencës së anëtarëve të Menaxhmentit të Lartë në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.

Neni 45 **Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve**

1. Mbledhja e bordit të drejtorëve mbahet sipas nevojës dhe së paku një herë në tre (3) muaj. Së paku dy (2) herë në vit takime tremujore duhet të mbahen në Kosovë. Përveç takimit vjetor që mbahet në Kosovë, të gjitha takimet tjera mund të mbahen me anë të telekonferencës ose mjeteve tjera elektronike, nëse kjo metodë shprehimisht është e përcaktuar dhe rregulluar në statutin e bankës.
2. Kryesuesi i bordit të drejtorëve thërret mbledhjet me kërkesë të kryeshefit ekzekutiv të bankës ose të dy (2) anëtarëve të bordit të drejtorëve, ose personit që është i autorizuar për thirrjen e mbledhjes me statut të bankës, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve mund të thirren në çdo kohë nga Kryesuesi i Bordit, apo, në rast të pamundësisë së tij për të bërë thirrjen, thirrja mund të realizohet nga çdo Drejtor përmes kërkesës me shkrim drejtuar tek Kryesuesi i Bordit. Personi që thërret një mbledhje të jashtëzakonshme duhet të njoftojë për kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes së Bordit. Të gjitha dispozitat e këtij neni zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve.
3. Vendimet e Bordit të Drejtorëve janë të vlefshme atëherë kur shumica e anëtarëve të Bordit janë të pranishëm dhe votojnë qoftë fizikisht apo përmes telekonferencës ose mjeteve tjera elektronike.
4. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rastit kur në statutin e bankës parashikohet një shumicë më e lartë.
5. Mbledhjet shoqërohen me procesverbale, që duhet në mënyrë të përmbledhur të paraqesin diskutimet, dhe mënyrën e marrjes së vendimeve, të cilat shprehin edhe elementin individual dhe pavarësinë e anëtarit të bordit në mbrojtje të interesit të bankës.

Neni 46 **Komitetet e Bordit**

1. Bordi i Drejtorëve i çdo banke themelon Komitetin e Auditimit, anëtarët e të cilit zgjedhën në mesin e drejtorëve dhe së paku një anëtar i komitetit të auditimit duhet të jetë një ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit, i cili i plotëson kriteret e të qenit i përshtatshëm dhe i duhur, si dhe i pavarur në pajtueshmëri me këtë ligj dhe rregulloret e BQK-së. Të gjithë anëtarët e Komitetit të Auditimit duhet të jenë drejtorë jo-ekzekutiv, duke përfshirë anëtarin vendor të Bordit. Komiteti i Auditimit duhet që:

- 1.1. të takohet së paku çdo tre (3) muaj dhe në periudha tjera të parapara me akte nënligjore, ku së paku dy (2) nga takimet mbahen në Kosovë;
- 1.2. të rekomandoj kontabilitetin e përshtatshëm, kontrollet e brendshme operative dhe administrative;
- 1.3. të mbikëqyrë pajtueshmërinë e bankës me politikat dhe procedurat;

- 1.4. të kërkojë dhe rishikojë raportet e udhëheqësit të auditimit të brendshëm të bankës;
 - 1.5. të rekomandojë kompensimin për udhëheqësin e auditimit të brendshëm dhe punëtorëve tjerë të auditimit të brendshëm;
 - të monitorojë pajtueshmërinë me këtë ligj dhe me rregulloret ose urdhëresat në fuqi;
 - të rekomandojë emërimin e auditorit të jashtëm në përputhje me nenin 68 të këtij ligji;
 - 1.8. të monitorojë performancën e auditorit të jashtëm, të rishikojë raportin e auditorit të jashtëm rreth pasqyrave financiare të bankës dhe ta njoftojë Bordin e Drejtorëve për të gjitha të gjeturat; dhe
 - 1.9. të japë mendime Bordit të Drejtorëve lidhur me çdo çështje që i është paraqitur nga Bordi i Drejtorëve, apo të cilën Komiteti dëshiron ta adresojë.
2. Mbledhjet shoqërohen me procesverbale, që duhet në mënyrë të përmbledhur të paraqesin pikëpamjet dhe diskutimet të cilat shprehin edhe elementin individual dhe pavarësinë e anëtarit të komitetit.
 3. Çdo bankë duhet të themelojë Komitetin për Menaxhim të Rrezikut i cili përbëhet vetëm nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Komiteti për Menaxhim të Rrezikut duhet që:
 - 3.1. të takohet së paku çdo tre (3) muaj dhe në periudha tjera të parapara me akte nënligjore;
 - 3.2. të monitorojë zbatimin e politikave dhe procedurave të bankës për menaxhim të rrezikut, duke përfshirë efikasitetin dhe pavarësinë e funksioneve të menaxhimit të rrezikut brenda bankës;
 - 3.3. të monitorojë profilin e rrezikut të bankës, duke përfshirë rrezikun kreditor, të tregut, të likuiditetit, operativ, të pajtueshmërisë, të reputacionit, ligjor dhe ndonjë rreziku tjetër të bankës;
 - 3.4. të monitorojë pajtueshmërinë me këtë ligj dhe me rregulloret ose urdhëresat që kanë të bëjnë me të, dhe
 - 3.5. të japë mendime Bordit të Drejtorëve lidhur me çdo çështje që i është paraqitur nga bordi i drejtorëve, apo të cilën komiteti dëshiron ta adresojë.
 4. BQK-ja mund të kërkojë nga të gjitha ose disa banka që të kenë komitetet tjera shtesë të Bordit. Çdo bankë mund të ketë komitete tjera të Bordit të cilat mund të konsiderohen si të nevojshme dhe të përshtatshme nga Bordi i Drejtorëve.
 5. Takimet e komitetit mund të mbahen me anë të pajisjeve të telekomunikimit për atë sa anëtarët e komitetit që marrin pjesë në takim mund të dëgjohen në kohë reale me njëri tjetrin, dhe një takim i tillë është në pajtim me statutin e Bankës dhe statutin e komitetit.

6. Ky nen nuk zbatohet për degët e bankave të huaja, përveç nëse BQK e kërkon këtë me rregullore.

7. Mbledhjet shoqërohen me procesverbale, që duhet në mënyrë të përmbledhur të paraqesin diskutimet të cilat shprehin edhe elementin individual dhe pavarësinë e anëtarit të komitetit.

Neni 47 **Menaxhmenti i Lartë**

1. Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Bordi i Drejtorëve të bankës. Zëvendëskryeshefi ekzekutiv dhe Menaxherët e Lartë emërohen nga Bordi i Drejtorëve me rekomandim të Kryeshefit Ekzekutiv.

2. Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv është katër (4) vjeçar dhe mund të vazhdohet me mandat shtesë, pa kufizime sa i përket numrit të mandateve. Megjithatë, çdo ri-emërim apo vazhdim i mandatit i nënshtrohet aprovimit të BQK-së.

3. Autorizimet, përgjegjësitë, dhe kompensimi i Kryeshefit rregullohet me kontratë ndërmjet Bordit të Drejtorëve dhe me statut të bankës për aq sa është e zbatueshme. Ndërsa pozitat, autorizimet përkatëse, përgjegjësitë dhe kompensimi i menaxhmentit të lartë, përfshirë zëvendëskryeshefin ekzekutiv rregullohet me kontratë ndërmjet kryeshefit ekzekutiv dhe menaxherëve tjerë të lartë dhe me statut të bankës për aq sa është e zbatueshme. Punësimi i menaxhmentit të lartë nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv i nënshtrohet miratimit paraparak të Bordit të Drejtorëve.

4. Kryeshefi Ekzekutiv, Zëvendëskryeshefi Ekzekutiv dhe Menaxherët tjerë të Lartë nuk mund të emërohen dhe ri-emërohen pa miratimin paraparak të BQK-së.

5. Kryeshefi Ekzekutiv i bankës sipas këtij ligji mban këto përgjegjësi:

5.1. është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së bankës dhe zbatimin e strategjisë së përcaktuar afariste të bankës;

5.2. përfaqëson bankën dhe vepron si agjent i saj;

5.3. zbaton vendimet e Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionarëve, Komitetit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve;

5.4. organizon dhe menaxhon veprimtaritë e bankës;

5.5. merr vendime për të gjitha çështjet të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit të Aksionarëve, Komitetit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve të një banke, dhe

5.6. kryen funksione tjera në përputhje me ligjin, aktin e themelimit dhe/ose statutin të bankës dhe aktet tjera të përgjithshme.

6. Kryeshefi Ekzekutiv mund t'ua delegojë të tjerëve një pjesë të kompetencave të tij. Delegimi nuk e liron nga përgjegjësia Kryeshefin Ekzekutiv.

7. Menaxherët e Lartë përgjegjës për një funksion nuk mund të jenë në të njëjtën kohë përgjegjës edhe për funksione tjera të Menaxherëve të Lartë.

8. Individët e emëruar si anëtarë të Menaxhmentit të Lartë të një banke duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore të BQK-së dhe me aktet e përgjithshme të bankës.

9. Nëse BQK-ja refuzon një kërkesë për miratimin e një individi në përputhje me nenin 54 të këtij ligji, banka nuk mund të parashtojë një kërkesë tjetër për emërimin e atij individi për të njëjtën pozitë deri në eliminimin e shkaqeve të përmendura në vendimin e BQK-së për refuzimin e dhënies së miratimit.

Neni 48 **Menaxherët e Lartë**

1. Zëvendëskryeshefi Ekzekutiv zëvendëson Kryeshefin Ekzekutiv në mungesë të tij dhe, nëse banka nuk ka zëvendëskryeshef të emëruar, Kryeshefi Ekzekutiv autorizon me shkrim njërin nga menaxherët e lartë që ta zëvendësojë atë dhe t'i ushtrojë kompetencat e tij.

2. Kryeshefi ekzekutiv, Zëvendëskryeshefi Ekzekutiv dhe menaxherët e lartë i deklarojnë me shkrim, Bordit të Drejtorëve për çdo interes direkt ose indirekt me individët e ndërlidhur apo me ndonjë person juridik me të cilin banka ka hyrë ose synon të hyjë në marrëdhënie afariste.

3. Në rastin e paraparë sipas paragrafit 2. të këtij neni, Menaxherët e Lartë mund të marrin pjesë në një marrëdhënie të tillë afariste në bazë të pëlqimit me shkrim të Bordit të Drejtorëve.

4. Në rast se Kryeshefi Ekzekutiv largohet nga detyra, jep dorëheqje, vdes, bëhet i paaftë në aspekt shëndetësor ose në një mënyrë mungon në detyrat e tij pa miratimin paraprak të Bordit të Drejtorëve për një periudhë më gjatë se tridhjetë (30) ditë vijuese kalendarike, Bordi i Drejtorëve duhet ta vendosë në pozitë Zëvendëskryeshefin Ekzekutiv ose ta emërojë Kryeshef Ekzekutiv të përkohshëm nga menaxhmenti i lartë apo zyrtar i miratuar paraprakisht nga BQK në pozitën ku ka shërbyer para emërimit të përkohshëm. Emërimi i përkohshëm zgjat deri në kohën kur Bordi i Drejtorëve emëron Kryeshefin e ri Ekzekutiv, dhe lidhur me emërimin e përkohshëm njoftohet me shkrim BQK.

5. Pavarësisht paragrafit 4. të këtij neni, emërimi i përkohshëm i kryeshefit ekzekutiv nuk mund të zgjas më shumë se gjashtë (6) muaj, përveç nëse BQK miraton me shkrim një afat shtesë. Në secilin rast, ky afat shtesë nuk tejkalon kohëzgjatjen prej dymbëdhjetë (12) muaj.

Neni 49

Funksionet e kontrollit

1. Banka ose dega e bankës së huaj duhet të krijojë këto funksione të kontrollit:

- 1.1. funksioni i auditimit të brendshëm;
- 1.2. funksioni i kontrollit të rrezikut, dhe
- 1.3. funksioni i pajtueshmërisë.

2. Banka, varësisht prej madhësisë dhe kompleksitetit të saj, duhet të krijojë funksione të përhershme dhe efektive të kontrollit. Funksionet e kontrollit duhet të jenë të pavarura nga proceset dhe veprimtaritë e biznesit në të cilat rreziku ndodh apo të cilat monitorohen dhe mbikëqyren nga funksionet e kontrollit.

3. Asnjë funksion individual i kontrollit nuk mund të jetë pjesë e një funksioni tjetër të kontrollit të bankës.

4. Një bankë duhet të organizojë funksionet e saj të kontrollit në mënyrë që të mbulojë të gjitha rreziqet materiale për të cilat banka ndodhet ose mund të ekspozohet në veprimtarinë e saj.

5. Një bankë duhet të krijojë funksione të kontrollit në mënyrë që të shmanget dhe parandalohet konflikti i interesave.

Neni 50

Funksioni i Auditimit të Brendshëm

1. Bordi i Drejtorëve i një banke emëron Udhëheqësin e Funksionit të Auditimit të Brendshëm. Banka sigurohet që Udhëheqësi i Funksionit të Auditimit të Brendshëm raporton drejtpërdrejtë në Komitetin e Auditimit të Bordit të Drejtorëve. Udhëheqësi i Funksionit të Auditimit të Brendshëm nuk mund të emërohet pa miratimin paraprak të BQK-së. Shkarkimi ose dorëheqja e Udhëheqësit të Funksionit të Auditimit të Brendshëm, së bashku me arsyetimet, duhet t'i raportohet BQK-së brenda shtatë (7) ditëve të punës pas ngjarjes përkatëse.

2. Udhëheqësi i Funksionit të Auditimit të Brendshëm vepron në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti dhe i njihet autoriteti i mjaftueshëm për të pasqyruar rëndësinë e funksionit të auditimit duke i dhënë qasje të duhur te menaxhmenti dhe anëtarët e menaxhmentit, dhe për të diskutuar çështjet që lidhen me funksionet e tyre. Udhëheqësi i Funksionit të Auditimit të Brendshëm ka të drejtë të kërkoj dhe sigurojë çdo informacion apo dokumentacion të bankës.

3. Udhëheqësi i Funksionit të Auditimit të Brendshëm ose zëvendësi i tij, nëse pozita e zëvendësit ekziston, emërohen nga Bordi i Drejtorëve apo Komiteti i Auditimit të bankës dhe i raportojnë Komitetit të Auditimit.

4. Paga dhe të drejtat tjera materiale të Udhëheqësit të Funkcionit të Auditimit të Brendshëm ose zëvendësit të tij, nëse pozita e zëvendësit ekziston, përcaktohet nga Komiteti i Auditimit ndërsa kontrata e punës miratohet nga Bordi i Drejtorëve.

5. Auditori i brendshëm është përgjegjës për identifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e rrezikut në veprimtarinë e një banke, dhe përcakton nëse sistemi i kontrollit të brendshëm është funksional me qëllim të sigurimit se ato rreziqe menaxhohen në atë mënyrë që të zbuten në masën e pranueshme. Banka i siguron auditorit të brendshëm burime të mjaftueshme për t'ia mundur atij ushtrimin e përgjegjësisë së tij.

6. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, auditori i brendshëm ka autoritet për punë në formë të pakufizuar dhe të papenguar dhe është i obliguar t'i raportojë Komitetit të Auditimit të bankës.

7. Auditori i brendshëm në veçanti duhet të:

7.1. rishikojë sistemet e kontrollit të brendshëm dhe të monitorojë dhe analizoj politikat dhe procedurat në lidhje me kontabilitetin, administrimin, operacionet dhe ruajtjen e aseteve;

7.2. rishikojë planet e auditimit të brendshëm për të testuar kënaqshëm mospajtueshmëritë dhe parregullsitë bazuar në vlerësimet e rrezikut të auditorit të brendshëm;

7.3. raportojë në Komitetin e Auditimit për mospajtueshmëri dhe parregullsi së paku çdo tre (3) muaj dhe në pajtim me procedurat të përcaktuara nga Komiteti i Auditimit, dhe kur rrethanat kërkojnë raportin para Bordit të Drejtorëve si dhe BQK-së;

7.4. asistojë dhe bashkëpunojë me auditorin e jashtëm gjatë kryerjes së detyrave të tij, dhe

7.5. kryejë shqyrtime dhe detyra tjera siç mund të përcaktohen me aktet e brendshme të bankës apo sipas detyrave të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve apo Komiteti i Auditimit.

8. Auditori i brendshëm nuk ka autoritet të përfaqësojë bankën në kontrata apo të hyj në emër dhe për llogari të bankës.

9. Individët e emëruar si auditorë të brendshëm nuk mund të kenë lidhje martesore ose gjaku deri në shkallë të dytë me ndonjë anëtarë të Bordit të Drejtorëve, Menaxherëve të Lartë ose ndonjë personi që mban një interes të konsiderueshëm të pronësisë në bankë.

10. Në rast të degës së bankës së huaj, auditimi i brendshëm i degës në Republikën e Kosovës duhet të emërohet nga organet vendimmarrëse të bankës së huaj, dhe duhet t'i raportojë Komitetit të Auditimit të bankës së huaj dhe duhet të operojë i pavarur nga menaxhmenti.

11. BQK përcakton me rregullore aspektet shtesë rreth organizimit dhe funksionimit të auditimit të brendshëm të bankave dhe degëve të bankave të huaja.

Neni 51 **Funksioni për menaxhim të rrezikut**

1. Banka duhet të krijojë një njësi të veçantë e cila ka përgjegjësinë e menaxhimit të rreziqeve dhe është e pavarur nga veprimtaritë e gjenerimit të të ardhurave të bankës.

2. Menaxhimi i rreziqeve i përshtatet madhësisë dhe strukturës organizative të bankës, vëllimit të operacioneve dhe llojeve të veprimtarive që banka kryen, ashtu që në mënyrë efektive dhe efikase të identifikojë, matë, vlerësojë dhe menaxhojë apo zbusë rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka gjatë ushtrimit të veprimtarive të saj.

3. Sistemi i menaxhimit të rreziqeve të bankës duhet të mbulojë rrezikun kreditor, rrezikun e koncentrimin, rrezikun nga sekjuritizimi, rrezikun rezidual (të mbetur), rrezikun e tregut, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, rrezikun nga leverazhi i tepruar dhe rreziqet tjera ndaj të cilave banka, gjatë veprimit, është apo mund të jetë e ekspozuar.

4. Çdo bankë duhet të sigurojë resurse adekuate të alokuara dhe dedikuara në menaxhimin e të gjitha rreziqeve materiale, përfshirë numrin e mjaftueshëm të punonjësve të cilët posedojnë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme për të qenë të përfshirë në menaxhim të rreziqeve, si dhe për vlerësimin e aseteve, përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore dhe modeleve të brendshme të lidhura me këto rreziqe.

5. Çdo bankë duhet të krijojë linja të përshtatshme të raportimit tek Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve që përfshijnë të gjitha rreziqet materiale duke përfshirë politikat e menaxhimit të rreziqeve dhe ndryshimet e tyre.

6. Çdo bankë duhet të krijojë dhe të përdorë në mënyrë të vazhdueshme sistemet e saj të kontrollit të brendshëm, përfshirë procedurat e shëndosha administrative, të kontabilitetit dhe procedurat tjera, në veçanti për:

6.1. llogaritjen dhe monitorimin e kërkesave të kapitalit në lidhje me këto rreziqe;

6.2. identifikimin dhe monitorimin e ekspozimeve të mëdha dhe ndryshimeve pasuese të tyre;

6.3. monitorimin e këtyre ekspozimeve përmes politikave për ekspozimet e secilës bankë.

7. Si pjesë e politikave dhe procedurave të përgjithshme për menaxhim të rreziqeve, çdo bankë së paku duhet të hartojë dhe mbajë politika dhe procedura të shkruara në lidhje me:

7.1. shumën e përgjithshme maksimale të pronës së paluajtshme dhe pasurive fikse, apo kategorive specifike të tyre që mbahen nga banka;

7.2. ndalesat, kufizimet ose kushtet që kanë të bëjnë me menaxhimin e normës së interesit në librin e bankës dhe menaxhimin e rrezikut të tregut, duke përfshirë:

7.2.1. llojet ose format e ekspozimeve të bëra, dhe përgjegjësi të marra (të mundshme ose të tjera);

7.2.2. përputhjen e maturimit dhe normës së interesit në lidhje me asetet dhe detyrimet (të mundshme/kontingjente ose të tjera);

7.2.3. pozicionet e pambrojtura në valuta të huaja, metale të çmuara ose gurë të çmuar, instrumentet e këmbimit dhe normës së interesit, aksionet dhe letrat tjera me vlerë të transferueshme; dhe

7.2.4. kontratat me pajtim paraprak (ang. "forward contracts"), kontratat e kundërkëmbimit (ang. "swaps"), kontratat e së ardhmës (ang. "futures"), kontratat opion dhe derivativët tjera të lidhura me valutat, aksionet, obligacionet, metalet e çmuara dhe normat e interesit.

7.3. menaxhimin e të gjitha llojeve të rreziqeve operationale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në sigurinë e objektit, teknologjisë dhe personelit.

8. Të gjitha strategjitë, politikat, proceset dhe limitet për menaxhim të rreziqeve miratohen nga Bordi i Drejtorëve, dokumentohet siç duhet si dhe rishikohen rregullisht.

9. Udhëheqësi i funksionit të menaxhimit të rrezikut miratohet nga BQK-ja.

10. BQK përmes rregullores mund të specifikojë më tej kërkesat si dhe mënyrën e identifikimit, matjes, vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve të referuara në këtë nen.

Neni 52 **Funksioni i pajtueshmërisë**

1. Banka duhet të sigurojë se funksioni i pajtueshmërisë vepron mbi baza proaktive dhe identifikon, dokumenton dhe vlerëson rrezikun e pajtueshmërisë të lidhur me veprimtaritë e biznesit të bankës, duke përfshirë zhvillimin e produkteve të reja, si dhe duhet të monitorojë rreziqet e mundshme që rrjedhin nga mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

2. Banka duhet të sigurojë që funksioni i pajtueshmërisë ka autoritetin dhe ndikimin e duhur për të kryer funksionin e tij si dhe është i pajisur me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për identifikimin efikas të rrezikut të pajtueshmërisë.

3. Kryesuesi i funksionit të pajtueshmërisë informon dhe këshillon Menaxhmentin e Lartë dhe raporton te Bordi i Drejtorëve i cili po ashtu vendos për kompensimin e tij. Shkarkimi apo dorëheqja e kryesuesit të funksionit të pajtueshmërisë së bashku me arsyetimin duhet t'i komunikohet BQK-së brenda shtatë (7) ditëve të punës pas ngjarjes përkatëse.

4. Funksioni i pajtueshmërisë kryen detyrat e mëposhtme në lidhje me rrezikun e pajtueshmërisë:

- 4.1. identifikimin dhe monitorimin e rrezikut nga mospajtueshmëria e operacioneve të bankës me kornizën ligjore dhe rregullative;
 - 4.2. monitorimin dhe testimin e funksionit të pajtueshmërisë dhe raportimin te Bordi i Drejtorëve për gjetjet e mospajtueshmërisë si dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra;
 - 4.3. këshillimin e anëtarëve të Menaxhmentit të Lartë dhe Bordit të Drejtorëve në vazhdimësi dhe në mënyrë efikase për zbatimin e kornizës ligjore dhe rregullative;
 - 4.4. informimin e Menaxhmentit të Lartë dhe raportimin te Bordi i Drejtorëve ose një komiteti të Bordit të Drejtorëve të caktuar për pajtueshmëri në pajtim me politikën e funksionit të pajtueshmërisë;
 - 4.5. vlerësimin e ndikimit të mundshëm të kornizës ligjore dhe rregullative si dhe ndryshimeve në operacionet e bankës dhe mjedisin rregullativ ku banka operon;
 - 4.6. vlerësimin e pajtueshmërisë së produkteve të reja dhe proceseve të bankës me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi.
5. Kryesuesi i funksionit të pajtueshmërisë miratohet nga BQK-ja.
6. BQK, përmes rregullores mund të specifikojë më tej aspektet e organizimit dhe funksionimit të funksionit të pajtueshmërisë për bankat dhe degët e bankave të huaja.

Neni 53 **Konflikti i interesit**

1. Çdo drejtor dhe menaxher i lartë, me rastin e marrjes së pozitës, kërkohet të paraqes një njoftim me shkrim Bordit të Drejtorëve ku shpalosen emrat, adresat dhe karakteristikat e veçanta të të gjitha interesave tregtare, financiare, bujqësore, industriale ose interesave afariste ose familjare.
2. Përveç kësaj, në vazhdimësi dhe para zbatimit të një kontrate materiale me bankën që duhet ose do të duhet të vihet në vëmendje Bordi i Drejtorëve, Menaxherët e Lartë duhet të paraqesin njoftim me shkrim Bordit të Drejtorëve çdo interes material ose marrëdhënie materiale me çdo person që banka është palë në një kontratë materiale ose kontratë të propozuar materiale.
3. Çdo drejtor ose menaxher i lartë i cili ka interes material ose marrëdhënie materiale brenda fushës së veprimit të këtij neni, duhet të mos marrë pjesë në mbledhjet ku diskutohet ose votohet çështja, dhe duhet të mos marrë pjesë në votim për të gjitha këto çështje që shtrihen në Bordin e Drejtorëve.
4. Një interes është material nëse është i konsiderueshëm në lidhje me aspektin financiar ose ekonomik të personit që ka interes ose një person ka marrëdhënie materiale në një shoqëri nëse personi zotëron, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, një kontroll të konsiderueshëm

në atë shoqëri, ose është drejtor ose menaxher i lartë i shoqërisë, ose ortak në çfarëdo ortakërie.

5. Nëse drejtori dhe menaxheri i lartë nuk shpalos interesin apo marrëdhënien materiale në përputhje me këtë nen, gjykata me kërkesë të bankës, aksionarit të bankës ose BQK-së, mundet ta anulojë kontratën, nëse ekziston, mbi bazë të asaj që e konsideron të përshtatshme, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Përveç kësaj, BQK-ja me anë të një urdhërese më shkrim, mundet ta suspendojë drejtorin dhe menaxherin e lartë nga pozita për një periudhë që nuk kalon një (1) vit, ose ta përjashtoj drejtorin dhe menaxherin e lartë nga pozita përkatëse, ose të shqiptoj sanksione tjera të parapara me këtë ligj.

6. Banka duhet të caktoj politika dhe procedura të duhura në mënyrë që drejtorët, menaxherët e lartë dhe punonjësit e saj të mos gjenden në një pozitë ku detyra zyrtare ndaj një klienti bie ndesh me detyrën zyrtare ndaj një klienti tjetër, apo nëse interesat e tyre bien ndesh me detyrën zyrtare ndaj klientit.

7. Drejtorët, menaxherët e lartë dhe punonjësit e bankave kanë detyrime fiduciare të pavarësisë, besnikërinë dhe kujdesin ndaj bankës ku shërbejnë dhe ndaj depozitorëve të bankës, si dhe për vendosjen e interesave të bankës para interesave personale.

8. Asnjë drejtor ose menaxher i lartë nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuese si person ose në emër të bankës me një individ të ndërlidhur përveç nëse marrëveshja kontraktuese miratohet nga Bordi i Drejtorëve të bankës.

Neni 54

Emërimi apo zëvendësimi i Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë

1. Asnjë person nuk mund të bëhet drejtor ose menaxher i lartë i një banke pa marrjen e miratimit paraprak të BQK-së.

2. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet ndaj degëve të bankave të huaja të licencuara për të operuar në Republikën e Kosovës vetëm në lidhje me emërimin e Menaxherëve të Lartë të degës që operon në Republikën e Kosovës.

3. Degët e bankave të huaja të licencuara për të operuar në Kosovë, duhet të njoftojnë BQK-në për çdo zëvendësim të Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë të bankës së huaj.

Neni 55

Përshtatshmëria e Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë

1. Çdo drejtor dhe menaxher i lartë i bankës duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm dhe me reputacion të mirë, dhe duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga BQK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe integritetin. Një person nuk konsiderohet si person i përshtatshëm dhe i duhur nëse ai person:

1.1. është dënuar me vendim final nga një gjykatë për vepër penale, me burgim prej gjashtë (6) apo më shumë vite;

- 1.2. ka qenë debitor në një procedurë falimentimi ose paaftësie paguese brenda dhjetë (10) viteve të fundit;
 - 1.3. sipas vendimit të gjykatës i është mohuar ushtrimi i veprimtarive në kuadër të kompetencës të Bordit të Drejtorëve apo Menaxherëve të Lartë, ose është përjashtuar apo suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes;
 - 1.4. ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një banke licenca e së cilës është revokuar apo ku paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruar është iniciuar gjatë mandatit të atij drejtori ose menaxheri të lartë;
 - 1.5. është konstatuar nga BQK se ka qenë i angazhuar në praktika financiare të pa shëndosha apo ka qenë në konflikt të interesit, ose
 - 1.6. është zëvendësuar gjatë procesit të përmbylljes sipas Kapitullit III të këtij ligji.
2. Në rrethana të veçanta, pasi të përmbushen kërkesat rreth kualifikimit, përvojës profesionale dhe sjelljes së personit, BQK-ja mund ta përjashtoj zbatimin e nën-paragrafit 1.4. të këtij neni ndaj një drejtori ose menaxheri të lartë pas skadimit të periudhës së paraparë për rastin përkatës.
 3. Një person nuk mund të emërohet apo të zgjidhet si drejtor ose menaxher i lartë i bankës, nëse ai person ka një pozitë në BQK, ose gjashtë (6) muajve para emërimit/zgjedhjes ka pasur një pozitë në BQK.
 4. Zyrtarët e zgjedhur, ministrat dhe zëvendësministrat e shtetit dhe qeverive komunale dhe të institucioneve të tyre përkatëse nuk mund të shërbejnë si anëtarë të bordit të drejtorëve të ndonjë banke përderisa janë të zgjedhur aty dhe për një periudhë pasuese prej një (1) viti pas përfundimit të mandatit.
 5. Të gjithë zyrtarët publikë të cilët shërbejnë si anëtarë të bordit të drejtorëve në ndonjë banke duhet ta lirojnë vetën dhe të përmbahen nga ndonjë diskutim ose vendim brenda institucionit që ka të bëjë me bankën në të cilët ata janë anëtarë të Bordit të Drejtorëve.
 6. Çdo bankë që vihet në dijeni të rrethanave të cilat tregojnë se ndonjë Drejtor ose Menaxher i Lartë mund të mos jetë person i përshtatshëm dhe i duhur duhet ta njoftojë BQK-në. Mos përmbushja e kësaj kërkesë mund të rezultojë në sanksione administrative sipas Kapitullit II të këtij ligji.
 7. Drejtorët dhe menaxherët e lartë të miratuar nga BQK-ja në baza vjetore dorëzojnë në BQK dëshmi nga gjykata dhe policia për verifikimin e të kaluarës penale. Dëshmia duhet të dorëzohet në BQK jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga përfundimi i vitit paraprak.
 8. Çdo Drejtor apo Menaxher i Lartë duhet të ketë diplomë universitare dhe përvojën e duhur, siç kërkohet me rregullore të BQK-së.

9. BQK mund të përcaktojë përmes rregulloreve kërkesat shtesë të përshtatshmërisë për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë.

Neni 56

Shkarkimi i Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë

1. Pasi që të përcaktohet se një Drejtor ose Menaxher i Lartë nuk i plotëson kriteret e parapara në nenin 55 të këtij ligji, BQK-ja paraqet një njoftim për përjashtimin e Drejtorit ose Menaxherit të Lartë të bankës.

2. Nëse brenda dhjetë (10) ditëve nga data e njoftimit për shkarkim nga BQK-ja, Drejtori ose Menaxheri i Lartë nuk është shkarkuar nga pozita, BQK-ja urdhëron shkarkimin e Drejtorit ose Menaxherit të Lartë dhe mund të vendosë sanksione ndaj bankës dhe ndaj Drejtorit ose Menaxherit të Lartë për mosveprim në përputhje me Kapitullin II të këtij Ligji.

Neni 57

Miratimi i aksionarëve kryesor

1. Personi që vepron drejtpërdrejtë ose tërthorazi, vetëm apo në bashkëveprim me ndonjë person tjetër, nuk mund të bëhet aksionar kryesor në një bankë pa marrjen e miratimit paraprak me shkrim nga BQK-ja.

2. Aksionari kryesor, që vepron drejtpërdrejtë ose tërthorazi, vetëm apo në bashkëveprim me ndonjë person tjetër, nuk mund ta shtojë interesin e pronësisë në një bankë mbi dhjetë (10%), njëzet (20%), tridhjetë e tre (33%), pesëdhjetë (50%) ose shtatëdhjetë e pesë (75%) për qind të kapitalit pa marrjen e miratimit paraprak nga BQK-ja.

3. Kërkesat për përvetësim të interesit të kapitalit aksionar në një bankë apo ngritjes së posedimit të interesave të kapitalit në një bankë duhet të bëhen në formën e përcaktuar nga BQK-ja dhe përfshijnë:

3.1. emrin, nacionalitetin, vendbanimin dhe historikun afarist dhe profesional, përfshirë çdo pronari përfitues të paraqitësit të kërkesës që, si rezultat i transaksionit, përfiton në mënyrë të tërthortë pesë përqind (5%) ose më shumë të interesave të kapitalit të bankës;

3.2. listën e sipërmarrjeve në të cilat pronarët e propozuar, duke përfshirë pronarët përfitues (siç përshkruhet me lartë), kanë pjesëmarrje, duke specifikuar nivelin e pjesëmarrjeve të këtyre dhe adresat e regjistruara të këtyre sipërmarrjeve;

3.3. për çdo person fizik që bën kërkesë, një deklaratë nga gjykata që shpalosë ndonjë dënim për vepra penale, dosjet personale të falimentimit, përjashtimi nga ushtrimi i profesionit, apo përfshirjen e tanishme apo të kaluar në funksion menaxhues të një korporate ose të ndonjë sipërmarrësi tjetër që i nënshtrohet procedurës së paaftësisë së pagesës, nëse ekziston;

3.4. për çdo paraqitës të kërkesës që është person juridik, pasqyrat e audituara financiare për tre (3) vitet e fundit, nëse është e aplikueshme;

3.5. afatet dhe kushtet e përvetësimit të propozuar;

3.6. burimin dhe shumën e fondeve që shfrytëzohen në ushtrimin e përvetësimit;

3.7. çdo plan ose propozim lidhur me ndryshimin kryesor në biznesin, strukturën e korporatës ose menaxhmentin e bankës;

3.8. në çdo rast kur përvetësimi do të ndikonte që banka të bëhet një subjekt i varur i një banke të huaj, një deklaratë se autoriteti i huaj mbikëqyrës përgjegjës për mbikëqyrje prudenciale të bankës së huaj në vendin amë nuk kundërshton në fillimin e veprimtarive të propozuara në Republikën e Kosovës, dhe ushtron mbikëqyrje globale bankare të konsoliduar ndaj bankës së huaj, dhe

3.9. informacionet tjera të cilat mund të kërkohen nga BQK-ja.

4. Çdo bankë duhet ta njoftojë BQK-në për çdo përvetësim të aksioneve brenda pesë (5) ditëve pas përvetësimit të shumës së aksioneve nëse shuma e tillë është e barabartë ose tejkalon pesë për qind (5%) të kapitalit aksionar por që nuk tejkalon dhjetë për qind (10%) të tij. Njoftimi bëhet në atë mënyrë që përmban informacionet që mund të kërkohen nga BQK-ja.

5. Kufizimet në paragrafin 1. dhe paragrafin 2. të këtij neni nuk zbatohen për përvetësimin e aksioneve në një bankë e huaj që është e licencuar për të operuar me një ose më shumë degë në Kosovë, për aq kohë sa banka e huaj njofton BQK-në për çdo përvetësim ku shuma e aksioneve të përvetësuara është e barabartë ose tejkalon pesë për qind (5%) të kapitalit të bankës së huaj.

Neni 58

Kontraktimi i jashtëm të funksioneve të brendshme

1. Banka nuk mund të kontrakttojë nga jashtë në tërësi funksionet e saj të kontrollit. Banka mund t'ia besojë ofruesve të shërbimeve kryerjen e një pjese të veprimtarive të saj të lidhura me funksionet e kontrollit në pajtueshmëri me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara në zbatim të këtij ligji. Kontraktimi i jashtëm nga banka, i cilit do operacion apo funksion (përveç funksioneve që nuk janë të lejuara të kontraktohen nga jashtë) është subjekt i miratimit paraprak nga BQK, sikurse përcaktohet me rregullore.

2. Për qëllime të këtij ligji, "kontraktimi i jashtëm" nënkupton marrëveshjen kontraktuale përmes së cilës ofruesit e jashtëm të shërbimeve angazhohen në kryerjen e veprimtarive të cilat përndryshe do të kryhen nga banka, megjithatë kontraktimi nga jashtë nuk do të konsiderohet të përfshijë:

2.1. prokurimin e mallrave dhe punimeve;

2.2. lizingun apo qiradhënien, apo

2.3. shërbimet komunale/publike.

3. Kushtet për kontraktimin e jashtëm listohen si në vijim:

3.1. banka duhet të krijojë sistem të duhur të menaxhimit të rreziqeve që lidhen me kontraktimin e jashtëm të funksioneve të brendshme;

3.2. Banka duhet të sigurojë që kontraktimi i jashtëm të mos pengojë apo dëmtojë:

3.2.1. veprimin e rregullt të saj;

3.2.2. menaxhimin efektiv të rrezikut të saj;

3.2.3. sistemet e saj të kontrollit të brendshëm, dhe

3.2.4. mbikëqyrjen nga BQK.

4. Përmes instrumenteve tjera rregullatore BQK do të përcaktojë si më poshtë:

4.1. veprimtaritë të cilat lejohen të kontraktohen me ofrues të jashtëm;

4.2. kushtet e detajuara të kontraktimit të jashtëm, dhe

4.3. përmbajtjen e dokumentacionit që duhet të bashkëngjitet dhe afatet kohore për kërkesën për miratimin paraprak të referuar në paragrafin 1. të këtij neni.

5. Kur bankat kontraktjnë ofrues të jashtëm të shërbimeve në kryerjen e çfarëdo funksioni apo veprimtarie sipas këtij neni, ato duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar pajtueshmërinë me dispozitat e këtij ligji dhe rregulloreve të BQK-së.

6. Bankat mbesin plotësisht përgjegjëse për çdo veprim të punonjësve, agjentëve, agjentëve të bankës si dhe të ofruesve të jashtëm të cilat i janë besuar funksionet e brendshme.

Neni 59

Zgjerimi apo zvogëlimi i rrjetit bankar

1. Me aprovim të BQK-së, Banka ka të drejtë të hapë degë ose zyre në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, të ofrojë shërbime ndërkufitare si dhe të hapë zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Kosovës. BQK-ja përcakton kushtet për themelimin e një dege, zyre ose zyre përfaqësimi ose sigurimin e shërbimeve bankare dhe/ose financiare ndërkufitare.

2. Banka e huaj ka të drejtë të hapë një ose më shumë degë ose zyra brenda territorit të Republikës së Kosovës, për të cilat BQK-ja do të japë vetëm një licencë. Për qëllime të mbikëqyrjes, degët e tilla do të konsiderohen si zyre.

3. Një bankë ose një degë e bankës së huaj ka të drejtë të ofrojë shërbime dhe të kryejë cilëndo nga veprimtaritë e saj nëpërmjet një agjenti bankar siç parashikohet në ligjin përkatës për sistemin e pagesave si dhe instrumenteve të tjera rregullatore të BQK-së.

4. Bankat duhet të sigurojnë që agjentët bankarë, që veprojnë në emër të tyre, të informojnë klientët për veprimin e tyre si agjentë të bankës.
5. Bankat nuk mund të vendosin detyrime të ekskluzivitetit ndaj agjentëve bankar ose ofruesve të shërbimeve agjentore bankare.
6. Banka duhet të marrë miratim paraprak me shkrim nga BQK-ja para themelimit, ndryshimit të lokacionit apo mbylljes së një dege apo zyre në Republikën e Kosovës, si dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
7. BQK përcakton me rregullore procedurën për marrjen e miratimit paraprak me shkrim si dhe formën dhe përmbajtjen e aplikacionit, siç parashihet me këtë nen, si dhe mund të rregullojë aspekte shtesë të zgjerimit apo zvogëlimit të rrjetit bankar

NËNKAPITULLI V BASHKIMET, NDARJET DHE PËRVETËSIMET

Neni 60 Bashkimet, ndarjet dhe përvetësimet

1. Një bankë nuk mund të bashkohet, ndahet ose përvetësohet nga ndonjë bankë tjetër në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, lidhur me të gjitha asetet (pasuritë) ose një nivel të konsiderueshëm të tyre, ose të marrë detyrimet e ndonjë banke tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së.
2. Një bankë nuk duhet të ndryshojë statutin e saj pa miratimin paraprak të BQK-së. Pavarësisht nga kërkesat e këtij ligji, BQK-ja mund të rregullojë forma të tjera të ndryshimit të statutit të bankave dhe mund të përcaktojë kërkesat tjera që bankat duhet t'i plotësojnë në procesin e ndryshimit të statutit të tyre.
3. Aplikacionet për t'u bashkuar, për t'u ndarë dhe për të përvetësuar të gjitha asetet ose një nivel të konsiderueshëm të tyre, ose të marrë detyrimet e një banke, duhet të jenë sipas formës të përcaktuar nga BQK-ja.
4. Për qëllime të vendosjes për një kërkesë të paraqitur sipas këtij neni, kriteret për miratimin paraprak të një kërkesë për licencë bankare, siç përcaktohet në nenin 13 të këtij ligji zbatohen përshtatshëm.
5. BQK mund të kërkojë nga një bankë apo degë e bankës së huaj që të fillojë procesin e bashkimit, ndarjes apo përvetësimit nëse gjykon se është në interes të arritjes së objektivave në pajtim me këtë ligj.
6. Aksionarët e bankave dhe bankave të huaja që operojnë përmes degës në Kosovë, nuk mund të jenë në të njëjtën kohë edhe aksionar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një banke tjetër, ose të një institucioni tjetër financiar në Kosovë që ushtron veprimtari të ngjashme me bankën, ose vlerësohet si e tillë nga BQK.

Neni 61

Bashkimet dhe ndarjet

1. Nëse një bashkim apo ndarje rezulton në një bankë të re, banka e re duhet të marrë licencën nga BQK-ja për të ofruar shërbime bankare dhe financiare.

2. Kërkesa për marrjen e një licence të përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni i paraqitet BQK-së. Dispozitat e nenit 60 të këtij ligji zbatohen përshtatshëmrisht ndaj një kërkesë të paraqitur në BQK dhe vendimet lidhur me atë kërkesë.

3. Kërkesa për marrjen e licencës për bashkim ose ndarje shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

3.1. Për bashkim:

3.1.1. marrëveshjen e bashkimit;

3.1.2. raportin ose raportet lidhur me bashkimin, duke përfshirë arsyetimin për bashkimin e përgatitur nga menaxhmenti i bankave ose menaxhmenti i subjekteve të përfshira në bashkim, të miratuara nga Bordi i Drejtorëve;

3.1.3. raportin ose raportet lidhur me auditimin e bashkimit;

3.1.4. propozimin për publikimin e thirrjes (organizimit) së kuvendit të përgjithshëm ose mbledhjeve të përgjithshme që do të miratojnë bashkimin.

3.2. Për ndarje:

3.2.1. planin e ndarjes;

3.2.2. raportin e menaxhmentit të bankës mbi ndarjen duke përfshirë arsyeshmërinë për ndarje të miratuar nga Bordi i Drejtorëve;

3.2.3. raportin lidhur me auditimin e ndarjes;

3.2.4. propozimin për publikimin e thirrjes (organizimit) së kuvendit të përgjithshëm të aksionarëve që do të miratojnë ndarjen.

4. Vendimi për lëshimin e licencës mund të përfshijë kushtet ose kufizimet në ofrimin e shërbimeve për të cilat licenca është lëshuar me qëllim të parandalimit të shkeljeve të këtij ligji.

5. Procesi i bashkimit dhe ndarjes rregullohet edhe më tej përmes instrumenteve rregullative nga BQK-ja.

Neni 62 **Përvetësimet**

1. Një bankë nuk duhet të përvetësojë ndonjë bankë tjetër ose të përvetësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të gjitha ose në nivel të konsiderueshëm ose të gjithë pasurinë ose të marrë detyrimet e ndonjë banke tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së.
2. Kërkesat për të miratuar përvetësimin e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni duhet t'i paraqiten BQK-së.
3. BQK miraton përvetësimin nëse:
 - 3.1. kjo nuk rrezikon kushtet financiare të bankës përvetësuese;
 - 3.2. banka përvetësuese ka një sistem të tillë të organizimit, menaxhimit, vendimmarrjes dhe teknologjisë së informacionit që i mundëson të menaxhojë në mënyrë adekuate rreziqet në veprimtaritë e biznesit dhe i mundëson integrimin e plotë të bankës së përvetësuar në sistemin e saj në atë mënyrë që nuk e rrezikon funksionimin e saj, deri në ditën e paraqitjes të kërkesës së specifikuar në paragrafin 2. të këtij neni;
 - 3.3. është e justifikuar ekonomikisht dhe / ose nuk mund të ketë pasoja materiale negative në tregun financiar, dhe veçanërisht në konkurrencën e lirë të tregut.
4. Procesi i miratimit të përvetësimin rregullohet më tej përmes instrumenteve rregullative nga BQK.

Neni 63 **Përvetësimet e interesave në kapital në një bankë**

BQK-ja para miratimit të një kërkesë për të përvetësuar një interes të kapitalit në një bankë, duhet të vlerësojë përvetësimin e propozuar në lidhje me kriteret e njëjta që zbatohen në përcaktimin e miratimit paraprak ose përfundimtar të një kërkesë për licencë sipas neneve 13 dhe 14 të këtij ligji, duke përfshirë, por pa u kufizuar në efektet e pritura të përvetësimin të propozuar mbi shëndetin financiar të bankës, strukturën pronësore të bankës dhe efektin e saj në aftësinë e BQK-së për të kryer mbikëqyrjen në nivel të bankës dhe në nivel të konsoliduar, si dhe përshtatshmërinë e aksionarëve të propozuar dhe pozitën e tyre në tregjet financiare.

Neni 64 **Përvetësimi i interesave në kapital në institucionet financiare**

1. Një bankë duhet me miratimin paraprak të BQK-së:
 - 1.1. të krijojë ose përvetësojë, në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, një interes të kualifikuar në një institucion financiar;
 - 1.2. të rrisë interesin e saj të kapitalit në një institucion financiar, ose

1.3. të pranojë si kolateral një interes të kualifikuar në një institucion financiar.

2. BQK nuk miraton përvetësimin përkatës nëse sipas vlerësimit të saj, përvetësimi i interesave në kapital aksionar të institucionit financiar ka aktivitetit të ngjashëm me atë të bankës përkatëse.

3. BQK rregullon më tej përvetësimin e interesave të kapitalit aksionar nga bankat në institucionet financiare me instrumente rregullative të BQK-së.

Neni 65

Përvetësimi i interesave në kapital në institucionet jo-financiare

1. Një bankë nuk mund të mbajë, në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthorë, një interes të kapitalit aksionar në personin juridik që është i përfshirë në aktivitete jo-financiare, nëse interesat e tilla:

1.1. përfaqësojnë më shumë se pesë për qind (5%), të interesit në personin juridik apo ndonjë kufizimi tjetër të përcaktuar me rregullore të BQK-së;

1.2. tejkalojnë pesëmbëdhjetë për qind (15%), të kapitalit rregullativ të bankës apo ndonjë kufizimi tjetër të përcaktuar me rregullore të BQK-së, apo

1.3. kur bashkohen me të gjitha interesat e kapitalit të mbajtur nga banka në shoqëritë jo-financiare, tejkalojnë njëzet e pesë për qind (25%) të kapitalit rregullativ të bankës.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk kërkohet miratim për:

2.1. interesat e kapitalit që janë përvetësuar nga një bankë në mbyllje ose në prag të kthimit të kredisë së dhënë nga banka, në të cilin rast banka ekspozon interesat e tilla të kapitalit brenda një viti nga data që ato janë përvetësuar apo brenda një periudhe më të gjatë të cilën mund ta lejojë BQK-ja, apo

2.2. interesat e kapitalit të mbajtura nga një bankë si agent ose administrues i besuar.

3. BQK-ja përcakton me rregullore mënyrën sipas së cilës kërkesat e këtij neni zbatohen në baza të gjëra grupore për grupin bankar, duke përfshirë rritjen e kufizimit të përvetësimit të kapitalit aksionar të institucioneve jo-financiare sipas paragrafit 1. të këtij neni.

NËNKAPITULLI VI LLOGARITË, AUDITIMI DHE SHPALOSJA

Neni 66 Llogaritë dhe pasqyrat financiare

1. Bankat duhet të mbajnë llogaritë, regjistrimet dhe të përgatisin pasqyrat vjetore financiare sipas rregullit për të pasqyruar operacionet dhe gjendjen financiare dhe për të pasqyruar operacionet dhe gjendjen financiare të subjekteve të varura dhe degëve të bankës si në bazë individuale ashtu edhe të konsoliduar.
2. Llogaritë dhe pasqyrat financiare duhet të jenë në formën e detajuar në përputhje me SNRF, duke pasqyruar rregullat dhe standardet shtesë ashtu siç përcaktohet nga BQK-ja.
3. BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore ose urdhëresë për filialet tjera të një banke nëse duhet të dërgohen raportet e konsoliduara financiare.
4. Kopja e çdo pasqyre të audituar financiare të bankës, duke përfshirë pasqyrat e konsoliduara financiare, nëse ekzistojnë, i paraqiten BQK-së kur ato të jenë në dispozicion dhe më së largu brenda katër (4) muajve pas përfundimit të vitit financiar.
5. Çdo degë e bankës së huaj duhet të përgatisë pasqyrat financiare të kërkuara në paragrafin 4. të këtij neni, duke treguar se degët e bankës së huaj që gjenden në Republikën e Kosovës operojnë në kuadër të bankës së huaj.
6. Për bankat participuese, aplikohen standardet përkatëse ndërkombëtare, te cilat adoptohen përmes rregulloreve përkatëse të BQK-së.
7. BQK-ja përcakton formën, llojin, metodologjinë, përmbajtjen dhe kohën e raportimit në BQK, të degëve të bankave të huaja.

Neni 67 Të dhënat e bankës

1. Çdo bankë duhet të përgatisë dhe të mbajë në zyrën e saj qendrore ose në një vend të sigurt, të dhënat në formë fizike apo elektronike që përmbajnë:
 - 1.1. statutin e saj ose një dokument themelues ekuivalent, dhe të gjitha amandamentimet përkatëse;
 - 1.2. një regjistër të aksionarëve, dhe pronarëve përfitues, duke përfshirë numrin e aksioneve të regjistruara në emër të secilit;
 - 1.3. procesverbalet e çdo mbledhjeje të Bordit të Drejtorëve ose komiteteve dhe vendime të miratuara nga Bordi i Drejtorëve;
 - 1.4. procesverbalet e kuvendit të aksionarëve dhe vendimet e miratuara nga kuvendi i aksionarëve;

1.5. të dhënat e kontabilitetit që tregojnë në mënyrë të qartë dhe të saktë gjendjen e çështjeve të saj të afarizmit, duke shpjeguar transaksionet dhe pozicionin financiar në mënyrë që të mundësojë BQK-në të përcaktojë nëse institucioni është në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij ligji dhe me rregulloret dhe urdhrat në fuqi;

1.6. të dhënat që tregojnë për çdo klient të bankës, në baza ditore, hollësitë e transaksioneve me, ose për llogari të atij klienti dhe të gjitha bilancet që i detyrohen ndaj atij klienti;

1.7. dokumentacionin kreditor dhe çdo informacion tjetër lidhur me marrëdhëniet afariste me klientët e saj dhe personat e tjerë që BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore, dhe të dhëna të tjera siç kërkohet nga BQK-ja.

Neni 68 **Auditimi i jashtëm**

1. Aksionarët, me rekomandimin e Komitetit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve, duhet të caktojnë një auditor të jashtëm të kualifikuar dhe të pavarur, të miratuar nga BQK-ja, i cili në përputhje me Standardet e Ndërkombëtare të Auditimit, duhet:

1.1. të japë një opinion nëse pasqyrat financiare paraqesin një pamje të plotë dhe të vërtetë të gjendjes financiare dhe performancës së bankës në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.2. të shqyrtojë përshtatshmërinë e praktikave dhe procedurave për auditim të brendshëm, dhe praktikave dhe procedurave për kontroll dhe të bëjë rekomandime për përmirësimet e nevojshme, dhe

1.3. të informojë Bordin e Drejtorëve për çdo veprim mashtrues të kryer nga një punonjës i bankës ose nga ndonjë subjekt i varur i saj ose ndonjë parregullsi a mangësi në administrim ose në operacionet që mund të pritet të rezultojnë me një humbje materiale për bankën apo subjektin e varur.

2. Auditori i jashtëm i bankës, apo çdo anëtar i firmës së auditimit, nuk duhet të jetë person i ndërlidhur me bankën ose agjent apo përfaqësues i bankës dhe nuk duhet të ketë ndonjë interes financiar në bankë, me përjashtim të mbajtjes së depozitës në bankë.

3. Partneri kryesor i auditimit në një kompani auditimi, i cili kryen një auditim ligjor në emër të kompanisë së auditimit, nuk do të lejohet të marrë pozita drejtuese apo administrative në bankën e audituar ose degën e bankës së huaj për një periudhë së paku dy (2) vjeçare që nga dita e dorëheqjes së dhënë si partner kryesor i auditimit në një kompani auditimi.

4. BQK-ja mund të vendos kritere shtesë për përzgjedhjen dhe kërkesat për rotacion të auditorëve ose partnerëve të angazhuar të firmave të auditimit pas një periudhe të caktuar kohore për të siguruar vazhdimësinë e pavarësisë.

5. BQK-ja ka kompetencë që të kërkojë përjashtimin ose zëvendësimin e një auditori, apo drejtpërsëdrejti të emërojë, përjashtoj ose zëvendësojë një auditor, me shpenzime të bankës për të bërë një riauditim, nëse banka ose auditori nuk i plotëson kërkesat e këtij neni, ose në rastet kur BQK-ja me arsye nuk është kënaqur me performancën e auditorit. BQK-ja ka kompetencën për qasje në dokumentet e punës të auditorit të jashtëm, aty ku është e nevojshme.

6. BQK-ja mund të kërkojë me rregullore të kryejë auditimin e pasqyrave financiare për degët e bankave të huaja.

Neni 69 **Kërkesat për shpalosje**

1. Çdo bankë brenda tridhjetë (30) ditëve të çdo tremujori kalendarik duhet të publikoj në një gazetë kombëtare dhe në faqen e saj të internetit një përmbledhje të vërtetë dhe të saktë të bilancit gjendjes të tremujorit kalendarik të mëparshëm. Çdo bankë duhet gjithashtu, brenda katër (4) muajve nga mbyllja e vitit të saj financiar, të publikojë në një gazetë kombëtare dhe në faqen e saj të internetit një përmbledhje të vërtetë dhe të saktë të bilancit të gjendjes për vitin financiar të mëparshëm.

2. Çdo bankë brenda katër (4) muajve nga mbyllja e vitit të saj financiar, gjithashtu, duhet të publikojë raportin e saj vjetor, që përmban pasqyrat e audituara financiare, dhe t'i vë në dispozicion të publikut kopjet e tyre sipas kërkesave dhe pa pagesë. Çdo bankë i'a dërgon kopjet e raportit të saj vjetor BQK-së sapo të jetë përfunduar dhe e publikon atë edhe në faqen e saj të internetit.

3. Një (1) herë në vit, banka duhet të publikojë në faqen e saj të internetit strukturën ligjore dhe organizative të grupit bankar, duke përfshirë një përshkrim të marrëveshjeve të qeverisjes së brendshme në përputhje me këtë ligj, marrëveshjet lidhur me marrëdhëniet e ngushta dhe marrëveshjet në lidhje me qeverisjen e subjekteve të varura në përputhje me këtë ligj, ose të ofrojë referencë për informacionin ekuivalent në vend të publikimit të përshkrimit të lartpërmendur.

4. BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore kërkesat e mëtejshme për dhënien e informacioneve shpjeguese për bankat.

NËNKAPITULLI VII **MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE EKZAMINIMI**

Neni 70 **Parimet për mbrojtjen e konsumatorëve**

1. Parimet kryesore të mbrojtjes së konsumatorit në kuptim të këtij ligji janë si në vijim:

1.1. e drejta për qasje në financa;

1.2. e drejta për një marrëdhënie të barabartë me ofruesin e shërbimeve financiare;

- 1.3. e drejta për mbrojtje nga diskriminimi;
- 1.4. e drejta për t'u informuar;
- 1.5. e drejta për detyrime kontraktuale të përcaktuara ose të përcaktueshme, dhe
- 1.6. e drejta për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorit.

Neni 71

Shpалosja e kushteve të biznesit (afarizmit)

1. Banka duhet të ketë kushtet e përgjithshme të biznesit, si dhe çdo ndryshim dhe plotësim të saj, të gatshme në dispozicion në mjediset (objektet) e saj të biznesit dhe ta publikoj në faqen e saj të internetit dhe në degët/zyrat bankare, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së hyrjes në fuqi të kushteve të përgjithshme.
2. Zbatimi i kushteve të përgjithshme të biznesit duhet të sigurohet përmes një kontrate me shkrim të lidhur ndërmjet një banke dhe një konsumatori.
3. Klienti mund të kërkojë sqarime dhe udhëzime shtesë nga banka lidhur me zbatimin e kushteve të përgjithshme të biznesit.
4. Për qëllim të këtij ligji, kushtet e përgjithshme të biznesit konsiderohen të gjitha dokumentet që përmbajnë kushte standarde të veprimit që zbatohen për të gjithë klientët e bankës, kushtet e përgjithshme për vendosjen e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve dhe bankës, procedurën e komunikimit ndërmjet konsumatorëve dhe bankës, dhe kushtet e përgjithshme për kryerjen e transaksioneve ndërmjet konsumatorëve dhe bankës.
5. Kushtet e tilla duhet t'i përmbahen parimeve nga neni 70 i këtij ligji.
6. BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore kërkesat të hollësishme dhe mënyrën e shpалosjes dhe zbatimit të kushteve të përgjithshme të biznesit të bankës.

Neni 72

Uniformiteti në llogaritjen dhe shpалosjen e kushteve dhe normave të interesit

1. BQK-ja mund të përcaktojë metodën uniforme të llogaritjes dhe shpалosjes së normave të interesit, dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me huadhënien bankare dhe veprimtarinë e depozitave.
2. Në rastin kur norma e interesit është variabile, banka duhet të caktojë një referencë të saktë për normën bazë, duke e shpалosur qartë llogaritjen dhe aplikimin e saj. Norma e tregut të parasë brenda vendit, mund të shërbejnë si referencë për normën bazë.
3. Informimi jo i plotë apo shpалosja jo e drejtë, konsiderohet si shkelje e këtij ligji dhe mund t'i nënshtrohet masave administrative, me efekte korrigjuese për konsumatorin e shërbimit apo produktit.

Neni 73

Reklamimi

1. Produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare duhet të reklamohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe reklamimi nuk duhet të përmbajë informacione të pasakta dhe/ose informacione mashtruese rreth kushteve sipas të cilave konsumatori i shfrytëzon këto produkte apo shërbime.
2. BQK përmes mekanizmave të saj trajton praktikën e bërjes biznes, nivelin dhe përshtatshmërinë e shpalosjeve ndaj klientit, praktikën e ofrimit të shërbimit dhe përputhshmërinë me promovimin e shërbimeve apo produkteve bankare.
3. BQK-ja mund të përcaktojë kërkesa të hollësishme në lidhje me reklamimin e produkteve dhe shërbimeve bankare dhe financiare.

Neni 74

Dhënia e informacionit për konsumatorët

1. Banka duhet të sigurojë konsumatorin e saj, sipas kërkesës së tij, me informacionin mbi bilancin e llogarisë të kredisë dhe / ose depozitave, si dhe informacione të tjera që lidhen me marrëdhënien biznesore (afariste) ndërmjet konsumatorit dhe bankës.
2. Banka duhet të publikojë në faqen e saj të internetit emrat e personave që mbajnë pjesëmarrje në atë bankë dhe/ose që janë anëtarë të bordit drejtues dhe ekzekutiv të saj, si dhe informacione mbi funksionet e atyre personave.
3. BQK-ja mund të përcaktojë kushtet e hollësishme dhe mënyrën e dhënies së informacionit për konsumatorët e bankës.

Neni 75

Kërkesa minimale e kompetencës profesionale

1. Punonjësit e angazhuar në ofrimin e shërbimeve bankare dhe financiare ose në këshillimin e konsumatorëve duhet të kenë integritet, kualifikime profesionale, njohuri dhe përvojë, dhe të veprojnë në përputhje me kodin e mirësjelljes dhe etikën profesionale, të respektojnë personalitetin dhe integritetin e konsumatorit dhe të informojnë konsumatorët plotësisht dhe me saktësi të kushteve për përdorimin e këtyre shërbimeve.
2. Ofruesit e shërbimeve bankare dhe financiare duhet të sigurojnë që punonjësit e angazhuar në shitjen e këtyre shërbimeve ose në këshillimin e konsumatorëve të kenë kualifikime adekuate dhe të organizojnë trajnimin e këtyre punonjësve.

Neni 76

Procedura e ankesës

1. Nëse një konsumator vlerëson se një bankë nuk i përmbush detyrimet që dalin nga kontrata apo nga ky ligj, mundet të paraqes ankesë pranë bankës.

2. Banka duhet t'i dërgojë përgjigjen e saj parashtresit të ankesës nga paragrafi 1. i këtij neni brenda një periudhe kohore të përcaktuar me instrument rregullator të BQK-së.

3. BQK-ja mund të vendos me instrument rregullator kërkesat e hollësishme dhe mënyrën e trajtimit të ankesave të konsumatorëve nga bankat.

Neni 77 **Rregullat e kontraktimit**

1. Një marrëveshje e shërbimit financiar hartohet me shkrim ose në një mënyrë tjetër të qëndrueshme. Çdo palë kontraktuese do të marrë një kopje të marrëveshjes. Marrëveshja nuk duhet të përmbajë dispozita me të cilat konsumatori heq dorë nga të drejtat e garantuara me këtë ligj si dhe duhet të jetë në pajtim me parimet e nenit 70 të këtij ligji.

2. Ofruesi i shërbimeve financiare duhet të mbajë në dosjen e çdo konsumatori marrëveshjen dhe dokumentacionin e marrëveshjes që ka të bëjë me konsumatorin e tillë, duke përfshirë ofertën, draft marrëveshjen, përmbledhjen e elementeve të detyrueshme, planin e ripagimit / pagesës, aneksin e marrëveshjes që përmban orarin e ri të ripagimit, njoftimet dhe dokumentacion tjetër me natyrë të ngjashme.

Neni 78 **Detyrimi për të vlerësuar aftësinë kreditore të konsumatorit**

1. Pavarësisht nga dispozitat e ligjit përkatës për mbrojtjen e konsumatorit, bankat përpara se të lidhin një marrëveshje kreditore, marrëveshje të autorizuar mbi mbitërheqjen, marrëveshje për lëshimin dhe përdorimin e kartelës kreditore ose marrëveshjen e lizingut, duhet të vlerësojnë aftësinë kreditore të konsumatorit në bazë të të dhënave të paraqitura nga konsumatori dhe duke u konsultuar me Regjistrin Kreditor të Kosovës (RKK) dhe bazave tjera të të dhënave mbi borxhin e konsumatorit, me pëlqimin paraprak me shkrim të konsumatorit.

2. Nëse palët kontraktuese bien dakord të rrisin detyrimin e konsumatorit, banka duhet të rivlerësojë aftësinë kreditore të konsumatorit.

3. Nëse kërkesa për kredi, mbitërheqje të autorizuar, lëshimi i kartelës kreditore ose lizingu refuzohet në bazë të konsultimit nga baza e të dhënave nga paragrafi 1. i këtij neni, banka duhet të njoftojë menjëherë konsumatorin, me shkrim dhe pa pagesë, rezultatin në bazë të të dhënave të konsultuara.

4. Bazat e të dhënave nga paragrafi 1. i këtij neni përmban të dhënat për përpunimin e të cilave konsumatori ka dhënë pëlqimin paraprak me shkrim, veçanërisht të dhënat për borxhet e tij ndaj institucioneve financiare dhe rregullsinë e shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i shërbimeve financiare.

5. Banka duhet të kujdeset që në vlerësimet e saj të mos shkaktojë mbingarkesë apo të cenojë minimumin e jetesës së kredimarrësit apo buxhetit familjar.

Neni 79

Krahasueshmëria e tarifave, qasja në një llogari të pagesave me shërbime bazike dhe shërbimi i ndërrimit të llogarisë

1. Për të krahasuar tarifat e ngarkuara nga bankat për shërbimet e tyre, BQK-ja publikon në faqen e saj të internetit një krahasim të tarifave në një listë të shërbimeve të lidhura me një llogari pagesash.
2. Konsumatorët me vendbanim në Republikën e Kosovës kanë të drejtë të hapin dhe përdorin një llogari të pagesës me shërbime bazike. Një llogari e pagesës me shërbime bazike përfshin shërbimet bazë të përcaktuara me rregullore nga BQK-ja.
3. Bankat duhet të sigurojnë një llogari të pagesës me shërbime bazike dhe shërbimin e ndërrimit të llogarisë me kërkesën e një konsumatori.
4. BQK-ja rregullon më tej krahasueshmërinë e tarifave, qasjen në një llogari të pagesave me shërbime bazike dhe shërbimet e ndërrimit të llogarisë.

Neni 80

Raportet dhe ekzaminimet

1. Çdo bankë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në BQK raportet mbi gjendjen e tyre financiare, performancën dhe rreziqet, sipas kërkesës dhe në intervale të rregullta. Këto raporte ofrojnë informacione të tilla si asetet dhe detyrimet bilancore dhe jashtë bilancore, fitimi dhe humbja, mjaftueshmëria e kapitalit, likuiditeti, ekspozimet e mëdha, koncentrimet e rrezikut (duke përfshirë sektorin ekonomik, gjeografik dhe valutor), cilësinë e aseteve, provizionet për humbjet nga kreditë, transaksionet me personat e ndërlidhur, rrezikun e normës së interesit, rrezikun e tregut, tarifat dhe komisionet, dhe informacione të tjera të kërkuara nga BQK-ja dhe ato të subjekteve të varura në baza individuale dhe të konsoliduara. Raportet duhet të përgatiten në formë dhe në detajet e kërkuara të cilat dorëzohen në intervale të tilla që përcaktohet nga BQK-ja.
2. Çdo bankë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në BQK projeksionet financiare për tre (3) vitet e njëpasnjëshme. Projeksionet financiare përgatiten në formë dhe detaje dhe dorëzohen në intervale të tilla që përcaktohet nga BQK-ja.
3. Çdo bankë dhe çdo filial i saj është subjekt i ekzaminimeve nga BQK-ja, që përfshin ekzaminimin nga ekspertët e jashtëm të caktuar nga BQK-ja. Ekzaminerët mund t'i vizitojnë bankat brenda kohës së arsyeshme që konsiderohet e përshtatshme nga BQK-ja dhe mund të ndërmarrin veprime që konsiderohen të nevojshme dhe të këshillueshme. Ekzaminerët mund të jenë zyrtarë të autoritetit të një vendi tjetër të huaj të ngarkuar me mbikëqyrjen monetare ose prudenciale të veprimtarive financiare në atë vend nëse ekzaminimi bëhet për një bankë që është degë ose filial i një banke të huaj që ka zyrën e saj qendrore në atë vend ose ka një interes të konsiderueshëm në një bankë të huaj që është e vendosur në atë vend.
4. Në ekzaminimet e bankave dhe filialeve të tyre, BQK-ja dhe ekzaminerët e caktuar mundën:

- 4.1. të ekzaminojë llogaritë, librat, dokumentacionin dhe regjistrimet (të dhënat) e tjera të bankës a të subjektit të varur, dhe
- 4.2. të kërkojnë nga drejtorët dhe menaxherët e lartë, punonjësit dhe agjentët e bankës ose filialeve që t'ju ofrojnë të gjitha informacionet ose çështjet tjera lidhur me administrimin dhe operacionet e saj që ata me arsye mund t'i kërkojnë.
5. Çdo bankë dhe çdo filial e saj duhet të pranojë dhe bashkëpunojë plotësisht me ekzaminerët e BQK-së dhe ekspertët e jashtëm të caktuar nga BQK-ja. Askush nuk ka të drejtë të përpiqet të provokojë, pengojë, vonojë, ndalojë, frikësojë ose të ushtrojë ndikim të pajustificuar ndaj një ekzamineri të BQK-së ose ekspertëve të jashtëm të caktuar prej saj.
6. Çdo filial i bankës dhe ofruesit e shërbimeve operacionale ose profesionale për bankat i japin informacion BQK-së që BQK-ja me arsye mund të kërkojë lidhur me operacionet dhe marrëdhëniet e bankës me këta persona.
7. BQK-ja mund t'i kërkojë raportet dhe të kryej ekzaminimet e parapara në këtë nen të ndonjë anëtari shtesë të grupit bankar, nëse këtë e konsideron të nevojshme për mbikëqyrje të konsoliduar.
8. Mbikëqyrja e konsoliduar përfshinë pa kufizim, vlerësimin e strukturës organizative të grupit, menaxhmentit, politikave për menaxhim të rrezikut dhe kontroleve të brendshme.
9. Raportet e ekzaminimit janë konfidenciale dhe i drejtohen bankës së ekzaminuar dhe nuk janë për përdorim nga asnjë autoritet tjetër, përveç nëse me vendim të gjykatës konsiderohen si prova në interes publik.
10. Përfundimisht nga paragrafi 9. i këtij neni, BQK mund të shpalojë raportet e ekzaminimeve para autoriteteve mbikëqyrëse rajonale apo ndërkombëtare, që ka marrëveshje paraprake për konfidencialitet.

NËNKAPITULLI VIII ZBATIMI DHE MASAT PËRMIRËSUESE

Neni 81 Urdhrat e pajtueshmërisë

1. Nëse BQK-ja konstaton se një bankë është në shkelje ose ka mundësi të jetë në shkelje të këtij ligji dhe instrumenteve rregullative të miratuar nga BQK-ja, ose ka shkelur ndonjë kusht ose kufizim të bashkangjitur me një autorizim të lëshuar nga BQK-ja, ose është angazhuar në praktika të pasigurta ose të paqëndrueshme në gjykimin e BQK-së, BQK informon atë bankë me shkrim për konstatimet e saj dhe urdhëron ndërprerjen e veprimit të tillë dhe urdhëron përmirësimin e shkeljes duke përfshirë shqiptimin e masave mbikëqyrëse mbi bankën dhe kryerjen detyrave shtesë.

2. Gjatë përcaktimit të masave mbikëqyrëse, BQK-ja merr parasysh të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me një shkelje me qëllim që të sigurojë përmirësimin efektiv të shkeljes përmes shqiptimit së këtyre masave dhe të parandalojë veprimet ose mosveprimet e mëtejme që konsiderohen shkelje të këtij ligji, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, dhe në veçanti merr në konsideratë:

2.1. seriozitetin dhe kohëzgjatjen e shkeljes dhe shkallën e përgjegjësisë së personit që ka kryer shkeljen;

2.2. gjendjen financiare të personit që ka kryer shkeljen, dhe fitimin e fituar ose humbjen e shmangur me anë të shkeljes, nëse ato mund të përcaktohen;

2.3. humbjet e shkaktuara nga palët e treta për shkak të shkeljes, nëse ato mund të përcaktohen;

2.4. bashkëpunimin e personit që ka bërë shkelje në procesin e identifikimit të shkeljes, dhe

2.5. shkeljet e mëparshme dhe pasojat e mundshme sistemike të shkeljes.

Neni 82

Masat përmirësuese dhe ndëshkuese

1. BQK-ja mund të shqiptoj masat e mëposhtme, ose ndëshkimet e mëposhtme për drejtorët dhe menaxherët e lartë, punonjësit, aksionarët kryesor ose ata që mbajnë interesa kualifikuese në një bankë, nëse konstatohet se një person i tillë ka shkelur një dispozitë të këtij ligji ose ndonjë instrumenti rregullativ ose vendimi të BQK-së, ka shkelur ndonjë kusht ose kufizim të bashkangjitur në një autorizim të lëshuar nga BQK-ja ose ka marrë pjesë në praktika të pasigurta ose të pashëndosha në gjykimin e BQK-së:

1.1. jep vërejtje me shkrim;

1.2. vendosë gjoba deri në dhjetë mijë (10,000) euro për çdo ditë që shkelja vazhdon me kusht që për të njëjtat shkelje gjobat të jenë në shuma të ngjashme për subjektet me shuma të krahasueshme të aseteve;

1.3. përjashton ose suspendon personin nga pozita e tij në bankë;

1.4. ndalon këtë person të punojë ose të angazhohet në veprimtari bankare ose financiare për një periudhë të caktuar ose përgjithmonë;

1.5. kërkon nga personi të paguajë bankën për humbjet e shkaktuara nga këto shkelje;

1.6. suspendon ushtrimin të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të së drejtës së votimit që lidhet me aksionet e bankës;

1.7. kërkon nga personi që të transferoj plotësisht ose pjesërisht pjesën e tij të pronësisë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ka në bankë ose të pushojë mbajtjen e një interesi të konsiderueshëm në bankë;

1.8. ndalon pagesën e shpërndarjeve të kapitalit ose të dividendëve për personin e tillë, dhe

1.9. lidh marrëveshje me shkrim me bordin e drejtorëve për sigurimin e një programi për ndërmarrjen e masave përmirësuese.

2. BQK-ja mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme ose të vendosë ndëshkimet e mëposhtme në një bankë, nëse konstatohet se banka ka shkelur një dispozitë të këtij ligji ose të ndonjë instrumenti ose vendimi rregullator të BQK-së, ka shkelur ndonjë kusht ose kufizim të bashkëngjitur në një autorizim të lëshuar nga BQK-ja ose është angazhuar në praktika të pasigurta ose të paqëndrueshme sipas gjykimit të BQK-së, si në vijim:

2.1. jep vërejtje me shkrim;

2.2. shqipton masa për të zvogëluar rreziqet që një bankë merr në lidhje me transaksionet specifike, produktet apo sistemet, duke përfshirë:

2.2.1. ndalimin ose kufizimin e zgjerimit të rrjetit të degëve të bankës, ose kërkesa për të zvogëluar rrjetin e degëve të bankës;

2.2.2. ndalimin ose kufizimin e veprimtarive të bankës që paraqesin rrezik material për pozicionin financiar të bankës.

2.3. Ndalon ose kufizon përmbushjen e transaksioneve individuale ose transaksioneve të llojeve të veçanta dhe kërkon një reduktim gradual të numrit të transaksioneve të përfunduara, duke marrë parasysh opsionet e përfundimit të parakohshëm në përputhje me marrëveshjet kontraktuale, përfshirë ndalimin ose kufizimin e përfundimit të transaksioneve nga banka:

2.3.1. me personat që paraqesin rrezik të shtuar për bankën për shkak të një vlerësimi të papërshtatshëm kreditor ose rrethanave të tjera, ose

2.3.2. me aksionarë individualë, anëtarë të bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë, ndërmarrjet me të cilat banka është në marrëdhënie të ngushtë, fondet e investimit të menaxhuara nga një shoqëri investuese me të cilën banka është në marrëdhënie të ngushtë, ose ndërmarrje të tjera dhe persona që përfaqësojnë rrezik të shtuar për bankën.

2.4. ndalon ose kufizon përdorimin e kritereve të kontabilitetit që rezultojnë në shpalosjen e informacionit të pasaktë të pozicionit financiar ose rezultateve të një banke dhe përcaktimin e kritereve të përshtatshme;

2.5. kufizon shpërblimin variabil të punonjësve që aplikojnë një përqindje të përshtatshme të të ardhurave të përgjithshme për vitin financiar, nëse pagesa e asaj

pjesë të shpërblimit do të rrezikonte përmbushjen e detyrimeve ose planifikimeve lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës;

2.6. vendosë kërkesa shtesë lidhur me kërkesat e likuiditetit, duke përfshirë kufizimet në lidhje me përputhjen e maturimit të kërkesave dhe detyrimeve të një banke;

2.7. kërkon raportime shtesë dhe më të shpeshta nga një bankë, veçanërisht në lidhje me kapitalin dhe likuiditetin e bankës;

2.8. urdhër me shkrim për të pushuar dhe për t'i mënjanuar shkeljet e tilla dhe për të ndërmarrë veprime përmirësuese;

2.9. të lidh një marrëveshje me shkrim me Bordin e Drejtorëve që parashikon një program veprimi përmirësues;

2.10. shqipton gjoba deri në dhjetë mijë (10,000) Euro për secilën ditë që shkelja vazhdon me kusht që gjobat të jenë të një shume të ngjashme me entitetet me shumica të aseteve të krahasueshme për të njëjtin lloj të shkeljes;

2.11. cakton një Administrator Zyrtar në pajtim me nenin 89 dhe nenin 90 të këtij ligji; dhe

2.12. revokon licencën e bankës.

3. Veprimet përmirësuese të përmendura sipas paragrafit 2. të këtij neni mund të përfshijnë pa kufizim, një a më tepër nga veprimet e mëposhtme:

3.1. të kërkojë që gjithsej asetet mesatare të bankës gjatë çdo tremujori kalendarik të mos tejkalojnë asetet mesatare të saj gjatë tremujorit të mëparshëm kalendarik ose të kërkojë nga banka që ta liroj veten nga asetet specifike ose të zvogëlojë asetet;

3.2. të kërkojë nga banka që të mos përvetësoj pjesëmarrje aksionare në ndonjë person juridik, të themelojë ose të përvetësojë ndonjë zyrë shtesë të degës ose të angazhohet në ndonjë linjë të re afarizmi;

3.3. të kërkojë që banka të mos japë ndonjë ekspozim ndaj një pale të caktuar përfshirë subjektet e varura të saj;

3.4. të kufizojë në mënyra tjera ose ndalojë transaksionet me filialet;

3.5. të kërkojë që normat e interesit që banka paguan për depozitat të mos tejkalojnë normat mbizotëruese të interesit për depozitat e shumave dhe maturimeve të krahasueshme në rajonin ku ndodhet banka, siç përcaktohet nga BQK-ja;

3.6. të kërkojë që banka ose ndonjë prej subjekteve të varura të saj të ndryshojë, zvogëlojë ose përfundojë çdo veprimtari që BQK-ja përcakton se ka shkaktuar ose mund të shkaktojë humbje materiale për bankën;

- 3.7. të kërkojë që banka të shkarkojë një ose më shumë drejtorë ose menaxherë të lartë, siç përcaktohet nga BQK-ja;
 - 3.8. të kërkojë që banka të transferoj ose të likuidojë ndonjë subjekt të varur;
 - 3.9. të kufizojë pagesën e shpërblimeve ose kompensimin e tepërt për çdo drejtor ose menaxher të lartë, dhe
 - 3.10. të kufizojë shpërndarjen e kapitalit ose të dividendës.
4. Masat dhe ndëshkimet e parashikuara në këtë nen nuk përjashtojnë zbatimin e gjobave administrative ose sanksioneve penale siç parashikohet në legjislacionin në fuqi.
 5. Të ardhurat nga çdo ndëshkime vendosur në përputhje me këtë kapitulli paguhet buxhetit të Republikës së Kosovës.
 6. Çdo person që angazhohet në pranimin e paautorizuar të depozitave, në kundërshtim me nenin 11 të këtij ligji, pavarësisht nga dispozitat e tjera të ligjit, dënohet sipas kodit përkatës penal. Përveç kësaj, BQK-ja mund të shqiptojë ndëshkim plotësues deri në dhjetë mijë (10,000) Euro për çdo ditë që shkelja vazhdon dhe ka autorizim për të kërkuar likuidimin e detyruar të bankës të një personi të tillë sipas dispozitave të ligjit në fuqi.
 7. Masat ndëshkuese dhe përmirësuese të parashikuara në Kapitullin II të këtij ligji zbatohen pa paragjykuar kompetencat specifike të dhëna BQK-së në Kapitullin III të këtij ligji.

Neni 83

Gjobat administrative

1. Një shkelje me efekt material mbi qeverisjen e sigurt dhe të kujdesshme (prudenciale) të bankës konsiderohet të ekzistojë nëse shkelja ka apo parashihet të ketë pasoja të rëndësishme për pozicionin financiar të bankës ose për menaxhimin e rrezikut ndaj të cilit është e ekspozuar në veprimtarinë e saj, nëse banka nuk siguron ose vlerësohet që nuk ka siguruar rregullimin e duhur të qeverisjes korporative. Në raste të tilla BQK-ja mund të shqiptoj gjobat administrative të mëposhtme:

1.1. Një gjobë prej pesëdhjetëmijë (50,000) euro deri në dhjetë për qind (10%) të gjithsej qarkullimit neto vjetor të bankës për shkeljet në vijim:

1.1.1. dështimin për të siguruar kapitalin rregullator dhe për të plotësuar kërkesat për kapital në përputhje me nenin 19 dhe 21 të këtij ligji;

1.1.2. shpërndarjen e fitimeve dhe dividendës në kundërshtim me kufizimet nga neni 30 i këtij ligji;

1.1.3. dështimin për të plotësuar kërkesat për likuiditet në përputhje me nenin 31 të këtij ligji;

1.1.4. dështimin për të organizuar ose funksionalizuar auditimin e brendshëm në përputhje me nenin 50 të këtij ligji;

1.1.5. përvetësimin e aksioneve në formë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ndonjë person tjetër juridik në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji;

1.1.6. zhvillimin e veprimtarive tjera përveç shërbimeve bankare, shërbimeve shtesë financiare ose shërbimeve bankare pa autorizimin paraprak të BQK-së në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;

1.1.7. dështimin për të mbajtur kufijtë maksimal për ekspozimet e mëdha në përputhje me nenin 24 të këtij ligji;

1.1.8. hyrjen në transaksion me personat e ndërlidhur në kundërshtim me nenin 25 të këtij ligji;

1.1.9. dështimin për të siguruar dhe zhvilluar politikat dhe procedurat e brendshme në përputhje me nenin 28 të këtij ligji;

1.1.10. dështimin për të përgatitur dhe mirëmbajtur regjistrimet me shkrim në përputhje me nenin 67 të këtij ligji;

1.1.11. mbajtjen e llogarive dhe shënimeve si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në kundërshtim me nenin 66 të këtij ligji;

1.1.12. dështimin për të publikuar pasqyrat financiare dhe raportin vjetor të audituar brenda katër (4) muajve nga përfundimi i vitit të saj financiar në përputhje me nenin 69 të këtij ligji;

1.1.13. dështimin për të raportuar në BQK në përputhje me nenin 80 të këtij ligji;

1.1.14. dështimin për të bashkëpunuar në mënyrë të plotë me ekzaminerët e BQK-së në përputhje me nenin 80 të këtij ligji.

2. Për shkeljet ku përgjegjës është personi nga Menaxhmenti i Lartë dhe/ose Bordit të Drejtorëve, BQK shqipton gjobë nga një mijë (1,000) Euro deri në pesëdhjetë mijë (50,000) Euro për shkeljet e mëposhtme:

2.1. dështimi për tu siguruar që banka operon në përputhje me rregulloret e BQK-së; dhe

2.2. dështimi për të qenë në pajtueshmëri me nenet 44 dhe 48 të këtij ligji.

3. Krahas paragrafit 1. të këtij neni, nëse BQK konstaton se banka ka realizuar përfitim material nga shkelja, shqipton gjobë administrative deri në dy (2) herë sa shuma e përfitimit të realizuar nga shkelja, kur mund të përcaktohet ky përfitim.

Neni 84

Masat përmirësuese dhe gjobat administrative në procesin e rimëkëmbjes dhe përmbylljes dhe likuidimit

1. Shkeljet në kuadër të procesit të rimëkëmbjes dhe përmbylljes, pa paragjykuar zbatueshmërinë e nenit paraprak, BQK shqipton një gjobë prej pesëdhjetëmijë (50,000) euro deri në dhjetë për qind (10%) të gjithsej qarkullimit neto vjetor të bankës për shkeljet në vijim:

1.1. dështimin për të hartuar, mirëmbajtur dhe përditësuar planet e rimëkëmbjes dhe planet grupore të rimëkëmbjes në shkelje të nenit 87 të këtij ligji;

1.2. dështimin për të siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e planeve të përmbylljes në shkelje të nenit 104 të këtij ligji;

1.3. dështimin për të njoftuar për qëllimin e ofrimit të mbështetjes financiare grupore për BQK-në në shkelje të nenit 88 të këtij ligji.

2. Krahas paragrafit 1. të këtij neni, nëse BQK konstaton se banka ka realizuar përfitim material nga shkelja, shqipton gjobë administrative deri në dy (2) herë sa shuma e përfitimit të realizuar nga shkelja, kur mund të përcaktohet ky përfitim.

3. Për shkeljet në paragrafin 1. të këtij neni BQK-ja, si autoritet i përmbylljes, krahas gjobave administrative, mund të shqiptoj masat përmirësuese si në vijim:

3.1. lëshimin e një deklaratë publike e cila tregon përgjegjësinë e bankës dhe natyrën e shkeljes;

3.2. një urdhër ndaj bankës përgjegjëse për ndërprerjen e sjelljes dhe detyrimin për mos përsëritje të asaj sjelljeje.

4. BQK si autoritet i përmbylljes, mund të vendosë një ndalim të përkohshëm për të ushtruar funksione në banka dhe / ose gjobë deri në një milion (1,000,000) Euro për Menaxhmentin e Lartë ose Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, për shkeljet e mëposhtme:

4.1. dështimi për të njoftuar BQK-në kur banka është duke dështuar ose ka mundësi të dështojë, duke shkelur nenin 106 të këtij ligji, dhe

4.2. çdo shkelje e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni kur anëtarët e Bordit të Drejtorëve janë direkt përgjegjës.

5. Për shkeljet në procedurën e likuidimit sipas nenit 129 të këtij ligji:

5.1. Çdo person i cili qëllimisht ndërhyjnë në qasjen e likuidatorit në mjediset e bankës ose në kontrollin e zyrave, librave të llogarive dhe regjistrimeve të tjera, si dhe të aseteve të tjera të një banke për të cilën ai ose ajo është emëruar, dënohet me burgim për një periudhë prej një (1) viti deri në pesë (5) vjet ose me gjobë prej një

mijë (1000) euro deri në pesë mijë (5000) euro në ditë për çdo ditë që vazhdon shkelja ose të dyja bashkë.

Neni 85

Gjoha administrative ndaj kompanive të auditimit dhe auditorevë të certifikuar

1. BQK shqipton një gjobë nga një mijë (1,000) Euro deri në pesëdhjetë mijë (50,000) Euro për kompaninë e auditimit apo auditorin e certifikuar për shkeljet e mëposhtme:

1.1. dështimi për të kryer një auditim ose për të përgatitur një raport të auditorit brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 68 të këtij ligji;

1.2. dështimi për të njoftuar Bordin e Drejtorëve menjëherë me faktet dhe rrethanat nga paragrafi nën-paragrafi 1.3. i nenit 68 të këtij ligji.

Neni 86

Matja e qarkullimit neto vjetor

Për qëllim të shqiptimit të gjobave administrative sipas këtij ligji, qarkullimi neto vjetor nënkupton gjithsej të hyrat neto para shpenzimeve nga zhvlerësimi dhe operative, por duke përfshirë të hyrat neto nga interesi, të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet, të hyrat neto nga tregtimi dhe të hyrat e tjera operative për vitin afarist paraprak, dhe duhet të jenë në koherencë me pasqyrat financiare të audituara sipas SNRF-ve të bankës.

KAPITULLI III

ADMINISTRIMI ZYRTAR, RIMËKËMBJA DHE PËRMBYLLJA

NËNKAPITULLI I

ADMINISTRIMI ZYRTAR, RIMËKËMBJA DHE NDËRHYRJA E HERSHME

Neni 87

Planet e rimëkëmbjes

1. Siç përcaktohet më tutje nga BQK-ja me rregullore, bankat duhet të hartojnë dhe mbajnë një plan të rimëkëmbjes i cili ofron masa për të rivendosur gjendjen e saj financiare pas një përkeqësimi të konsiderueshëm të gjendjes së saj financiare. Planet e rimëkëmbjes duhet të përfshijnë një gamë të gjerë të opsioneve të rimëkëmbjes dhe procedurave të përshtatshme për të siguruar zbatimin në kohë të veprimeve të rimëkëmbjes, bazuar në një varg skenarësh të kushteve të rënda stresuese makroekonomike dhe financiare. Planet e rimëkëmbjes nuk duhet të marrin asnjë qasje apo pranim të mbështetjes të jashtëzakonshme publike financiare.

2. Planet e rimëkëmbjes duhet të vlerësohen dhe miratohen nga Bordi i Drejtorëve të secilës bankë, para dorëzimit të tyre në BQK, e cila vepron si autoritet mbikëqyrës.

3. Grupet bankare hartojnë dhe i dorëzojnë BQK-së planet e rimëkëmbjes grupore në kushtet e dhëna nga rregullorja e cila nxirret nga BQK-ja.

Neni 88 **Ndërhyrja e hershme**

1. Masat e ndërhyrjes së hershme zbatohen nga BQK-ja në situatat në vijim:

1.1. kur një bankë i shkel kërkesat e kapitalit rregullator të përcaktuara në rregulloren e BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave; apo

1.2. nëse, ndër të tjera, për shkak të një gjendjeje financiare që përkeqësohet me shpejtësi, duke përfshirë përkeqësimin e situatës së likuiditetit, rritjen e nivelit të leverazhit, rritja e kredive jo performuese apo koncentrimi i ekspozimeve, një bankë me shumë mundësi do të shkelë në të ardhmen e afërt, kërkesat e kapitalit rregullator të përcaktuara sipas rregullativës së BQK-së.

2. Nëse ndodhë ndonjë nga situatat e paragrafit 1. të këtij neni, BQK-ja, si autoritet mbikëqyrës, mund t'i kërkojë Bordit të Drejtorëve të bankës:

2.1. implementimin e masave të përcaktuara në planin e rimëkëmbjes, apo përditësimin e planit të tillë të rimëkëmbjes nëse rrethanat që çojnë në ndërhyrje të hershme janë të ndryshme nga supozimet e përcaktuara në planin fillestar të rimëkëmbjes, dhe të zbatojnë masat e përcaktuara në planin e përditësuar brenda një afati kohor të caktuar;

2.2. shqyrtimin e situatës, identifikimin e masave për të tejkaluar çdo problem të identifikuar dhe hartimin e një program veprimi për të tejkaluar këto probleme dhe një afat kohor për zbatimin e tij;

2.3. thirrjen e takimit të kuvendit të aksionarëve të bankës duke e caktuar agjendën dhe duke kërkuar vendime të caktuara për t'u marrë parasysh për miratim, pa paragjykuar se BQK-ja, si autoritet mbikëqyrës, mund të thërrasë drejtpërdrejtë një takim të tillë nëse Bordi i Drejtorëve dështon për ta thirrur një takim të tillë;

2.4. hartimin e planit për negociim në ristrukturimin e borxhit me disa apo me të gjithë kreditorët e vet sipas planit të rimëkëmbjes;

2.5. të kërkojë ndryshime në strategjinë afariste të bankës, apo strukturës ligjore apo operacionale.

3. Përveç masave të mësipërme, BQK, si autoritet mbikëqyrës, gjithashtu mund t'i kërkojë një apo më shumë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve apo Menaxhmentit të Lartë që të shkarkohen apo të zëvendësohen nëse këta persona janë të papërshtatshëm për të kryer detyrat e tyre.

4. Kur ekziston një përkeqësim i ndjeshëm apo i konsiderueshëm në gjendjen financiare të një banke apo kur ekzistojnë shkelje serioze të ligjit, rregulloreve apo statuteve të bankës, apo parregullsive të rënda administrative dhe masat e tjera të marra në përputhje me paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni nuk janë të mjaftueshme për ta ndryshuar atë përkeqësim,

BQK-ja si autoritet mbikëqyrës mund të kërkojë shkarkimin e Menaxhmentit të Lartë apo Bordit të Drejtorëve të bankës, në tërësi ose në lidhje me individët.

5. Nëse zëvendësimi i Menaxhmentit të lartë ose Bordit të drejtorëve, siç është referuar në paragrafin 4. të këtij neni, konsiderohet i pamjaftueshëm nga BQK-ja, për të korrigjuar situatën, BQK-ja, duke vepruar në kushte të tilla, mund të emërojë një administrator zyrtar, në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli për qëllim përmbylljes sipas këtij ligji. BQK-ja si autoritet mbikëqyrës, ka kompetencën ekskluzive për të shkarkuar administratorin zyrtar të tillë në çfarëdo kohe dhe për çfarëdo arsye.

6. Kompanitë amë të grupeve bankare dhe filialeve të tyre të mbuluara nga mbikëqyrja e konsoliduar, mund të hyjnë në marrëveshje brenda grupit për të siguruar mbështetje financiare për çdo subjekt të varur që plotëson kushtet për ndërhyrje të hershme sipas këtij neni, sipas kushteve që përcaktohen nga BQK-ja në rregulloren përkatëse. Grupet bankare duhet të aplikojnë për miratimin e BQK-së, për realizimin marrëveshjeve të tilla.

Neni 89

Arsyet për emërimin e një administratori zyrtar

1. Pa paragjykuar zbatimin e paragrafit 5. të nenit 88 të këtij ligji, BQK-ja mund ta caktojë një administrator zyrtar në një bankë nëse:

1.1. banka ka shkelur ndonjë dispozitë të ligjit ose të rregullores, apo është angazhuar në praktika të pasigurta dhe jo të shëndosha, në atë mënyrë që dobëson gjendjen e bankës, rrezikon rëndë interesat e depozitarëve apo shpërndanë asetet e bankës në kundërshtim me këtë ligj;

1.2. ekziston shkaku i arsyeshëm për të besuar se banka ose menaxherët e lartë ose drejtorët e saj janë përfshirë në veprimtari penale të dënueshme me burgim prej një (1) viti a më shumë, në atë mënyrë që rrezikon interesat e depozitorëve;

1.3. banka është në gjendje të pasigurtë ose jo të shëndoshë për të ushtruar veprimtari dhe se banka apo drejtorët dhe menaxherët e lartë të saj nuk janë në gjendje ta përmirësojnë këtë gjendje në formë të menjëhershme;

1.4. banka dështon në çdo mënyrë të bashkëpunojë me BQK-në ose me ekzaminerët e saj dhe i'a pamundëson BQK-së të ushtrorë përgjegjësitë e saj mbikëqyrëse, duke përfshirë fshehjen ose dështimin për t'i paraqitur për inspektim ndonjë nga librat, dokumentet ose regjistrimet e bankës;

1.5. banka ose menaxherët e lartë, drejtorët, punonjësit ose aksionarët kryesor nuk veprojnë në pajtueshmëri me urdhëresën e BQK-së sipas Kapitullit II të këtij ligji;

1.6. banka, me vendim të drejtorëve ose të aksionarëve kryesor, kërkon emërimin e një administratori zyrtar;

1.7. ky emërim caktohet nga BQK në kontekst të masave për ndërhyrje të hershme;

1.8. në bankë tjetër ose ndonjë aksionar që mban një interes të konsiderueshëm në një bankë ballafaqohet me rrezikun që të bëhet josolvente ose dështon në plotësimin e kërkesave rregullative lidhur me kapitalin ose likuiditetin nga mbikëqyrësi i vendit amë ose në vendin amë të zyrës qendrore të korporatës së saj.

2. Vendimi i BQK-së për emërimin e një administratori zyrtar specifikon kushtet sipas të cilave ai është emëruar. Me këtë vendim, pa vonesë njoftohet banka që i nënshtrohet administrimit zyrtar dhe shënohet në regjistrin e mbajtur në përputhje me nenin 4 të këtij ligji.

Neni 90

Emërimi dhe shkarkimi i administratorit zyrtar

1. Administratori zyrtar duhet të emërohet nga BQK-ja për një periudhë që nuk i tejkalon gjashtë (6) muaj, siç specifikohet në vendimin e BQK-së. Afati i emërimit mund të vazhdohet nga BQK-ja vetëm dy (2) herë, për një periudhë që nuk tejkalon, në secilin rast, tre (3) muaj. Nëse administratori zyrtar nuk i ka zgjidhur çështjet për të cilat është emëruar t'i zgjidhë pas një periudhe prej dymbëdhjetë (12) muajve, atëherë licenca do të revokohet dhe do të fillojë procesi i likuidimit të detyruar të bankës në pajtim me Kapitullin IV të këtij ligji.

2. Nëse rrethanat për të cilat emërohet administratori zyrtar nuk zgjidhen pas një periudhe prej dymbëdhjetë (12) muajve, atëherë revokohet licenca e bankës dhe fillon procesi i likuidimit në përputhje me Kapitullin IV të këtij ligji, përveç nëse emërimi i administrimit zyrtar ishte vendosur në kontekst të masave të ndërhyrjes së hershme, për të cilën Kapitulli III të këtij ligji aplikohet në kontekst të Përmbylljes.

3. Administratori zyrtar mund të jetë një person nga sektori privat ose një zyrtar i BQK-së i cili plotëson kualifikimet e përcaktuara nga BQK-ja në rregulloren përkatëse.

4. BQK-ja ia paraqet një njoftim me shkrim bankës për emërimin e administratorit zyrtar.

5. Vendimi i BQK-së për emërimin e një administratori zyrtar të bankës është efektiv nga koha e specifikuar në vendim ose, nëse koha nuk specifikohet, nga koha kur është dhënë njoftimi sipas paragrafit 4. të këtij neni.

6. Me rastin e emërimit, të gjitha kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e aksionarëve dhe drejtorëve ose menaxherëve të lartë të bankës i barten administratorit zyrtar, përveç nëse administratori kërkon nga aksionarët, drejtorët ose menaxherët e lartë që të kryejnë ndonjë veprimtari të paraparë me këtë ligj. Çdo veprim a vendim i marrë në emër dhe për llogari të bankës gjatë administrimit zyrtar është i pavlefshëm, përveç nëse ato merren nga dhe nën autoritetin e administratorit zyrtar. Përrjashtimisht, nëse administratori zyrtar, emërohet në kontekstin e masave të ndërhyrjes së hershme, administratori zyrtar ka vetëm kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e bordit të drejtorëve të bankës.

7. BQK-ja mund ta shkarkojë administratorin zyrtar para përfundimit të mandatit të specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni më lartë dhe ta caktojë një zëvendësim të kualifikuar. BQK-ja duhet të sigurojë që banka në çdo kohë të mbetet nën kontrollin e administratorit të emëruar zyrtar.

8. Dispozitat e nenit 53 të këtij ligji zbatohen për një administrator zyrtar përveç se çdo obligim për t'i raportuar bordit të drejtorëve do të nënkupton një obligim për t'i raportuar BQK-së. Çdo transaksion, në të cilin administratori zyrtar ka interes material ose marrëdhënie që përfshinë bankën nën administrim zyrtar, mund të bëhet vetëm me miratimin paraprak të BQK-së. Nëse administratori zyrtar nuk shpalos interesin material ose lidhjen ashtu siç kërkohet, kontrata mund të anulohet dhe BQK-ja shkarkon administratorin zyrtar.

Neni 91

Kompetencat dhe detyrat e administratorit zyrtar

1. Administratori zyrtar ka kompetenca të plota dhe ekskluzive për të menaxhuar dhe drejtuar bankën. Administratori zyrtar mund të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm ose të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarive të bankës, mbron dhe ruan asetet dhe pronën e saj apo zbaton planin e veprimit në lidhje me bankën që është miratuar nga BQK-ja.

2. Administratori zyrtar vepron në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe instruksionet e dhëna nga BQK-ja në çdo kohë gjatë administrimit zyrtar dhe i jep llogari vetëm BQK-së për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave si administrator zyrtar. Administratori zyrtar mund t'ua delegojë çdonjërin prej këtyre kompetencave dhe detyrave personave tjerë në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga BQK-ja.

3. Administratori zyrtar pezullon pagesën e çdo dividende ose formave tjera të shpërndarjes së kapitalit tek aksionarët, si dhe çdo pagesë të drejtorëve, përveç për shërbimet e ofruara për bankën janë me kërkesë të administratorit zyrtar.

4. Administratori zyrtar mund të angazhojë, në shpenzime të bankës nën administrim zyrtar, avokatë të pavarur, kontabilistë dhe këshilltarë për ta ndihmuar administratorin zyrtar sipas kushteve të miratuara nga BQK-ja.

5. Nëse administratori zyrtar ka shkak të arsyeshëm të besojë se aksionarët, drejtorët, punonjësit, avokatët, kontabilistët ose profesionistët tjerë kanë qenë të angazhuar ose janë të angazhuar në veprimtari penale të dënueshme me burgim prej një (1) viti a më shumë, ose në veprimtari mashtruese, duhet të njoftojë menjëherë BQK-në dhe duhet të iniciojë procedurën gjyqësore në kërkim të dëmshpërblimit.

Neni 92

Moratoriumi dhe efekti i administrimit zyrtar në procedura dhe kontrata

1. BQK-ja, sipas kërkesës me shkrim të administratorit zyrtar, mund të vendosë një moratorium që pezullon disa ose të gjitha pagesat nga një bankë në kuadër të administrimit zyrtar. Ky paragraf nuk zbatohet për ato raste në të cilat është emëruar administratori zyrtar në kontekstin e masave të ndërhyrjes së hershme.

2. Nëse vendoset në moratorium, atëherë pa pëlqimin e BQK-së:

2.1. një person nuk mund të fillojë ose të vazhdojë procedurën gjyqësore kundër një banke nën administrim zyrtar, dhe

2.2. një person nuk mund të ushtrojë të drejtat sipas hipotekës, ngarkesës ose sigurisë tjetër reale ndaj pronës së një banke nën administrim zyrtar, apo të bëjë ndonjë ekzekutim, propozim për përmbarim të dokumenteve parimore a ngjashëm në raport me një bankë nën administrim zyrtar.

3. Pëlqimi i BQK-së mund të mos marrë parasysh zbatimin e nën-paragrafëve 2.1. dhe 2.2. të këtij neni për ndonjë kreditor ose kategori të kreditorëve.

4. Asnjë e drejtë ose obligim kontraktual palë e cilës është banka nën administrim zyrtar nuk mund të shfuqizohet, përshpejtohet ose ndryshohet vetëm për shkak të emërimit të administratorit zyrtar ose nga ndonjë veprim i ndërmarrë nga administratori zyrtar.

5. Administratori zyrtar mund të kërkojë nga BQK-ja që të nxjerrë një urdhëresë për të gjitha bankat që të ndërpresin menjëherë dhënien e kredive për ndonjërin nga debitorët joperformues të bankës nën administrim zyrtar dhe të subjekteve të tyre të ndërlidhura, e cila urdhëresë mbetet në fuqi deri në kohën kur debitorët joperformues arrijnë marrëveshje me administratorin zyrtar për pagesën e borxhit të kredisë në bankën nën administrim zyrtar. Në vendosjen për të lëshuar një urdhëresë të tillë, BQK-ja mund të marrë parasysh gjendjen financiare të debitorit joperformues dhe ndikimin e mundshëm të urdhëresës në personat e tretë.

6. Moratoriumi nuk do të ndikojë në të drejtat e kundër palëve të bankës nën administrim zyrtar për transferet e pjeshme, bartjen e titullit në një marrëveshje të kolateralit financiar dhe marrëveshjet e kompensimit dhe netimit, detyrimet e siguruara sipas një marrëveshje sigurie, dhe marrëveshjet e financës së strukturuar dhe obligacionet e mbuluara.

Neni 93

Marrja e kontrollit të bankës

1. Menjëherë pas emërimit, administratori zyrtar siguron asetet, pronat, zyrat, librat dhe shënimet e bankës dhe mund të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm ose të përshtatshëm që synojnë atë qëllim, duke përfshirë:

1.1. kufizimin për qasje të jashtme dhe të brendshme në objektet dhe zyrat e bankës;

1.2. ndryshimin e fjalëkalimeve për kompjuterët e bankës dhe dhënien e qasjes vetëm një numri të kufizuar të punonjësve;

1.3. lëshimin për punonjësit e autorizuar të llojit të ri të lejekalimeve për hyrje në mjediset e bankës dhe kontrollimin e qasjes në këto mjediset të punonjësve tjerë.

2. Gjatë administrimit zyrtar, administratori zyrtar ka qasje të pakufizuar për të kontrolluar asetet, pronat, zyrat, dhe librat kontabël dhe shënimet tjera të bankës që është subjekt i administrimit zyrtar.

3. Menjëherë pas kërkesës së administratorit zyrtar, zyrtarët e organeve të rendit duhet të ndihmojnë administratorin zyrtar, nëse është e nevojshme, edhe me anë të përdorimit të forcës, për të mundësuar qasje në çdo objekt të bankës dhe për të marrë kontrollin dhe për

të siguruar ato asete, prona, zyra, libra dhe shënime. Vendimi i BQK-së për emërimin e administratorit zyrtar ka të njëjtin efekt ligjor sikurse të një urdhri të zbatueshëm të gjykatës, që autorizon organet e rendit të ofrojnë një asistencë të tillë.

4. Drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e bankës i vënë në dispozicion administratorit zyrtar të gjitha shënimet dhe dokumentacionin që ka të bëjë me çdo informatë shtesë ose raport të kërkuar nga administratori zyrtar.

Neni 94 **Regjistrimi dhe plani i veprimit**

1. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas emërimit, administratori zyrtar përgatitë dhe i dorëzon BQK-së listën e regjistrimit të aseteve dhe detyrimeve të bankës. Një raport i tillë specifikon asetet sipas profileve të tyre të ndryshme të rrezikut dhe klasifikon kreditë joperformuese.

2. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas emërimit, administratori zyrtar përgatitë dhe i dorëzon BQK-së raportin mbi gjendjen financiare dhe gjasat e ngjarjeve të ardhshme të bankës që është subjekt i administrimit zyrtar.

3. Në raportin e referuar në paragrafin 2. të këtij neni, administratori zyrtar propozon planin e veprimit, ku sipas nevojës, rekomandon rikthimin e bankës në pajtueshmëri me ligjin duke zbatuar një plan të masave përmirësuese të cilat mund të përfshijnë rritjen e kapitalit, apo, nëse banka nuk mund të rehabilitohet, ndonjë linjë tjetër veprimi me qëllim të minimizimit të dëmtimit të depozitorëve dhe ruajtjes së stabilitetit në sektorin bankar. Administratori zyrtar ia paraqet me kohë BQK-së ndonjë raport shtesë ose informacion të kërkuar nga BQK-ja.

Neni 95 **Rritja e kapitalit nga aksionarët ekzistues**

1. Në bazë të raportit të nxjerrë sipas nenit 94 të këtij ligji dhe me miratimin e BQK-së, administratori zyrtar mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme për rritjen e kapitalit përmes emetimit të aksioneve të reja, pasi:

1.1. përcakton nivelin e humbjeve dhe përgatisë bilancin e gjendjes së bankës që mbulon shumën e humbjeve të këtilla përmes fitimeve të bankës, rezervave dhe, nëse është e nevojshme, kapitalit; dhe

1.2. njofton aksionarët ekzistues për shumën e kapitalit shtesë të nevojshëm për kthimin e kapitalit të bankës në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat për kapital dhe t'i lejojë këta aksionarë të regjistrojnë dhe blejnë aksione shtesë, duke paraqitur zotimet detyruese të barabarta me shumën e plotë të kapitalit shtesë të nevojshëm brenda tri ditë pune pas atij njoftimi.

2. Aksionarët ekzistues të bankës në administrim zyrtar nuk kanë të drejta përvetësuese ose të tjera për të blerë aksionet shtesë të emetuara, përveç sikurse rregullohet me këtë nen.

3. Ky nen nuk zbatohet për ato raste në të cilat është emëruar administratori zyrtar në kontekstin e masave të ndërhyrjes së hershme.

Neni 96 **Rikapitalizimi nga aksionarët e rinj**

1. Në bazë të raportit të nxjerrë sipas nenit 94 të këtij ligji dhe me miratimin e BQK-së, administratori zyrtar mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme për rritjen e kapitalit të bankës përmes emetimit të aksioneve për aksionarët e rinj sipas rrethanave në vijim:

1.1 në rast se zotimet detyruese nuk janë paraqitur në shumën e barabartë me shumën e plotë të kapitalit shtesë të nevojshëm për aksionarët ekzistues, apo

1.2. pa i ofruar aksione aksionarëve ekzistues, nëse BQK përcakton se:

1.2.1. është e nevojshme për një zgjidhje e shpejtë në bankë për të ruajtur stabilitetin financiar,

1.2.2. aksionarët ekzistues nuk janë më tej të përshtatshëm për të mbajtur një pozicion të konsiderueshëm të kapitalit në bankë;

1.2.3. ka pasur dështim për të vepruar me kohë në pajtim me masën përmirësuese sipas nenit 95 të këtij ligji që kërkon shtimin e kapitalit të bankës.

2. Për të bërë rikapitalizimin nga aksionarët e rinj, administratori zyrtar duhet:

2.1. nëse tashmë nuk është bërë në përputhje me nenin 95 të këtij ligji, përcaktojë nivelin e humbjeve dhe të përgatisë bilancin e gjendjes së bankës që mbulon shumën e humbjeve të këtilla përmes fitimeve të bankës, rezervave dhe, nëse është e nevojshme, kapitalit;

2.2. nëse është e nevojshme të pasqyrojë humbjet, zvogëlojë vlerën nominale të aksioneve të dhëna, pavarësisht nga ndonjë dispozite tjetër të ligjit;

2.3. të përcaktojë shumën dhe llojin e financimit të nevojshëm për ta kthyer bankën në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat për kapital;

2.4. të bëjë që banka të emetojë aksione në shumën e nevojshme dhe të kryejë shitjen e aksioneve nga banka dhe blerjen e atyre aksioneve nga investitorët e rinj.

3. Pavarësisht nga ndonjë ligj që mund të hyjë në fuqi për rregullimin e tregut të letrave me vlerë ose shpalosjeve tjera nga emetuesit e letrave me vlerë, organi kompetent sipas atij ligji duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të lejuar një emetim të tillë brenda tri (3) ditë pune.

4. Ky nen nuk zbatohet për ato raste në të cilat është emëruar administratori zyrtar në kontekstin e masave të ndërhyrjes së hershme.

Neni 97

Bashkimet, shitjet dhe ristrukturimet tjera

1. Në bazë të raportit të nxjerrë sipas nenit 94 të këtij ligji dhe me miratimin e BQK-së, administratori zyrtar mund të bëjë bashkimin e bankës ose transferimin, e plotë a të pjesshëm, të asetëve dhe detyrimeve të bankës.
2. Transferimi i asetëve dhe detyrimeve të bankës mund të përfshijë transferimin në institucionin urë, e cila është një bankë e themeluar nga qeveria ose BQK-ja për një periudhë të përkohshme me qëllim të zgjidhjes së çështjes së bankës dështuese.
3. Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga BQK-ja, administratori zyrtar, mund ta miratojë ristrukturimin e detyrimeve të bankës përmes marrëveshjeve me kreditorët e bankës, duke përfshirë, zvogëlimin, modifikimin, riprogramimin dhe zëvendësimin e kërkesave të tyre.
4. Asetet dhe detyrimet e bankës nën administrim zyrtar, që transferohen tek një bankë tjetër, përfshinë transferimin e depozitave të siguruara, dhe vetëm nëse vlera e pagesës është me e vogël se sa shumat e transferuar e depozitave të siguruara, atëherë ndryshimi deri në shumën e depozitave të siguruara të transferuara, paguhet nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në bankën tjetër, në përputhje me ligjin që rregullon sistemin e sigurimit të depozitave, me kusht që kostot për mbështetjen e transferimit të mos e kalojnë shumën neto të kompensimit të depozitarëve të mbuluar nëse banka e dështuar do të ishte likuiduar sipas procedurave të rregullta të likuidimit. Pas transferimit të këtyre asetëve dhe detyrimeve të bankës dhe shfrytëzimit të fondeve për sigurimin e depozitave, licenca e bankës nën administrim zyrtar revokohet, dhe banka vendoset në likuidim dhe likuidohet në përputhje me dispozitat e Kapitullit IV të këtij ligji.
5. Ky nen nuk zbatohet për ato raste në të cilat është emëruar administratori zyrtar në kontekstin e masave të ndërhyrjes së hershme.

Neni 98

Shpenzimet e administrimit zyrtar

Administratori zyrtar pranon kompensimin e përcaktuar nga BQK-ja. Të gjitha kostot dhe shpenzimet e bëra në interes të administrimit zyrtar mbulohen dhe i ngarkohen bankës që është subjekt i kësaj procedure.

Neni 99

Ndërprerja e administrimit zyrtar

1. Administrimi zyrtar ndërpritet me skadimin e mandatit të specifikuar në vendimin për emërimin e administratorit zyrtar ose të çdo vazhdimi të mandatit të atij emërimi siç parashihet në nenin 90 të këtij ligji.
2. Administrimi zyrtar ndërpritet para skadimit të mandatit të identifikuar më lartë nëse BQK-ja përcakton se:

2.1. administrimi zyrtar nuk është me tej i nevojshëm sepse shkaqet për emërimin administratorit zyrtar janë zgjidhur apo shuar, ose

2.2. banka nuk mund të rehabilitohet dhe BQK-ja merr vendim për revokimin e licencës së bankës sipas nenit 18 të këtij ligji dhe fillon procedurën për likuidim të detyruar sipas dispozitave të nenit 127 të këtij ligji, ose

2.3. banka i plotëson kushtet për përmbyllje në përputhje me nenin 106 të këtij ligji.

3. Në rast të ndërprerjes së administrimit zyrtar që nuk përfshinë mbylljen e bankës, administratori zyrtar kryen detyrat e drejtorëve ose menaxherëve të lartë të bankës deri në nominimin dhe/ose zgjedhjen e drejtorëve ose menaxherëve të lartë. Pas nominimit dhe/ose zgjedhjes së drejtorëve ose menaxherëve të lartë, administratori zyrtar ia kthen kontrollin e bankës dhe asetëve, pronave, zyrave, librave dhe shënimeve të saj organeve kompetente.

4. Vendimi i BQK-së për të ndërprerë administrimin zyrtar shoqërohet me një rekomandim nga administratori zyrtar dhe me një raport të hollësishëm i përgatitur nga administratori zyrtar në mbështetje të atij rekomandimi.

5. Brenda pesë (5) ditëve të ndërprerjes së emërimit, administratori zyrtar përgatitë dhe ia paraqet BQK-së një raport përfundimtar dhe llogaritjet të administrimit zyrtar.

6. Nëse banka bëhet bankë në proces të përmbylljes, BQK-ja, si autoritet i përmbylljes, mund të vendosë që administratori zyrtar të emërohet ose të zëvendësohet nga një menaxher special në kushtet e parashikuara në nenin 107 të këtij ligji.

NËNKAPITULLI II PËRMBYLLJA DHE TRAJTIMI I DEPOZITAVE

Neni 100 Objektivat e përmbylljes

1. BQK kur aplikon instrumentet e përmbylljes dhe kur i ushtron kompetencat e përmbylljes në zbatim të Kapitullit III të këtij ligji, duhet të ketë parasysh objektivat e përmbylljes si në vijim:

1.1. të siguroj vazhdimësinë e funksioneve kritike të bankës;

1.2. të mënjanoj efektin negativ të konsiderueshëm në sistemin financiar, në veçanti duke parandaluar përhapjen e tyre, përfshirë infrastrukturën e tregut, dhe duke e mbajtur disiplinën e tregut;

1.3. të mbroj fondet publike duke minimizuar ndihmën e mbështetjes së jashtëzakonshme publike financiare;

1.4. të mbroj depozituesit sipas ligjit përkatës mbi sistemin e sigurimit të depozitave për institucionet financiare në Kosovë, dhe

- 1.5. të mbroj fondet dhe pasuritë e klientit.
2. Objektivat e përmbylljes të përmendur më lartë janë të një rëndësie të barabartë. BQK-ja duhet t'i balancojë ato siç mund të jetë e nevojshme, sipas natyrës dhe rrethanave të rastit.
3. BQK zgjedhë instrumentet dhe ushtron kompetencat të cilat më së miri i arrijnë objektivat e përmbylljes në secilin rast të veçantë dhe duhet të kërkojë të minimizoj koston e përmbylljes dhe të shmangë rrënimin e vlerës, përveç nëse ndryshe është e nevojshme për arritjen e objektivave të përmbylljes.
4. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, referencat në BQK në Kapitull III të këtij ligji interpretohen për BQK-në në cilësi të autoritetit të përmbylljes.

Neni 101

Rregullat e përgjithshme që zbatohen gjatë përmbylljes

1. BQK kur aplikon instrumentet e përmbylljes dhe kur ushtron kompetencat e përmbylljes, merr masat e duhura për të siguruar se veprimi i përmbylljes merret në përputhje me rregullat si në vijim:
 - 1.1. aksionarët e bankës në procesin e përmbylljes janë të parët që i bartin humbjet;
 - 1.2. kreditorët e bankës në procesin e përmbylljes i bartin humbjet pas aksionarëve në përputhje me rendin e prioritetit të kërkesave të tyre sipas procedurave të rregullta të falimentimit përveç nëse ndryshe rregullohet shprehimisht me këtë ligj;
 - 1.3. bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë i bankës në procesin e përmbylljes zëvendësohen, përveç në ato raste kur mbajtja e Bordit të drejtorëve dhe Menaxhmentit të lartë, plotësisht apo pjesërisht, konsiderohen të nevojshëm për arritjen e objektivave të përmbylljes;
 - 1.4. bordi i drejtorëve dhe Menaxhmenti i lartë i bankës në procesin e përmbylljes duhet të ofrojnë të gjithë asistencën e nevojshme për arritjen e objektivave të përmbylljes;
 - 1.5. personat fizik dhe juridik kanë përgjegjësi juridike civile dhe penale për dështimin e bankës;
 - 1.6. përveç nëse ndryshe parashihet në këtë ligj, kreditorët e klasit të njëjtë trajtohen në mënyrë të barabartë;
 - 1.7. depozitat e siguruara mbrohen në mënyrë të plotë, dhe
 - 1.8. veprimet e përmbylljes ndërmerren në përputhje me masat e sigurisë të dhëna në këtë ligj.

2. Ligji përkatës për ndihmë shtetërore respektohet nga BQK-ja kur i aplikon instrumentet e përmbylljes dhe kur i ushtron kompetencat e përmbylljes.

Neni 102 **Vlerësimi**

1. Para marrjes së ndonjë veprimi për përmbyllje, apo ushtrimit të kompetencës së zvogëlimit të vlerës apo konvertimit, BQK-ja siguron që një vlerësim i drejtë, i matur dhe real i asetëve dhe detyrimeve të bankës të kryhet nga një person i pavarur nga BQK-ja, autoriteti publik dhe nga vetë banka.

2. Shpenzimet e tarifave të ekspertëve, si dhe shpenzimet tjera të mundshme në lidhje me procesin duhet të barten nga BQK-ja. Në këtë aspekt, BQK mund të vendos tarifa të veçanta të përmbylljes ndaj bankave në mënyrë që të sigurohet që ka kapacitet të mjaftueshëm buxhetor.

3. Kur një vlerësim i pavarur, sipas paragrafit 1. të këtij neni, nuk është i mundur si pasojë e urgjencës së rastit, zhvillohet një vlerësim i përkohshëm i asetëve dhe detyrimeve të bankës nga BQK-ja, në përputhje me kushtet e dhëna në Rregullore, të cilën e nxjerrë BQK. Vlerësimi i përkohshëm përfshin një parandalim për humbjet shtesë, me arsyetimin e duhur. Vlerësimi është i përkohshëm përderisa personi i pavarur të kryejë, sa më parë të jetë e zbatueshme, një vlerësim përfundimtar plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë nen dhe në rregulloren përkatëse të BQK-së. Megjithatë, BQK mund t'i ndërmarrë veprimet përkatëse të përmbylljes në bazë të vlerësimit të përkohshëm.

4. Objektivi dhe qëllimet e vlerësimit janë të vlerësojnë, nëse vlera e asetëve dhe detyrimeve të bankës i përmbushin kushtet për përmbyllje apo për zvogëlimin e vlerës apo konvertimit të instrumenteve të kapitalit të përcaktuara në nenin 112 të këtij ligji , dhe të informojë për vendimet relevante të BQK-së.

5. Vlerësimi bazohet në supozime të matura, duke përfshirë sa i përket normave të dështimit dhe ashpërsinë e humbjeve. Vlerësimi nuk e merr në konsideratë asnjë provizion të mundshëm të ardhshëm të mbështetjes së jashtëzakonshme publike financiare apo ndonjë ndihmë të likuiditetit nga BQK-ja.

6. Një vlerësim i kryer nga një vlerësues i pavarur i cili nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë nen dhe në Rregulloren e BQK-së, konsiderohet se është i përkohshëm përderisa një person i pavarur të ketë kryer një vlerësim që është plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë nen dhe në Rregulloren e BQK-së. Vlerësimi i tillë përfundimtar kryhet sa më shpejtë të jetë e zbatueshme.

7. Vetë vlerësimi nuk i nënshtrohet një të drejte të veçantë ankimi, por mund të jetë subjekt i ankesës së bashku me vendimin në përputhje me nenin 145 të këtij ligji.

8. Vlerësimi i pavarur e merr parasysh faktin se, nëse aplikohet ndonjë instrument i përmbylljes, BQK-ja dhe Fondi Kombëtar i përmbylljes mund t'i mbulojnë shpenzimet e arsyeshme që janë shkaktuar nga banka nën procesin e përmbylljes, duke përfshirë tarifat dhe kostot e shkaktuara në lidhje me vlerësimin e pavarur.

9. BQK-ja nxjerrë një rregullore e cila vendos kushtet përkatëse dhe metodat e vlerësimit.

Neni 103

Zbatimi i procedurave të rregullta të likuidimit

Procedura e rregullte likuidimit nuk do të fillojnë së zbatuari në një bankë, përveç nëse BQK-ja vendosë të mos zbatojë ndonjë nga masat e parashikuara nga ky Kapitull pas zbatimit të masave përkatëse.

Neni 104

Plani i përmbylljes

1. BQK-ja harton një plan të përmbylljes për secilën bankë, e cila ofron veprimet e përmbylljes që BQK-ja mund t'i ndërmarrë aty ku banka i plotëson kushtet për përmbyllje.

2. Plani i përmbylljes nuk merr parasysh ndonjë mbështetje të jashtëzakonshme publike financiare, përveç përdorimit të Fondit Kombëtar të Përmbylljes i themeluar në përputhje me nenin 124 të këtij ligji, dhe përdorimit të ndonjë ndihme emergjente për likuiditet apo ndonjë ndihmë likuiditeti sipas kolateralizimit jo standard, kushteve të maturimit dhe normës së interesit nga BQK-ja.

3. Plani i përmbylljes rishikohet dhe aty ku mundet, përditësohet, të paktën një herë në vit, si dhe rishikohet pas çdo ndryshimi material në strukturën ligjore apo organizative të bankës, në veprimtaritë afariste apo të pozitës së saj financiare, të cilat mund të ketë efekt material në efektivitetin e planit ose përndryshe kërkon rishikimin e planit të përmbylljes.

4. BQK-ja ka të drejtë t'u kërkojë bankave të bashkëpunojnë sa më shumë në hartimin e planit të përmbylljes, dhe t'u ofrojë atyre të gjithë informacionet e nevojshme për të hartuar dhe zbatuar planin e përmbylljes.

5. BQK harton plane grupore për përmbyllje në nivelin e grupit bankar.

Neni 105

Vlerësimi i planit të përmbylljes

1. Në të njëjtën kohë, si dhe për qëllimet e hartimit dhe përditësimit të planit të përmbylljes, BQK-ja vlerëson shkallën deri në të cilën një bankë mund të aplikohet përmbylljes pa marrë ndonjë mbështetje të jashtëzakonshme publike financiare përveç përdorimit të Fondit Kombëtar të përmbylljes, të themeluar në përputhje me nenin 124 të këtij ligji, ndonjë ndihmë emergjente të likuiditetit apo ndonjë ndihmë likuiditeti sipas kolateralizimit jo standard, kushteve të maturimit dhe normës së interesit nga BQK-ja.

2. Banka konsiderohet se mund të përmbyllet nëse është e realizueshme dhe e besueshme për BQK-në ashtu që banka të likuidohet nën procedurat e rregullta të likuidimit, apo të zbatojë procesin e përmbylljes duke aplikuar instrumentet e ndryshme të përmbylljes ndaj bankës, duke shmangur në masën maksimale të mundshme çdo efekt negativ të konsiderueshëm në sistemin financiar, duke përfshirë rrethanat e një jostabiliteti më të gjerë

financiar apo ngjarjet në të gjithë sistemin dhe me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së funksioneve kritike të bankës.

3. Nëse BQK-ja konstaton se ekzistojnë pengesa thelbësore për zbatimin procedurës së përmbylljes në bankë, BQK-ja e njofton me shkrim bankën për një konstatim të tillë. Banka i propozon BQK-së masat e mundshme për të adresuar apo për të mënjeluar pengesat brenda katër (4) muajve nga data e pranimit të njoftimit. Pavarësisht kësaj, BQK-ja harton një plan të përmbylljes të përkohshëm për bankën sipas rrethanave ekzistuese të saj, pa paragjykuar përditësimin e mëvonshëm të këtij plani sipas masave të propozuara nga banka.

4. BQK-ja i vlerëson masat e propozuara nga banka. Nëse BQK konsideron se masat e propozuara nga banka nuk i zvogëlojnë në mënyrë efektive apo nuk i mënjanojnë pengesat, i kërkon bankës të marrë masa alternative që mund të arrijnë këtë objektiv dhe t'ua njoftojë me shkrim këto masa bankës, e cila do të propozojë një plan për t'i përmbushur ato brenda një (1) muaji. Masat e tilla alternative mund të jenë si në vijim:

4.1. të kërkojë nga banka që të rishikojë çdo marrëveshje financimi brenda grupit apo të rishikojë mungesën e një financimi të tillë, apo të hartojë marrëveshjet për shërbim, për të mbuluar ofrimin e funksioneve kritike;

4.2. të kërkojë nga banka t'i kufizojë ekspozimet maksimale në nivel individual dhe të përgjithshëm;

4.3. të imponojë kërkesat shtesë për informim të veçantë ose të rregullt që janë relevante për qëllimet e përmbylljes;

4.4. t'i kërkojë bankës shitjen e aseteve specifike;

4.5. t'i kërkojë bankës të kufizojë apo të ndërpresë veprimtaritë specifike ekzistuese apo të propozuara;

4.6. të kufizojë apo parandalojë zhvillimin e linjave afariste të reja apo ekzistuese apo shitjen e produkteve të reja apo ekzistuese;

4.7. të kërkojë ndryshime në strukturat ligjore ose operationale të bankës apo ndonjë subjekti të varur në grupin e tij bankar, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nën kontrollin e tij, në mënyrë që të reduktojë ndërlikueshmërinë dhe të sigurojë që funksionet kritike të mund ndahen ligjërisht dhe funksionalisht nga funksionet tjera përmes aplikimit të instrumenteve të përmbylljes.

5. Vendimet e BQK-së sipas këtij neni, arsyetohen mjaftueshëm, duke treguar se si vlerësimi dhe masat alternative janë proporcionale. Këto vendime i nënshtrohen një të drejte për ankesë pa paragjykuar faktin se parashtrimi i ankesës nuk sjell pezullimin automatik të çfarëdo vendimi në përputhje me nenin 145 të këtij ligji.

Neni 106 **Kushtet për përmbyllje**

1. BQK-ja ndërmerr një veprim të përmbylljes ndaj një banke vetëm nëse konsideron se janë përmbyllur të gjitha kushtet si në vijim:

1.1. përcaktimi se banka është duke dështuar ose ka mundësi të dështojë, sipas paragrafit 2. të këtij neni, është bërë nga BQK-ja, e cila vepron si autoritet mbikëqyrës;

1.2. sipas kohës dhe rrethanave të tjera relevante, nuk ka perspektivë të arsyeshme që çdo masë alternative e sektorit privat, apo veprim mbikëqyrës, përfshirë masat e ndërhyrjes së hershme ose zvogëlimin e vlerës apo konvertimin e instrumenteve kapitale relevante siç përcaktohet në nenin 112 të këtij ligji në lidhje me bankën, do të parandalonte dështimin e bankës brenda një afati të arsyeshëm kohor;

1.3. një veprim i përmbylljes është i nevojshëm në interes të publikut. Një veprim i përmbylljes trajtohet në interesin publik nëse është proporcional dhe i nevojshëm për arritjen e një ose disa objektivave të përmbylljes, ashtu që procedurat e rregullta të falimentimit nuk do t'i plotësonin ato objektiva të përmbylljes në të njëjtën shkallë, dhe duke mos paragjykuar zbatimin e kombinuar të instrumenteve të përmbylljes dhe të likuidimit sipas nenit 105 të këtij ligji.

2. Banka konsiderohet të jetë e dështuar apo ka mundësi të dështojë në njërin apo në më shumë rrethana si në vijim:

2.1. banka shkel, apo ka rrethana objektive për të mbështetur faktin që banka në të ardhmen e afërt, do të shkelë kërkesat për licencim të vazhdueshëm në atë mënyrë që arsyeton revokimin e licencës nga BQK-ja, sepse ndër të tjerash, banka ka pësuar apo ka mundësi të pësojë humbje që do të shterojë të gjithë ose një sasi të konsiderueshme të kapitalit rregullator;

2.2. asetet e bankës janë, apo ka rrethana objektive për të mbështetur faktin se asetet e bankës, në të ardhmen e afërt, do të jenë më të ulëta në raport me detyrimet e saj;

2.3. banka, është apo ka rrethana objektive për të mbështetur përcaktimin se banka, në të ardhmen e afërt, nuk do të jetë në gjendje t'i paguajë borxhet e saj apo detyrimet në rast të maturimit;

2.4. kërkohet mbështetje e jashtëzakonshme financiare publike, përveç kur, në mënyrë që të korrigohet një shqetësim serioz në ekonomi dhe të ruaj stabilitetin financiar, mbështetja e jashtëzakonshme financiare publike vjen si rezultat:

2.4.1. të një garancisë publike për t'i mbështetur instrumentet financiare lehtësuese të likuidimit të dhëna nga BQK-ja;

2.4.2. të një garancisë publike të detyrimeve sapo emetuara, apo

2.4.3. të injektimit të kapitalit rregullator ose blerjes së instrumenteve të kapitalit me çmime dhe kushte që nuk ofrojnë avantazh për bankën, dhe me kusht që rrethanat e referuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2. dhe 2.3. të këtij neni, dhe rrethanat e referuara në paragrafin e nenit 112 të këtij ligji nuk janë të pranishme në kohën e dhënies së mbështetjes publike.

3. Në secilën rast të përmendur në nën-paragrafin 2.4. të këtij neni, garancioni ose masat ekuivalente të referuara zbatohen vetëm për bankat e afta paguese dhe kushtëzohet me miratimin përfundimtar sipas dispozitave të ligjit përkatës të ndihmës shtetërore, aty ku është e aplikueshme. Masat e tilla konsiderohen të natyrës parandaluese dhe të përkohshme, në proporcion për të përmirësuar pasojat e shqetësimit serioz, dhe assesi nuk mund të përdoren për të kompensuar humbjet që banka i ka pësuar ose ka mundësi të pësojë në të ardhmen e afërt.

4. Konstatimi se banka është duke dështuar ose ka mundësi të dështojë duhet të bëhet nga BQK-ja në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës.

5. Bordi i drejtorëve të bankës duhet të njoftojë BQK-në, nëse vlerësojnë që banka është duke dështuar ose ka mundësi të dështojë.

6. Miratimi paraprak i çdo mase të ndërhyrjes së hershme nuk është kusht për marrjen e veprimit të përmbylljes.

7. Vendimi i BQK-së, përfshirë situatën për përmbyllje ose jo në raport me bankën, i përshkruan arsyet relevante për atë vendim dhe për veprimet të cilat BQK synon t'i ndërmer

Neni 107 **Instrumentet e përmbylljes**

1. Nëse BQK-ja vendosë të aplikojë një mjet të përmbylljes ndaj një banke, dhe ku ai veprim i përmbylljes do të rezultojë në humbje të cilat do të barten nga kreditorët ose kërkesat e tyre konvertohen, BQK-ja ushtron kompetencat e zvogëlimit të vlerës dhe konvertimit menjëherë para ose së bashku me aplikimin e instrumentit të përmbylljes.

2. Instrumentet e përmbylljes të referuara në paragrafin 1. të këtij neni janë si në vijim:

2.1. instrumenti i shitjes së veprimtarisë (veprimtarisë tregtare);

2.2. instrumenti i institucionit urë;

2.3. instrumenti i ndarjes së aseteve, dhe

2.4. instrumenti i rikapitalizimit nga brenda.

3. BQK-ja mund të aplikojë instrumentet e përmbylljes në mënyrë individuale ose në kombinim, në çdo kohë, me kusht që të zbatojë instrumentin e ndarjes së aseteve së bashku me një instrument tjetër të përmbylljes.

4. Me qëllim të arritjes së objektivave të përmbylljes, BQK-ja mund të vendosë të zbatojë kornizën rregullative për likuidim, të parashikuar në Kapitullin IV të këtij ligji, në masën që BQK-ja përcakton, në kombinim me ndonjë nga instrumentet e përmbylljes, në çdo kohë gjatë procesit të përmbylljes.

5. Kur përdoren vetëm instrumentet e përmbylljes, të referuara në nën-paragrafin 2.1. dhe 2.2., të këtij neni dhe vetëm për të transferuar një pjesë të asetëve, të drejtave apo detyrimeve të bankës nën procesin e përmbylljes, institucioni i mbetur nga i cili janë transferuar asetet, të drejtat apo detyrimet, mbyllet sipas procedurave të rregullta të falimentimit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

6. Çdo legjislacion i falimentimit që lidhet me pavlefshmërinë apo pazbatueshmërinë e të drejtave ligjore, në dëm të kreditorëve që mund të jetë e zbatueshme për bankat, nuk zbatohet ndaj transferimit të asetëve, të drejtave apo detyrimeve nga një bankë nën procesin e përmbylljes tek një subjekt tjetër, për arsye të zbatimit të një instrumenti të përmbylljes apo ushtrimit të kompetencës së përmbylljes apo përdorimit të një instrumenti qeveritar të stabilizimit financiar.

7. BQK-ja mund të caktojë një menaxher special për të zëvendësuar Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e Lartë të bankës nën procesin e përmbylljes. Nëse administratori zyrtar i bankës është emëruar nën masën e ndërhyrjes së hershme dhe është zyrtar i BQK-së, BQK-ja sipas diskrecionit të saj, vendos që administratori zyrtar të vazhdojë si menaxher special i bankës nën procesin e përmbylljes.

8. Menaxheri special i ka të gjitha kompetencat e aksionarëve, Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të Lartë të bankës, të cilat ushtrohen nën kontrollin e BQK-së. Menaxheri special promovon objektivat e përmbylljes dhe i zbaton veprimet e përmbylljes sipas vendimit të BQK-së. BQK-ja nxjerrë një rregullore duke i përcaktuar kushtet për emërimin e tillë, dhe funksionet dhe përgjegjësitë e menaxherit special.

9. Në një situatë tejet të jashtëzakonshme të një krize sistemike, BQK-ja mund të kërkojë financim nga burime alternative të financimit përmes përdorimit të instrumenteve qeveritare të stabilizimit të përcaktuara në nenin 123 të këtij ligji, kur përmbushen kushtet si në vijim:

9.1. kontributi ndaj absorbimit të humbjeve dhe rikapitalizimit të barabartë me një shumë të përcaktuar me rregullore të BQK-së, si përqindje e gjithsej detyrimeve (përfshirë kapitalin) të bankës nën procesin e përmbylljes, të matura në kohën kur veprimi i përmbylljes është marrë në përputhje me vlerësimin e përcaktuar në nenin 102 të këtij ligji, është bërë nga aksionarët dhe nga zotëruesit e instrumenteve tjera të pronësisë, instrumenteve kapitale dhe detyrimeve të tjera të pranueshme përmes zvogëlimit të vlerës, konvertimit ose në ndonjë mënyrë tjetër;

9.2. kjo kushtëzohet me aprovimin paraprak dhe përfundimtar sipas dispozitave të ligjit përkatës për ndihmë shtetërore, aty ku është e aplikueshme.

10. BQK-ja nxjerrë një rregullore që përcakton kushtet për përdorimin e instrumenteve qeveritare stabilizuese.

11. BQK-ja publikon një kopje të urdhrimit ose instrumentit me të cilin është ndërmarrë veprimi i përmblylljes, ose një njoftim që përmbledhë efektet e veprimit të përmblylljes.

Neni 108

Instrumenti i shitjes së veprimtarisë tregtare

1. BQK-ja mund t'i transferojë blerësit që nuk është institucion urë:

1.1. aksionet apo instrumentet tjera të pronësisë, të emetuara nga banka nën procesin e përmblylljes;

1.2. të gjitha apo disa asete, të drejta apo detyrime të bankës nën procesin e përmblylljes.

2. Transferimet sipas këtij neni bëhen pa pëlqimin e aksionarëve të bankës nën procesin e përmblylljes apo ndonjë pale të tretë, përveç me pëlqim të blerësit, dhe pa respektuar kërkesat procedurale sipas ligjit përkatës të shoqërive tregtare apo letrave me vlerë.

3. BQK-ja i ndërmerr të gjitha hapat e arsyeshëm për transfer me kushte komerciale konform vlerësimit të kryer sipas nenit 102 të këtij ligji.

4. Blerësi duhet të ketë autorizimin e duhur për të zhvilluar veprimtarinë që e përvetëson sipas këtij neni, kur transferimi bëhet në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni BQK-ja siguron që kërkesa për autorizim në lidhje me transferimin të shqyrtohet brenda kohës.

5. BQK-ja nxjerrë një rregullore që përcakton kushtet për zbatimin e instrumentit të shitjes së veprimtarive të biznesit. Kushtet e tilla sigurojnë që marketingu i aseteve, të drejtave, detyrimeve, aksioneve apo instrumenteve të tjera të pronësisë së bankës në procesin e përmblylljes të jetë transparent dhe pa konflikt interesi, dhe nuk bën favorizim apo nuk bën diskriminim ndërmjet blerësve potencialë.

Neni 109

Instrumenti i institucionit urë

1. BQK-ja mund të transferoj tek një institucion kur:

1.1. aksionet apo instrumentet tjera të pronësisë të nxjerra nga një apo më shumë institucione nën procesin e përmblylljes;

1.2. të gjitha apo disa pasuri, të drejtat apo detyrimet të një apo më shumë institucioneve nën procesin e përmblylljes.

2. Transferimi mund të bëhet pa marrë pëlqimin e aksionarëve të bankës nën procesin e përmblylljes apo ndonjë pale të tretë, përveç institucionit urë, dhe pa respektuar kërkesat procedurale sipas ligjit përkatës të shoqërive tregtare apo të letrave me vlerë.

3. Institucioni urë duhet të jetë person juridik që i përmbushë të gjitha kërkesat në vijim:

3.1. është tërësisht apo pjesërisht në pronësi dhe kontrollohet nga një ose më shumë autoritete publike, të cilat mund të përfshirë BQK-në, pavarësisht nga dispozitat e përcaktuara në ligjin përkatës për BQK-në;

3.2. është krijuar për qëllim të marrjes dhe mbajtjes të disa apo të të gjitha aksioneve apo instrumenteve tjera të pronësisë, të emetuara nga një bankë nën procesin e përmbylljes, apo disa apo të të gjitha aseteteve, të drejtave dhe detyrimeve të një apo më shumë bankave nën procesin e përmbylljes, me qëllim që të ruajë qasjen në funksionet kritike dhe në shitjen e bankës.

4. BQK-ja nxjerrë një rregullore e cila i përcakton kushtet për zbatimin e instrumentit të institucionit urë dhe operacionet e institucionit urë.

Neni 110 **Instrumenti i ndarjes së aseteteve**

1. BQK-ja mund t'i transferojë asetet, të drejtat apo detyrimet e një banke nën procesin e përmbylljes apo një institucioni urë tek një apo më shumë subjekte për menaxhimin e aseteteve, pa marrë pëlqimin e aksionarëve të bankës nën procesin e përmbylljes apo ndonjë pale të tretë, përveç institucionit urë dhe pa përmbushur kërkesat procedurale sipas ligjit për shoqëri tregtare apo ligjit për letra me vlerë.

2. Subjekti për menaxhimin e aseteteve është personi juridik që i përmbush të gjitha kërkesat në vijim:

2.1. është tërësisht apo pjesërisht në pronësi dhe kontrollohet nga një ose më shumë autoritete publike, të cilat mund të përfshirë BQK-në, dhe kontrollohet nga BQK-ja, pavarësisht nga dispozitat e përcaktuara në ligjin përkatës BQK-në;

2.2. është krijuar për qëllim të marrjes të disa apo të të gjitha aseteteve, të drejtave dhe detyrimeve të një apo më shumë institucioneve nën procesin e përmbylljes apo një institucioni urë.

3. Subjekti për menaxhimin e aseteteve i menaxhon asetet e transferuara tek ai me qëllim të maksimizimit të vlerës përmes shitjes eventuale apo zvogëlimit gradual të vlerës.

4. Aksionarët apo kreditorët e bankës nën procesin e përmbylljes dhe palët tjera të treta, asetet, të drejtat apo detyrimet e të cilëve nuk transferohen tek subjekti për menaxhimin e aseteteve nuk kanë të drejta mbi apo në lidhje me asetet, të drejtat apo detyrimet e transferuara në subjektin për menaxhimin e aseteteve apo në Bordin e Drejtorëve ose në Menaxhmentin e Lartë.

5. BQK-ja nxjerrë një rregullore e cila i përcakton kushtet për zbatimin e këtij instrumenti për përmbyllje.

Neni 111

Instrumenti i rikapitalizimit nga brenda

1. Instrumenti i rikapitalizimit nga brenda është mekanizmi për ushtrimin nga BQK-ja të kompetencës për të zvogëluar vlerën dhe për të konvertuar në lidhje me detyrimet e një banke nën procesin e përmbylljes. Këto kompetenca janë të ndara dhe të pavarura nga ato të përcaktuara në nenin 112 të këtij ligji.

2. BQK-ja mund të zbatojë instrumentin e rikapitalizimit nga brenda për t'i përmbushur objektivat e përmbylljes për secilin qëllim si në vijim:

2.1. Për të rikapitalizuar bankën nën procesin e përmbylljes deri në masën e mjaftueshme për të kthyer aftësinë e saj në përmbushjen e kushteve për licencim dhe për të vazhduar kryerjen e veprimtarive për të cilat është e licencuar dhe për të mbajtur besimin e mjaftueshëm të tregut në bankë, por vetëm nëse ka një perspektivë të arsyeshme që zbatimi i këtij instrumenti, së bashku me masat tjera relevante, e kthejnë bankën në qëndrueshmërinë financiare dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

2.2. Për të konvertuar në kapital apo për të zvogëluar shumën e kryesore të kërkesave apo instrumenteve të borxhit që transferohen:

2.2.1. tek një institucion urë me qëllim të ofrimit të kapitalit për atë institucion urë; ose

2.2.2. sipas instrumentit të shitjes së afarizmit (veprimtarisë) ose instrumentit të ndarjes së asetëve.

3. BQK-ja nuk ushtron kompetencat e zvogëlimit së vlerës apo të konvertimit në lidhje me detyrimet si në vijim:

3.1. depozitat e siguruara;

3.2. detyrimet e garantuara;

3.3. çdo detyrim që krijohet me qëllim të mbajtjes së asetëve të klientit apo parave të klientit nga banka;

3.4. çdo detyrim që krijohet nga një marrëdhënie mirëbesimi në mes të bankës si e besuar dhe një personi tjetër si përfitues me kusht që përfituesi i tillë është i mbrojtur sipas ligjit të falimentimit apo ligjit nga marrëdhënia civilo-juridike në fuqi;

3.5. detyrimet ndaj bankave tjera, duke përjashtuar bankat që janë pjesë e të njëjtit grup, me një maturim fillestar prej më pak se shtatë (7) ditësh;

3.6. detyrimi ndaj këtyre si në vijim:

3.6.1. një punonjësi, në lidhje me pagën e papaguar, përfitimet pensionale apo pagesave tjera me shuma fikse, me përjashtim të pjesës të ndryshueshme të pagesës që nuk derivon nga një marrëveshje kolektive;

3.6.2. një kreditori komercial që rrjedh nga ofrimi i mallrave apo shërbimeve për bankën që janë kritike për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së saj, duke përfshirë shërbimet e TI-së, shërbimet publike dhe dhënien me qira, servisimin dhe mirëmbajtjen e objekteve;

3.6.3. autoriteteve tatimore dhe të sigurimit social, me kusht që këto detyrime janë me prioritet të pagesës sipas ligjit në fuqi;

3.6.4. fondit të Sigurimit të Depozitave që rrjedh nga kontributet për t'u paguar.

4. Ky instrument mund të përfshijë emërimin e një personi apo personave nga BQK-ja në përputhje me nenin 121 të këtij ligji me qëllim të hartimit dhe zbatimit të një plani për riorganizimin e biznesit sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren që BQK-ja mund ta nxjerrë për këtë qëllim.

5. BQK-ja nxjerrë një rregullore që përcakton detyrimet e përfshira në fushëveprimin e këtij instrumenti dhe kushtet për zbatimin e tij.

Neni 112

Zvogëlimi i vlerës dhe konvertimi i instrumenteve kapitale

1. BQK-ja mund të vendosë detyrimisht të zvogëlojë vlerën ose të konvertojë instrumentet kapitale në aksione apo në instrumente tjera të pronësisë së institucioneve në mënyrë të pavarur nga veprimi i përmbylljes apo në kombinim me një veprim të përmbylljes, ku kushtet për përmbyllje të përcaktuara në nenin 106 të këtij ligji janë plotësuar, me kusht që të zbatohen një ose më shumë nga rrethanat e mëposhtme:

1.1. kushtet për përmbyllje janë plotësuar para se të merret ndonjë veprim për përmbyllje;

1.2. nëse nuk ushtrohet kompetenca në lidhje me instrumentet përkatëse të kapitalit, banka nuk do të jetë më e qëndrueshme;

1.3. në rastin e instrumenteve përkatëse të kapitalit të emetuara nga një filialë dhe ku këto instrumente të kapitalit njihen për qëllim të plotësimit të kërkesave të kapitalit rregullator si në bazë individuale ashtu edhe në bazë të konsoliduar, BQK-ja përcakton që nëse nuk ushtrohen kompetencat e zvogëlimit të vlerës apo konvertimit në lidhje me ato instrumente, grupi bankar nuk do të jetë më i qëndrueshëm;

1.4. në rastin e instrumenteve përkatëse të kapitalit të emetuara në nivel të subjektit amë të grupit bankar dhe ku këto instrumente të kapitalit njihen për qëllime të përmbushjes së kërkesave të kapitalit rregullator në baza individuale në nivelin e subjektit amë apo në bazë të konsoliduar dhe ku BQK-ja përcakton që nëse nuk

ushtrohen kompetencat e zvogëlimit të vlerës apo konvertimit në lidhje me ato instrumente, grupi bankar nuk do të jetë më i qëndrueshëm;

1.5. nga banka kërkohet mbështetja e jashtëzakonshme financiare publike përveç në rrethanat e përcaktuara në nën-nën-paragrafin 2.4.3., të nenit 106 të këtij ligji.

2. Banka konsiderohet se nuk është më e qëndrueshme vetëm nëse plotësohen këto dy (2) kushte:

2.1. banka është duke dështuar apo ka mundësi të dështojë, siç është përcaktuar në paragrafin 2. të nenit 106 të këtij ligji;

2.2. marrë në konsideratë kohën dhe rrethanat e tjera relevante, nuk ka asnjë perspektivë të arsyeshme që ndonjë veprim, duke përfshirë masat alternative të sektorit privat apo veprimit mbikëqyrës, masat e ndërhyrjes së hershme, në mënyrë të pavarur ose në kombinim me një veprim të përmbylljes, do të parandalonin dështimin e bankës brenda një afati të arsyeshëm kohor, përveç nëse bëhet zvogëlimi i vlerës apo konvertimit të instrumenteve kapitale.

3. BQK-ja nxjerrë një rregullore e cila i përcakton kushtet tjera për zvogëlimin e vlerës së instrumenteve të kapitalit.

Neni 113

Trajtimi i aksionarëve gjatë rikapitalizimit nga brenda dhe zvogëlimi i vlerës apo konvertimi i instrumenteve të kapitalit

1. Kur aplikohet instrumenti i rikapitalizimit nga brenda apo zvogëlimi i vlerës apo konvertimi i instrumenteve të kapitalit në nenin 112 të këtij ligji, BQK-ja i ndërmerr një apo të dyja veprimet në vijim për aksionarët dhe zotëruesit e instrumenteve tjera të pronësisë:

1.1. anulon aksionet ekzistuese apo instrumentet tjera të pronësisë apo i transferon ato tek kreditorët e rikapitalizuar;

1.2. nëse, në përputhje me vlerësimin e bërë sipas nenit 102 të këtij ligji, banka nën procesin e përmbylljes ka vlerë pozitive neto, i zvogëlon aksionarët ekzistues dhe zotëruesit e instrumenteve tjera të pronësisë si rezultat i konvertimit në aksione apo instrumente tjera të pronësisë si:

1.2.1. instrumentet përkatëse të kapitalit të emetuara nga banka në pajtim me kompetencën e referuar në nenin 112 të këtij ligji; apo

1.2.2. detyrimet e pranueshme të emetuara nga banka nën procesin e përmbylljes në pajtim me kompetencën e referuar në nën-paragrafin 1.6. të nenit 121 të këtij ligji.

2. Sa i përket nën-paragrafit 1.2. të këtij neni, konvertimi kryhet me një normë konvertimi që ndjeshëm i zvogëlon zotërimet ekzistuese të aksioneve apo instrumenteve tjera të pronësisë.

Neni 114

Ndikimi i rikapitalizimit nga brenda dhe zvogëlimi i vlerës apo konvertimi i instrumenteve të kapitalit

1. Nëse BQK i ushtron kompetencat e referuara në nenin 112 dhe në nën-paragrafin 1.6. të nenit 121, të këtij ligji zvogëlimi i shumës kryesore apo të papaguar që ka afatin për pagesë, konvertimi ose anulimi hyjnë në fuqi dhe janë menjëherë të detyrueshme për bankën nën procesin e përmbylljes dhe për kreditorët e prekur dhe aksionarët e prekur.

2. BQK-ja ka të drejtë t'i jep efekt ushtrimit të kompetencës referuar në nenin 112 dhe në nën- paragrafin 1.6. të nenit 121 të këtij ligji, duke përfshirë ndryshimin e të gjithë regjistrave përkatës, heqjen nga lista apo heqjen nga tregtimi i aksioneve apo instrumenteve tjera të pronësisë apo instrumenteve të borxhit, regjistrimin apo pranimin në tregtimin e aksioneve të reja apo instrumenteve tjera të pronësisë dhe regjistrimin apo ri pranimin e çdo instrumenti të borxhit të cilit i është zvogëluar vlera.

3. Nëse BQK-ja e redukton në zero shumën kryesore, apo shumën e papaguar, e pagueshme lidhur me detyrimin dhe çdo obligim apo kërkesën që rrjedh në lidhje me to që nuk janë mbledhur në kohën e ushtrimit të kompetencës, detyrimi i tillë trajtohet si i liruar për të gjitha qëllimet dhe nuk mund të shërbej si provë materiale në asnjë procedurë të mëvonshme në lidhje me bankën nën procesin e përmbylljes apo ndonjë subjekti pasues në çdo mbyllje pasuese.

4. Nëse BQK-ja e zvogëlon pjesërisht por jo plotësisht, shumën kryesore apo shumën e papaguar, të pagueshme në lidhje me një detyrim, detyrimi i tillë lirohet deri në masën e shumës së zvogëluar, ndërsa instrumenti përkatës që ka krijuar detyrimin fillestar vazhdon të aplikohet në lidhje me shumën kryesore të mbetur, apo për shumën e papaguar të mbetur, të pagueshme në lidhje me, detyrimin, në varësi të ndonjë modifikimi të miratuar nga BQK-ja.

Neni 115

Implikimet e ndërhyrjes së hershme dhe masat e përmbylljes në raporte kontraktuale

1. Masa për parandalimin e krizës apo masa për menaxhimin e krizës të marra ndaj bankës në përputhje me këtë kapitull, nuk do të nënkuptoj vetvetiu në raportet kontraktuale të bankës, si një ngjarje e procedurës përmbarimore apo të kualifikohet si procedurë e falimentimit, me kusht që obligimet thelbësore sipas kontratës vazhdojnë të zbatohen, duke përfshirë përmbushjen e pagesës dhe detyrimeve të tjerat dhe kolaterali vazhdon të jetë i siguruar.

2. Me kusht që detyrimet thelbësore sipas kontratës, duke përfshirë përmbushjen e pagesës dhe detyrimeve dhe, vazhdojnë të zbatohen, dhe kolaterali vazhdon të jetë i siguruar, masa për parandalimin e krizës apo masa e menaxhimit të krizës, duke përfshirë pasojë në çdo ngjarjeje lidhur drejtpërdrejtë me zbatimin e masës së tillë, nuk e bën vetvetiu të mundur për asnjërin palë kontraktuese që të ushtroj të drejtën e shkëputjes, pezullimit, modifikimit, netimin apo të drejtat e kompensimit, ose për të marrë posedimin, të ushtrojë kontrollin apo të përmbaroj ndonjë kolateral mbi çdo pronë të bankës, apo të ndikojë në çdo të drejtë

kontraktuale të bankës. Kjo gjithashtu është e zbatueshme për çdo subjekt të varur në grupin bankar të bankës në lidhje me kontratën që përfshinë dispozitat e dështimit të ndërsjellë.

3. Ky nen nuk e ndikon të drejtën e një personi për të ndërmarrë një veprim sipas paragrafit 2. të këtij neni, kur kjo e drejtë bazohet në një ngjarje tjetër, dhe jo në masën për parandalimin e krizës, masën për menaxhimin e krizës apo pasojë në çdo ngjarjeje të lidhur drejtpërdrejtë me zbatimin e masës së tillë.

4. Pezullimi apo kufizimi i pajtuar sipas nenit 121 të këtij ligji nuk përbën mos përmbushje të obligimit kontraktual për qëllimet e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni.

Neni 116

Trajtimi i aksionarëve dhe kreditorëve në rastin e transfereve të pjeshme dhe zbatimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda

1. Kur aplikohen një apo më shumë instrumente të përmbylljes:

1.1. përveç rasteve kur zbatohet nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, nëse BQK-ja i transferon vetëm pjesët e të drejtave, aseteve dhe detyrimeve të bankës nën procesin e përmbylljes, aksionarët dhe ata kreditorë, kërkesat e të cilëve nuk janë transferuar, i pranojnë duke i përmbushur kërkesat e tyre së paku aq sa do të pranonin nëse një bankë nën procesin e përmbylljes të ishte mbyllur sipas procedurave të rregullta të likuidimit në kohën kur është marrë vendimi i BQK-së rreth përmbushjes së kushteve të përmbylljes;

1.2. aty ku BQK-ja zbaton instrumentin e rikapitalizimit nga brenda, aksionarët dhe kreditorët kërkesat e të cilëve janë zvogëluar në vlerë apo janë konvertuar në kapital nuk shkaktojnë humbje më të mëdha se ato që do të ishin shkaktuar nëse banka në procesin e përmbylljes të ishte mbyllur sipas procedurave të rregullta të falimentimit menjëherë në kohën kur është marrë vendimi i BQK-së për përmbushjen e kushteve të përmbylljes.

Neni 117

Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse përbëhen nga aranzhimi dhe palët përkatëse në transferet e pjeshme, bartja e titullit në një marrëveshje të kolateralit financiar dhe marrëveshjet e kompensimit dhe netimit, detyrimet e siguruara sipas një marrëveshje sigurie, dhe marrëveshjet e financës së strukturuar dhe obligacionet e mbuluara.

2. BQK rregullon masat e mbrojtjes dhe rregullimet e zbatimit me rregullore.

Neni 118

Vlerësimi i diferencës në trajtim

1. Për qëllime të vlerësimit nëse aksionarët dhe kreditorët do të kishin marrë trajtim më të favorshëm nëse banka nën procesin e përmbylljes do të kishte hyrë në procedura të rregullta të falimentimit, përfshirë, por pa u kufizuar për qëllimin e nenit 116 të këtij ligji, vlerësimi kryhet nga një person i pavarur, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 102 të këtij ligji, sa më parë të jetë e mundur, pas kryerjes së veprimit apo veprimeve të përmbylljes. Ky vlerësim është i ndryshëm nga vlerësimi i kryer sipas nenit 102 të këtij ligji.

2. Vlerësimi në paragrafin 1. të këtij neni përcakton:

2.1. trajtimin të cilin aksionarët dhe kreditorët, apo Fondi i Sigurimit të Depozitave i Kosovës do të kishin pranuar nëse banka nën procesin e përmbylljes të kishte hyrë në procedurat e rregullta të falimentimit në kohën kur BQK-ja ndërmori veprimin e përmbylljes (duke përfshirë përcaktimin se kushtet për procesin e përmbylljes janë plotësuar apo jo);

2.2. trajtimi aktual të cilin aksionarët dhe kreditorët e kanë pranuar nën procesin e përmbylljes të bankës; dhe

2.3. nëse ka ndonjë ndryshim ndërmjet trajtimit të referuar në nën-paragrafin 2.1. dhe trajtimit të referuar në nën-paragrafin 2.2. të këtij neni

3. Nëse vlerësimi përcakton se çdo aksionar ose kreditor apo Fondi i Sigurimit të Depozitave i Kosovës ka pësuar humbje më të mëdha se sa që do të kishte pësuar në procedurat e rregullta të falimentimit, ata kanë të drejtë të realizojnë diferencën në pagesë nga Fondi Kombëtar i Përmbylljes i cili themelohet sipas nenit 124 të këtij ligji.

Neni 119

Kërkesat minimale për kapitalin rregullator dhe detyrimet e pranueshme

1. Bankat në çdo kohë, duhet të përmbushin kërkesën minimale për kapitalin rregullator dhe detyrimet e pranueshme, të përcaktuara nga BQK-ja mbi bazën e nevojës për të siguruar që një bankë mund iniciohet procesi i përmbylljes përmes zbatimit të instrumenteve për përmbyllje (duke përfshirë instrumentin e rikapitalizimit nga brenda) në një mënyrë e cila i përmbushë objektivat e përmbylljes.

2. Kërkesa minimale llogaritet si përpjesëtim i kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranueshme ndaj gjithsej detyrimeve dhe kapitalit rregullator të bankës.

3. BQK-ja verifikon që bankat e përmbushin kriterin minimal për kapitalin rregullator dhe detyrimet e pranueshme.

4. BQK-ja nxjerrë një rregullore që i përcakton kushtet e këtij obligimi dhe kompetencat përkatëse të BQK-së lidhur me të.

Neni 120

Përdorimi i Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës në kontekst të përmbylljes

1. Nëse BQK-ja ndërmerr ndonjë veprim të përmbylljes, me kusht që veprimet e tilla sigurojnë që depozitorët vazhdojnë të kenë qasje në depozitat e tyre, Fondi i Sigurimit të Depozitave i Kosovës është përgjegjës:

1.1. kur aplikohet instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, dhe nëse depozitat e siguruara janë përfshirë brenda fushëveprimit të rikapitalizimit nga brenda dhe janë zvogëluar në vlerë deri në të njëjtën masë si kreditorët me të njëjtin nivel të prioritetit sipas procedurës të rregullt të falimentimit, shumë kjo me të cilën depozitat e siguruara do të ishin zvogëluar në vlerë për të absorbuar humbjet në bankë. Megjithatë, Fondi i Sigurimit të Depozitave i Kosovës nuk i bart kostot e rikapitalizimit të bankës apo institucionit të urë.

1.2. nëse aplikohen instrumentet e përmbylljes ndryshe nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, dhe nëse depozitorët e siguruar kanë pësuar humbje, shumën e humbjeve që depozitorët e siguruar do të kishin pësuar në proporcion me humbjet e pësuar nga kreditorët me të njëjtin nivel të prioritetit sipas procedurave të rregullta të likuidimit.

2. Detyrimi i Fondit të Sigurimit të Depozitave i Kosovës nuk duhet të jetë më i madh se shumën e humbjeve që do të duhej ta bartnin sikur banka të ishte mbyllur sipas procedurave të rregullta të falimentimit.

3. Nëse përcaktohet me anë të vlerësimit sipas nenit 118 të këtij ligji, që kontributi i Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës në procesin e përmbylljes, ishte më i madh se humbjet neto që do t'i kishte pësuar sikur banka do të mbyllej sipas procedurave të rregullta të falimentimit, Fondi i Sigurimit të Depozitave i Kosovës ka të drejtën të realizojnë diferencën në pagesë nga Fondi Kombëtar i Përmbylljes, i themeluar sipas nenit 124 të këtij ligji.

4. Kur depozitat e një banke nën procesin e përmbylljes transferohen tek një subjekt tjetër përmes instrumentit të shitjes së veprimtarisë apo instrumentit të institucionit të urë, depozitorët nuk kanë asnjë kërkesë kundrejt Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës në lidhje me ndonjë pjesë të depozitave të tyre në bankën nën procesin e përmbylljes që nuk janë transferuar, me kusht që shumën e fondeve të transferuara të jetë e barabartë me ose më shumë se niveli i përgjithshëm i mbulesës, i përcaktuar në ligjin përkatës për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

NËNKAPITULLI III

KOMPETENCAT E PËRMBYLLJES DHE MBËSHTETJA FINANCIARE

Neni 121

Kompetencat e përmbylljes

1. BQK-ja i ka kompetencat në vijim për përmbyllje të cilat mund të ushtrohen individualisht apo në çfarëdo kombinimi:

- 1.1. t'i kërkojë çdo personi që të ofrojë çfarëdo informacioni të kërkuar për BQK-në për të vendosur dhe për të përgatitur veprimin e përmbylljes;
- 1.2. të marrë kontrollin e bankës nën procesin e përmbylljes dhe të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e aksionarëve të saj, pronarëve të tjerë, Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të Lartë, duke përfshirë kompetencën për të transferuar aksione ose instrumente të tjera të pronësisë të emetuara nga banka, ose asetet apo detyrimet e saj tek një subjekt tjetër;
- 1.3. heqjen e të drejtave për të blerë aksione të tjera apo instrumente tjera të pronësisë të bankës nën procesin e përmbylljes;
- 1.4. të anulojë ose modifikojë kushtet e kontratës në të cilën banka nën procesin e përmbylljes është palë apo zëvendëson pranuesin si palë;
- 1.5. për të zvogëluar, duke përfshirë zvogëlimin në zero, shumën nominale të aksioneve apo instrumenteve tjera të pronësisë të një banke nën procesin e përmbylljes dhe për të anuluar aksionet e tilla apo instrumentet tjera të pronësisë;
- 1.6. për të zvogëluar, duke përfshirë zvogëlimin në zero, shumën kryesore të, apo shumën e papaguar që ka afatin lidhur me detyrimet e pranueshme, të një bankë nën procesin e përmbylljes; të anulojë instrumentet e borxhit të lëshuara nga ajo (përveç për ato detyrime të siguruara të cilat mund të vendosen nga BQK-ja në rregulloren përkatëse, dhe të konvertojë detyrimet e saj të pranueshme në aksione të zakonshme ose instrumente tjera të pronësisë të një banke të tillë apo të një institucioni urë;
- 1.7. për të ndryshuar maturitetin e instrumenteve të borxhit dhe detyrimeve tjera të pranueshme të emetuara nga një bankë nën procesin e përmbylljes apo të ndryshojë shumën e interesit të pagueshëm në të, apo datën në të cilën interesi bëhet i pagueshëm, përveç atyre detyrimeve të garantuara që mund të vendosen nga BQK-ja në rregulloren përkatëse;
- 1.8. t'i kërkojë një banke nën procesin e përmbylljes të emetojë aksione të reja apo instrumente të tjera të pronësinë apo instrumente tjera të kapitalit, duke përfshirë aksionet preferenciale dhe instrumentet e konvertueshme kontingjente (i mundshëm);
- 1.9. për t'i përfunduar dhe për t'i shkëputur kontratat financiare apo kontratat derivative, duke përfshirë kontratat financiare të pranueshme;
- 1.10. për të shkarkuar apo zëvendësuar Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhimin e Lartë të një banke nën procesin e përmbylljes;
- 1.11. për të siguruar aranzhimet e vazhdimësisë, të nevojshme për të siguruar që veprimi i përmbylljes është efektiv dhe, aty ku është relevante, biznesi i transferuar mund të operohet nga pranuesi;

1.12. t'i kërkojë një banke nën procesin e përmbylljes apo ndonjë subjekti të varur të grupit të saj bankar, ofrimin e të gjitha shërbimeve apo lehtësirave, të nevojshme për t'i mundësuar një pranuesi të veprorë në mënyrë efektive me veprimtarinë që i është transferuar atij.

2. BQK-ja autorizohet të pezullojë çdo pagesë apo obligim të dorëzimit në pajtim me çdo kontratë në të cilën një bankë nën procesin e përmbylljes është palë, nga publikimi i njoftimit të pezullimit në përputhje me nenin 107 të këtij ligji deri në mesnatë në fund të ditës së punës pas publikimit të njoftimit.

3. Kur një pagesë apo obligim për dorëzim do të kishte arrit afatin e pagesës gjatë periudhës së pezullimit, pagesa apo obligimi për dorëzim paguhet menjëherë pas skadimit të periudhës së pezullimit.

4. Në rast të pezullimit të pagesës apo përbushjes së detyrimit, obligimet e ngjashme për palën tjetër kontraktuese përkatëse pezullohet gjithashtu për të njëjtën periudhë kohore.

5. Pezullimet nuk zbatohen për depozitat dhe përbushjen e detyrimeve ndaj Kundër palëve Qendrore dhe BQK-së.

6. BQK-ja gjatë procesit të përmbylljes mund:

6.1. të kufizojë kreditorët e siguruar të bankës nga zbatimi i interesave të sigurisë në lidhje me çdo pasuri të asaj banke nën procesin e përmbylljes nga publikimi i njoftimit të pezullimit në përputhje me nenin 107 të këtij ligji deri në mesnatë në fund të ditës së punës pas atij publikimi të njoftimit. Kjo e drejtë nuk ushtrohet në lidhje me interesat e sigurisë të kundërpalëve Qendrore dhe BQK-së ndaj asetëve të mbajtura peng apo të ofruara me anë të margjinës apo kolateralit nga banka;

6.2. pezullojë të drejtat për të shkëputur, përshpejtuar, përfunduar, kompensuar apo netuar detyrimet, apo ndonjë të drejtë tjetër të ngjashme për të pezulluar, modifikuar ose shuar një obligim kontraktual, të çdo pale në kontratë me bankën nën procesin e përmbylljes nga publikimi i njoftimit të pezullimit në përputhje me nenin 107 të këtij ligji deri në mesnatë në fund të ditës së punës pas atij publikimi, me kusht që detyrimet e pagesës dhe detyrimeve të tjera vazhdojnë të zbatohen dhe kolaterali vazhdon të jetë i siguruar. Ky pezullim nuk aplikohet ndaj kundërpalëve qendrore dhe BQK-së.

7. Kur aplikohen instrumentet e përmbylljes dhe para se të ushtrohen ose gjatë ushtrimit të kompetencave të përmbylljes, BQK-ja nuk obligohet të marrë miratimin apo pëlqimin nga ndonjë person qoftë publik a privat, duke përfshirë aksionarët apo kreditorët e bankës nën procesin e përmbylljes, dhe nuk i nënshtrohet kërkesave procedurale lidhur me njoftimin apo publikimin e njoftimeve.

8. Nëse veprimet e përmbylljes përfshijnë veprime të ndërmarra në lidhje me asetet që ndodhen në një vend të huaj, apo aksionet, instrumentet tjera të pronësisë, të drejtat apo detyrimet rregullohen me ligj të një vendi të huaj, BQK-ja mund t'i kërkojë administratorit, pranuesit apo personit tjetër që ushtron kontrollin në bankën nën procesin e përmbylljes, dhe

pranuesi i merr të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që transferimi, zvogëlimi i vlerës, konvertimi apo veprimi të hyjë në fuqi. BQK-ja nuk vazhdon me transferimin, zvogëlimin e vlerës, konvertimin apo veprimin në qoftë se e konsideron të pamundur që veprimet e tilla të hyjnë në fuqi.

Neni 122

Kompetencat lidhur me vendet e huaja

1. BQK-ja mund t'i njoh dhe t'i zbatojë procedurat e përmbylljes të vendit të huaj në lidhje me një bankë të huaj apo një grupi bankar të huaj. Një vendim i tillë duhet të marrë në konsideratë interesat e klientëve të Republikës së Kosovës, dhe stabilitetit financiar në Republikën e Kosovës.
2. BQK-ja në çdo kohë ka autoritet të ushtrojë kompetencat e përmbylljes në lidhje me asetet e bankave të huaja që ndodhen në Kosovë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e rregulluara nga ligjet e Kosovës. BQK-ja gjithashtu mund të veprojë në lidhje me degët e bankave të huaja në Kosovë.
3. BQK-ja mund të lidhë marrëveshje jo-detyruese të bashkëpunimit me autoritetet relevante të vendeve të treta, në lidhje me shkëmbimin e informacionit për përgatitjen, mirëmbajtjen apo zhvillimin e planeve të përmbylljes, aplikimin e instrumenteve të përmbylljes dhe ushtrimin e kompetencave të përmbylljes.
4. BQK është e autorizuar të përcaktojë më tej kompetencat lidhur me vendet e huaja me rregullore për të arritur objektiva e nenit 100 të këtij Ligji.

Neni 123

Instrumentet qeveritare të qëndrueshmërisë financiare

1. Ministria, në bashkëpunim të ngushtë me BQK-në, mund të vendosë që të ofrojë mbështetje të jashtëzakonshme financiare publike përmes instrumenteve shtesë të qëndrueshmërisë financiare, me qëllim të pjesëmarrjes në përmbylljen të bankës, dhe të përmbushjes së objektivave për përmbyllje.
2. Instrumentet qeveritare të qëndrueshmërisë financiare përdoren si mjeti i fundit pasi të jenë vlerësuar dhe shfrytëzuar instrumentet tjera të përmbylljes deri në masën maksimale praktike duke ruajtur qëndrueshmërinë financiare sipas vlerësimit të Ministrisë pas konsultimit me BQK-në. Në veçanti, Ministria dhe BQK-ja do t'i aplikojnë instrumentet vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 106 të këtij ligji, si dhe pasi të plotësohet njëri nga kushtet e mëposhtme:
 - 2.1. Ministria dhe BQK-ja konstatojnë se aplikimi i instrumenteve të përmbylljes nuk do të mjaftojë për të shmangur një efekt negativ të konsiderueshëm në sistemin financiar;
 - 2.2. Ministria dhe BQK-ja konstatojnë se aplikimi i instrumenteve të përmbylljes nuk do të mjaftojë për të mbrojtur interesin publik, ku ndihma e jashtëzakonshme e likuiditetit i është dhënë më parë bankës nga BQK-ja;

2.3. Në lidhje me instrumentin e përkohshëm të pronësisë publike të përcaktuar në nën -paragrafin 3.2. të këtij neni, Ministria, pas konsultimit me BQK-në, konstaton që aplikimi i instrumenteve të përmbylljes nuk do të mjaftojë për të mbrojtur interesin publik, ku mbështetja e kapitalit publik përmes instrumentit të mbështetjes së kapitalit i është dhënë më parë bankës.

3. Instrumentet e qëndrueshmërisë financiare përbëhen nga si në vijim:

3.1. instrumenti për mbështetjen e kapitalit publik, përmes pjesëmarrjes në rikapitalizimin e një banke duke i dhënë kapitalin bankës në këmbim të instrumenteve që kualifikohen si kapital rregullator.

3.2. instrumenti i përkohshëm i pronësisë publike, për qëllimin e të cilit Ministria i bën një ose më shumë urdhra të transferimit të aksioneve në të cilat pranuesi është ndërmarrje në pronësi të plotë publike.

4. Bankat sipas këtyre instrumenteve menaxhohen në baza komerciale dhe profesionale.

5. Pjesëmarrja publike i transferohet sektorit privat sa më shpejtë që rrethanat komerciale dhe financiare e lejojnë një transferim të tillë.

Neni 124

Fondi Kombëtar i Përmbylljes

1. Fondi Kombëtar i Përmbylljes themelohet me qëllim të zbatimit efektiv të instrumenteve dhe kompetencave të përmbylljes të BQK-së, në përputhje me rregulloren që BQK-ja e nxjerrë për këtë qëllim.

2. Fondi Kombëtar i Përmbylljes përdoret vetëm në pajtim me objektivat e përmbylljes dhe vetëm deri në masën e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të instrumenteve të përmbylljes të përcaktuar në Kapitullin III të këtij ligji.

3. Fondi Kombëtar i Përmbylljes duhet të ketë burime të mjaftueshme financiare dhe do të ketë kompetencën për të mbledhur kontribute nga bankat në baza të detyrueshme.

4. Kontributi i secilës bankë është proporcional me shumën e detyrimeve të saj (duke përjashtuar kapitalin rregullator) pa depozitat e siguruara, në lidhje me gjithsej detyrimet (duke përjashtuar kapitalin rregullator) pa depozitat e siguruara të të gjitha bankave të licencuara në Republikën e Kosovës. Këto kontribute përshtaten në proporcion me profilin e rrezikut të bankave kontribuuese.

KAPITULLI IV LIKUIDIMI

NËNKAPITULLI I LIKUIDIMI

Neni 125 Llojet e likuidimit

1. Banka ose dega e bankës së huaj likuidohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji në dy mënyra:

1.1. likuidimi vullnetar; dhe

1.2. likuidimi.

Neni 126 Likuidimi vullnetar

1. Një bankë nuk mund të përfundojë vullnetarisht veprimtarinë e saj në Republikën e Kosovës pa marrë fillimisht miratimin paraprak nga BQK-ja në përputhje me këtë nen.

2. Likuidimi vullnetar ka efekt kur:

2.1. aksionarët e bankës ose dega e bankës së huaj vendosin që të iniciohet procesi i likuidimit të bankës;

2.2. aksionarët e bankës ose të degës së bankës së huaj, vendosin të ndryshojnë veprimtarinë e bankës ose të degës së bankës së huaj, duke ndërprerë ushtrimin e veprimtarisë bankare.

3. Në rastet sipas paragrafit 2. të këtij neni, banka ose dega e bankës së huaj:

3.1. duhet të njoftojë paraprakisht BQK-në për një vendim të tillë;

3.2. së bashku me vendimin, banka i paraqet BQK-së kërkesën për pëlqimin e kuvendit të bankës për ndërprerjen e veprimtarive të bankës, si dhe një garanci bankare të pakushtëzueshme dhe të pakthyeshme të pagueshme me kërkesën e parë, të lëshuar nga një bankë me shkallë të klasifikimit të investimeve: kapacitet adekuat i pagesës në shumën që garanton mbulimin e të gjitha detyrimeve të bankës nga paragrafi 1. i këtij neni - në favor të BQK-së. BQK-ja gjithashtu mund të kërkojë nga banka dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni.

4. BQK-ja vendosë për kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni, duke marrë një vendim brenda shtatë (7) ditëve nga marrja e kërkesës në formë të kompletuar dhe:

4.1. BQK-ja dorëzon vendimin në bankë jo më vonë se ditën tjetër të punës pas datës së nxjerrjes së tij.

4.2. nëse BQK-ja nuk jep miratimin për likuidim vullnetar për shkak të dështimit të bankës për të paraqitur dokumentacionin në pajtim me këtë nen, ose nuk zbaton këtë ligj udhëzimet e nxjerra nga BQK, atëherë dispozitat e këtij kapitulli të këtij ligji do të zbatohen për emërimin e likuidatorit dhe BQK-ja njëkohësisht do të revokojë licencën e bankës.

4.3. BQK-ja jep miratimin për likuidim vullnetar nëse konstaton se banka ka asete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj, likuidimi kryhet menjëherë dhe të gjithë depozitorët paguhen brenda pesë (5) ditësh nga banka, në përputhje me procedurat që do të lëshohen nga BQK-ja dhe nën mbikëqyrjen e saj.

5. Vendimi për likuidimin vullnetar ka efekt nga dita e nxjerrjes së vendimit dhe dërgohet në Fondin e Sigurimit të Depozitave të Kosovës.

6. Vendimi për likuidimin vullnetar shpallet dhe publikohet nga banka ose dega e bankës së huaj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në dy gazeta kombëtare.

7. Dispozitat e ligjit përkatës për shoqëritë tregtare zbatohen në lidhje me likuidimin vullnetar për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 127

Kriteret për fillimin e likuidimit

1. Në rast të revokimit të licencës së një banke sipas nenit 18 të këtij ligji, ndryshe nga revokimi sipas nën-paragrafit 1.1, dhe paragrafit 2. të nenit 18 të këtij ligji, BQK-ja menjëherë e merr bankën nën posedimin dhe kontrollin e saj përmes një likuidatori të cilin e emëron BQK-ja, nëse ashtu vendoset nga BQK-ja për shkak se objektivat e përmbylljes nuk mund të përmbushen siç parashikohet në nenin 104 të këtij ligji, dhe kjo nuk paragjykon zbatimin e kombinuar të instrumenteve të përmbylljes siç përcaktohet në nenin 105 të këtij ligji. Kjo procedurë do të njihet si Likuidim.

2. Likuidatori mund të jetë një person nga sektori privat ose një zyrtar i BQK-së që plotëson kualifikimet e përcaktuara nga BQK-ja. BQK-ja mund ta shkarkojë likuidatorin. Kushtet për pagesën e likuidatorit caktohet nga BQK-ja dhe mund të përfshijnë stimulimet për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga BQK-ja si dhe mund të përfshijnë edhe gjobat për mospërmbushjen e këtyre objektivave.

3. Pagesa e likuidatorit dhe i ekspertëve që ai ose ajo angazhon, kompensimi i shpenzimeve të tyre dhe i shpenzimeve të BQK-së për zbatimin e kësaj rregulloreje lidhur me një bankë duhet të paguhen nga asetet e bankës. Pagesa e likuidatorit bëhet rregullisht, nëse sipas vlerësimit të likuidatorit ka asete likuide të mjaftueshme. Shuma që likuidatori nuk e ka marrë deri në fund të falimentimit paguhet nga të ardhurat prej shitjes së aseteve të bankës me përparësi të përcaktuara në nenin 135 të këtij ligji.

4. Këto procedura nuk janë të aplikueshme për situatat që bien brenda fushëveprimit të Kapitullit III të këtij ligji, pa paragjykuar aplikimin e tyre ndaj bankave, institucioneve urë apo subjekteve për menaxhimin e aseteve të themeluara sipas nenit 110 të këtij ligji, që mbesin pas aplikimit të instrumenteve dhe përfundimit veprimeve të përmbylljes.

Neni 128 **Njoftimi dhe regjistrimi i likuidimit**

1. Vendimi i BQK-së për emërimin e një likuidatori të bankës hyn në fuqi në datën e nxjerrjes së vendimit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me atë vendim. Likuidatori menjëherë vendosë në çdo zyrë të bankës një njoftim për revokimin e licencës dhe emërimin nga ana e BQK-së, ku specifikohet data dhe koha e hyrjes në fuqi dhe periodha e marrjes në posedim nga likuidatori, duke specifikuar që:

1.1. autorizimet e dhëna personave për përgjegjësinë financiare të bankës janë shfuqizuar;

1.2. autorizimet personat të cilët më parë kishin autorizim për dhënien e udhëzimeve në emër të bankës në lidhje me pagesat ose transferimin e aseteve të bankës apo të aseteve të menaxhuara nga banka janë shfuqizuar;

1.3. licenca e bankës është revokuar.

2. Likuidatori duhet të publikojë një njoftim për specifikimin e masave të ndërmarra në një ose më shumë gazeta me qarkullim të përgjithshëm ku banka ka zyrën dhe vazhdon publikimin e këtij njoftimi çdo javë për katër (4) javë rresht, si dhe informon sipas nevojës autoritetet kompetente dhe i dërgon BQK-së kopje të këtyre masave brenda dy (2) ditësh nga ndërmarrja e tyre.

Neni 129 **Kompetencat dhe detyrat e likuidatorit dhe efektet e likuidimit**

1. Pas emërimit, likuidatori bëhet përfaqësuesi i vetëm ligjor i bankës, dhe trashëgon të gjitha të drejtat dhe kompetencat e aksionarëve dhe të drejtorëve ose menaxherëve të lartë të bankës. Këto të drejta dhe kompetencat përfshijnë mbajtjen e titullarit të librave, shënimeve dhe aseteve të bankës, menaxhimin, qeverisjen dhe përfaqësimin e bankës, renditjen e aseteve dhe kërkesave, transferimin dhe ekspozimin e aseteve, dhe marrjen e masave tjera të nevojshme për likuidim efikas të bankës dhe nxjerrjes së shumës maksimale nga shitja e aseteve, duke përfshirë pa kufizim:

1.1. vazhdimin ose ndërprerjen e çdo operacioni të bankës;

1.2. huazimin e parave të garantuara me asetet e saj ose pa garancion;

1.3. pezullimin ose kufizimin pagesës së borxheve që janë subjekt i miratimit të BQK-së siç parashihet më poshtë;

1.4. punësimin e specialistëve, ekspertëve ose konsulentëve profesional;

- 1.5. administrimin e llogarive të bankës;
 - 1.6. arkëtimin e borxheve për bankën dhe kthimin e mallrave nga palët e treta;
 - 1.7. inicimin ose mbrojtjen e bankës në çdo procedurë dhe zbatimin e çdo instrumenti relevant në emër të bankës, dhe
 - 1.8. ristrukturimin e detyrimeve të bankës përmes marrëveshjeve me kreditorët e bankës, duke përfshirë zvogëlimin, modifikimin, riprogramimin dhe zëvendësimin e kërkesave të tyre deri në shumën e përcaktuar nga BQK-ja.
2. Likuidatori vepron në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e dhëna nga BQK-ja në çdo kohë gjatë likuidimit të detyruar dhe i përgjigjet vetëm BQK-së për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave si likuidator.
 3. Likuidatori nuk mund të pranoj depozita të reja. Likuidatori mund të jap kredi vetëm për klientët ekzistues në përputhje me kushtet e marrëveshjes në fuqi në kohën e emërimit të likuidatorit.
 4. Likuidatori mund të vazhdojë çdo veprimtari përveç atyre të parandaluara sipas paragrafit 3. të këtij neni dhe mund të huazojë para në formë të siguruara ose të pasiguruara. Likuidatori mund të ndërpresë ose të kufizojë pagesën për çdo detyrim, të punësojë ose të pushojë nga puna cilindo zyrtar, punonjës ose këshilltar, të përdorë çdo instrument në emër të bankës dhe të fillojë ose të mbrojë dhe të kryejë në emër të bankës çdo veprim a procedurë ligjore.
 5. Likuidatori ka qasje të pakufizuar për kontrollin e zyrave, librave të llogarive, dhe të shënimeve të tjera si dhe të aseteve tjera të bankës dhe subjekteve të saj të varura. Me kërkesën e likuidatorit, zyrtarët e organeve të rendit duhet të ndihmojnë likuidatorin për të hyrë në objektet e bankës ose të ketë kontrollin e të dhënave të bankës.
 6. BQK-ja miraton ose refuzon bashkimin e bankës me një bankë tjetër ose shitjen substanciale të të gjithë aseteve të bankës, një banke tjetër, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji.
 7. Likuidatori ka të njëjtat të drejta dhe privilegje si dhe i nënshtrohet detyrave, dënimeve, kushteve dhe kufizimeve të njëjta, të zbatueshme për drejtorët, menaxherët e lartë ose punonjësit e tjerë të një banke të licencuar sipas këtij ligji.
 8. Kompetencat e drejtorëve ose menaxherëve të lartë dhe aksionarëve të bankës pezullohen gjatë periudhës së likuidimit. Megjithatë, drejtorët ose menaxherët e lartë të mund të udhëzohen nga likuidatori për të kryer funksionet e specifikuar për bankën, si edhe me kusht që këta persona të mund të shkarkohen nga likuidatori prej detyrave të tyre në bankë dhe për pasojë të mos marrin kompensim nga banka.

9. Likuidatori siguron pronën, zyrat, librat, shënimet dhe asetet e bankës për të parandaluar humbjen e tyre përmes vjedhjes ose veprimeve të tjera të ndaluara, duke ndërmarrë masat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to, siç janë:

9.1. kufizimi i qasjeve për dyert e jashtme dhe dyert e brendshme të zyrave ku ndodhen asetet financiare, informacioni ose pajisjet që lejojnë një person të ketë qasje në mënyrë të paligjshme në asetet financiare;

9.2. ndërrimi ose vendosja e kodeve hyrëse në kompjuterët e bankës dhe dhënien e mundësisë së hyrjes për vetëm një numër të kufizuar të punonjësve të besuar;

9.3. nxjerrja e lejeve të reja foto identifikuese për hyrjen e punonjësve të autorizuar në objektet e bankës dhe kontrollimi i hyrjes së personave të tjerë në hapësirat e bankës;

9.4. shfuqizimi i autorizimeve të personave për mbajtjen e përgjegjësive financiare të bankës dhe dhënia e autorizimeve të reja, sipas rregullit, dhe njoftimin e palëve të treta për këtë;

9.5. informimi i bankave korrespondente, regjistruarëve dhe agjentëve të transferimit të letrave me vlerë, dhe menaxherëve të jashtëm të aseteve të bankës se personat, të cilët më parë ishin të autorizuar për dhënien e udhëzimeve në emër të bankës në lidhje me asetet e bankës, ose asetet e mbajtura në mirëbesim nga banka nuk janë më të autorizuar dhe që vetëm likuidatori dhe personat e autorizuar nga ai kanë këto kompetenca, dhe

9.6. pezullimi i shpërndarjes së kapitalit në përgjithësi dhe pagesave të çdo lloji për drejtorët ose menaxherët e lartë dhe aksionarët kryesorë, me kusht që drejtorëve ose menaxherëve të lartë dhe personelit tjetër të bankës të mund t'iu paguhet kompensim i arsyeshëm për shërbimet e kryera për bankën me kërkesë të likuidatorit.

10. Likuidatori duhet të krijojë një bilanc të ri për bankën, në bazë të vlerësimit të tij rreth vlerave likuiduese të aseteve të bankës me një zvogëlim korrespondues në vlerën e detyrimeve të bankës, me rend të kundërt të përparësisë në pagesën e shpërndarjeve në një likuidim të aseteve të bankës. Detyrimet konsiderohen të maturuara dhe të pagueshme dhe interesi ndërpritet së akumuluar në datën e emërimit të likuidatorit. Detyrimet e pamaturuara diskontohen nga vlera aktuale në masën e interesit të përcaktuar nga BQK-ja.

11. Brenda një (1) muaji nga marrja në posedim e bankës, likuidatori duhet të bëjë inventarizimin e aseteve dhe të pronës së bankës dhe një kopje të inventarit ia dërgon BQK-së, e cila e vë një kopje në dispozicion për shqyrtim nga publiku.

12. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e emërimit, likuidatori mund ta ndërpresë çdo kontratë të papërbushur ose pjesërisht të përbushur, për aq sa përbushja e asaj kontrate përcaktohet të jetë e barrë e rëndë për bankën dhe ndërprerja e saj do të promovonte administrimin e rregullt të çështjeve të bankës dhe mbron interesat e depozitorëve. Çdo detyrim që rrjedh nga kjo ndërprerje përcaktohet që nga data e ndërprerjes dhe kufizohet në dëmet aktuale të drejtpërdrejta të ndodhura dhe nuk përfshinë

asnjë dëm për fitimet e humbura ose dëmet jo monetare. Në rast të ndërprerjes së një kontrate të qirasë për pronën e paluajtshme a të luajtshme, qiradhënësit i jepet një njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditëve.

13. Sa më shpejtë që të jetë e mundur pas datës së emërimit, likuidatori mund të vërë në dispozicion për tërheqje nga depozitarët ose për pagesë të kreditorëve shuma të tilla që, sipas vlerësimit të tij, mund të përdoren brenda rregullit për këtë qëllim me kusht që respektohet përparësia e pagesave në kërkesat e përcaktuara në nenin 135 të këtij ligji dhe të gjithë depozitarët ose kreditorët e tjerë të cilët ndodhen në pozita të njëjta të trajtohen në mënyrë të njëjtë.

Neni 130

Efektet ligjore të marrjes së bankës në posedim nga likuidatori

1. Kur likuidatori e merr bankën në posedim prodhohen këto pasoja juridike sipas fuqisë ligjore:

1.1. ndërpritet çdo afat ligjor, kontraktues ose tjetër, me skadimin e të cilit parashkruhet ose pushon një kërkesë ose e drejtë e bankës, dhe:

1.1.1. llogaritja e interesave dhe dënimeve kundrejt detyrimeve të bankës pezullohen dhe nuk shtohet ndonjë ngarkesë a përgjegjësi për detyrimet e bankës;

1.1.2. të gjitha procedurat ligjore kundër bankës pezullohen dhe ndërpritet çdo e drejtë e mbi asetet e bankës. Asnjë e drejtë nuk mund të ushtrohet mbi asetet gjatë likuidimit të detyruar të bankës, përveç të drejtave që i janë dhënë likuidatorit, dhe asnjë kreditor nuk mund të mbajë, shesë ose marrë në posedim ndonjë aset të bankës si mjet i përmbarimit të kërkesës së tij ose për të iniciuar ose vazhduar ndonjë procedurë ligjore për kthim të borxhit apo plotësim të pjesëmarrjes aksionare në asetet e bankës.

1.2. çdo peng ose e drejtë me sigurim real përveç atyre që datojnë gjashtë (6) muaj para hyrjes në fuqi të vënies nën likuidim, anulohen dhe asnjë peng ose sigurim tjetër real, përveç atij të krijuar nga likuidatori në zbatim të këtij neni, nuk i regjistrohesh apo intabulohet ndonjë aset ose prone e bankës për aq kohë sa zgjatë likuidimi;

1.3. të drejtat e aksionarëve shuhet, përveç së drejtës së marrjes së të hyrave, nëse ka, sipas nenit 135 të këtij ligji, dhe

1.4. likuidatori mund të shesë asetet e bankës ose të bjerë dakord për marrjen përsipër të detyrimeve të bankës në kushte që ai i konsideron të drejta.

2. Procedurat për përcaktimet e vlefshmërisë dhe përparësive të kërkesave dhe për likuidimin e detyruar të aseteve të bankës dhe kthimin e pasurisë klientëve të bankës përcaktohen nga BQK-ja, me kusht që shitja e aseteve të bankës të kryhet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme në pikëpamje tregtare.

3. Asetet e pa shitura të bankës deri në fund të afatit të likuidimit mund të braktisen nga likuidatori ose t'i jepet ndonjë institucioni bamirës që nxitë çështjen e ruajtjes së shëndetit dhe të arsimit publik. Kreditorët e bankës nuk mund të kenë pretendime ndaj këtyre aseteve.

Neni 131

Detyrimet për njoftim dhe raportim

1. Nëse likuidatori ka bazë të arsyeshme të besojë se aksionarët, drejtorët, nëpunësit, avokatët, kontabilistët ose profesionistët tjerë kanë qenë të angazhuar ose janë të angazhuar në veprimtari mashtruese penale, e njofton menjëherë BQK-në dhe ndërmerr veprime ligjore për kërkimin e dëmshpërblimit.

2. Likuidatori raporton çdo muaj në BQK për ecurinë e likuidimit në formën e përcaktuar nga BQK-ja dhe ofron ndonjë informacion tjetër sipas kërkesës së BQK-së.

Neni 132

Veprimet e likuidatorit që kërkojnë miratime shtesë

1. Likuidatori mundet pas miratimit paraprak me shkrim nga BQK-ja dhe sipas instruksioneve të saj, të merret edhe me veprimtaritë e mëposhtme:

1.1. tjetërsojë asetet dhe detyrimet e bankës përmes transaksionit të shitblerjes dhe cedimit; ose

1.2. të riorganizojë ristrukturimin e aseteve dhe detyrimeve të bankës ose të vazhdojë operacionet e papenguara dhe të nevojshme përmes një institucioni urë.

2. Nëse detyrimet e bankës së transferuar në një bankë tjetër menjëherë pas revokimit të licencës së bankës, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, që gjithashtu përfshinë edhe transferimin e depozitave të siguruara, dhe vetëm nëse vlera e pagesës është me e vogël sesa shuma e transferuar e depozitave të siguruara, atëherë ndryshimi deri në shumën e depozitave të siguruara të transferuara në një bankë tjetër, paguhet nga Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës, në përputhje me ligjin përkatës që rregullon sistemin e sigurimit të depozitave, me kusht që kostot për mbështetjen e transferimit të mos e kalojnë shumën neto të kompensimit të depozitarëve të mbuluar nëse banka e dështuar do të ishte likuiduar sipas procedurave të rregullta të likuidimit.

Neni 133

Shmangia dhe anulimi i transfereve para likuidimit të detyruar

1. Likuidatori mund të anulojë një transaksion të bazuar në dokumente mashtruese ose të falsifikuara që banka ka ekzekutuar në dëm të kreditorëve që ka ndodhur brenda pesë (5) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vënies nën likuidim.

2. Likuidatori mund të ngrejë padi në gjykatë që të anulojë transaksionet e mëposhtme, që ndikojnë në asetet e bankës ose të marrë prej palëve të treta transferimet e bëra nga banka, siç janë:

- 2.1. transferet falas ose simbolike të bëra në dobi të Drejtorëve ose Menaxherëve të lartë dhe Aksionarëve kryesorë ose mbajtësve të interesave të konsiderueshëm në bankë ose personave të lidhur me ta, që kanë ndodhur brenda pesë (5) viteve para datës së hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.2. transferet falas ose simbolike të bëra në dobi të palëve të treta që kanë ndodhur brenda tri (3) viteve para hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.3. transaksionet në të cilat vlera e dhënë nga banka tejkalon në mënyrë të konsiderueshme vlerën e pranuar, që kanë ndodhur brenda tri (3) viteve para datës së hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.4. çdo veprim i bërë me qëllim, nga gjithë palët e përfshira në të, për të mbajtur asete nga kreditorët e bankës ose për të minimizuar të drejtat e tyre, që ka ndodhur brenda (5) viteve para datës së hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.5. transferimet e pronës së bankës tek një kreditor ose në dobi të një kreditori për llogari të një borxhi që ka ndodhur brenda (6) muajve para datës së hyrjes në fuqi të likuidimit që ka efektin e rritjes së shumës që kreditori do të merrte me likuidimin e bankës, me kusht që pagesa e depozitës nën shumën e siguruar të depozitave të përcaktuar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës, për depozitor të mos i nënshtrohet kësaj dispozite;
3. Transaksionet me personat e ndërlidhur me bankën të kryera brenda një (1) viti para datës së hyrjes në fuqi të likuidimit, në qoftë se janë të dëmshme ndaj interesave të depozitorëve dhe kreditorëve të tjerë mund të anulohen dhe të rikthehet dëmi nga këta persona.
 4. Një veprim për anulimin e një transferimi mund të ndërmerret nga likuidatori brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e likuidimit.
 5. Pavarësisht nga paragrafët më lartë, likuidatori mund të mos anulojë një pagesë ose transferim nga banka, në qoftë se është kryer në rrjedhën e zakonshme të veprimtarive të bankës, ose në qoftë se ka qenë pjesë e një këmbimi të njëkohshëm për vlerë të arsyeshme dhe të barabartë ose në atë masë që pas transferimit, pranuesi i ka dhënë një kredi të re, të pasiguruar, bankës e cila nuk ishte e përmbushur që nga data e efektshme e likuidimit.
 6. Likuidatori mund të rikthej pronën ose vlerën e pronës së transferuar nga banka te një person i parë i cili më pas ka transferuar pronën tek një personi i dytë, vetëm në qoftë se personi i dytë nuk e ka dhënë vlerën reale të pronës.
 7. Likuidatori mund të urdhërojë që njoftimi për inicimin e procedurës ligjore të anulimit të një transferimi të regjistrohët në regjistrin publik kadastral mbi pronë ne paluajtshme dhe çdo të drejtë tjetër mbi pronë të regjistruar në regjistra publik, dhe personi që fiton të drejtë sendore ndaj kësaj prone ose krijon sigurim real a interes tjetër mbi këtë pronë, pas një njoftimi të tillë, atëherë realizimi i kësaj të drejte sendore ose sigurimi real varet nga e drejta e bankës për ta rikthyer atë pronë.

8. Qiradhënësi i objekteve të bankës ose ndërmarrja e ofrimit të shërbimeve publike apo ndonjë ofruer tjetër i shërbimeve komunale, duke përfshirë pa kufizim një ndërmarrje që furnizon energji elektrike, gaz natyror, ujë ose shërbime të telefonisë, nuk mund të ndryshojë, refuzojë ose ndërpresë këto shërbime për një bankë për shkak të vënies së saj nën likuidim ose për shkak se banka nuk i ka paguar për shërbimet para kohës së vendosjes së saj në likuidim, me kusht që, me kërkesën e qiradhënësit të lokaleve të bankës ose ndërmarrjes së ofrimit të shërbimeve publike, banka duhet të vendosë një depozitë sigurimi në një bankë, si kusht ndaj detyrimit që qiradhënësi i lokaleve të bankës ose ndërmarrja e ofrimit të shërbimeve publike të vazhdojnë ofrimin e shërbimeve edhe gjatë likuidimit, dhe kjo depozitë nuk kërkohet të jetë më e madhe se kostoja e shërbimeve të kryera për bankën gjatë muajit paraprak para hyrjes në fuqi të likuidimit.

Neni 134

Përfshirjet nga anulimi i transfereve para likuidimit të detyruar

1. Pavarësisht nenit 133 të këtij ligji, transferet e më poshtë nuk anulohen para vendosjes në likuidim të detyruar:

1.1. urdhërpagesat e parevokueshme të parave dhe letrave me vlerë, të bëra nga një bankë në sistemin e pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë e njohur si e këtillë nga BQK-ja, ligjërisht të zbatueshme dhe detyruese për palët e treta, edhe pas vendimit për revokim të licencës së bankës dhe emërimit të likuidatorit por vetëm nëse urdhëresat për transferim bëhen të revokueshme para se një vendim i tillë të hyjë në fuqi, ose

1.2. kur banka ka dhënë urdhra për transfere të parevokueshme të parave dhe urdhër transfere të letrave me vlerë përmes sistemit të pagesave ose sistemit të shlyerjes së letrave me vlerë, pas hyrjes në fuqi të vendimit për revokim të licencës dhe emërim të likuidatorit, dhe urdhëresat për transferime zbatohen në ditën e marrjes së atij vendimi, urdhëresat për transferim janë ligjërisht të zbatueshme dhe janë detyruese për palët e treta, përveç nëse likuidatori dëshmon se operatori i sistemit ka qenë në dijeni të vendimit para se urdhëresat për transfere të bëhen të pakthyeshme.

2. Asnjë ligj, rregullore ose praktikë për të anuluar kontratat dhe transaksionet e emetuara ose të miratuara para hyrjes në fuqi të vendimit për revokim të licencës së bankës dhe emërimit të likuidatorit nuk do të çojë në zgjidhjen e netimit nga sistemi i pagesave ose të shlyerjes së letrave me vlerë e njohur si i tillë nga BQK-ja për shkak të atij vendimi.

3. Për qëllimet e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, një urdhëresë për transfer e futur në sistemin e pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë bëhet e parevokueshme kohën e përcaktuar me rregulloret për atë sistem.

4. Pavarësisht nga ky ligj, asnjë vendim i marrë sipas këtij ligji nuk parandalon ose pengon shuarjen e detyrimeve me kompensim sipas ligjit përkatës për marrëdhëniet detyrimore ndërmjet bankës që është subjekt i procedurës së likuidimit sipas këtij kapitulli dhe palës tjetër.

5. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet bankës dhe palëve tjera kontraktuese të saj, duhet të merren parasysh dispozitat e shkëputjes së kontratave të pranueshme financiare ndërmjet tyre. Vlera neto e shkëputjes, e përcaktuar në përputhje me kontratën e pranueshme financiare ndërmjet tyre paraqet kërkesën e bankës ndaj palës tjetër ose pranohet pas miratimit të kërkesës së palës tjetër nga banka. Për qëllime të këtij paragrafi, kontratat e pranueshme financiare janë:

- 5.1. kontrata e kundërkëmbimit të valutës ose normës së interesit;
- 5.2. kontrata e kundërkëmbimit bazë;
- 5.3. kontrata e kundërkëmbimit aktuale (spot), e së ardhmes, me pajtim paraprak apo kontratë tjetër e këmbimit valutor;
- 5.4. kontrata që ofron kufizime të llojit “collar, floor” në transaksion;
- 5.5. kontratë kundërkëmbimi të mallrave;
- 5.6. kontratë valide e normës së interesit;
- 5.7. marrëveshje e riblerjes ose marrëveshje e anasjelltë e riblerjes;
- 5.8. kontrata aktuale (spot), e së ardhmes, me pajtim paraprak apo kontratë tjetër në mallra;
- 5.9. një kontratë për të blerë, shitur, huazuar apo të jap hua letrat me vlerë me qëllim që të shlyej transaksionet e letrave me vlerë apo të veprojë si kujdestar për letra me vlerë;
- 5.10. çdo kontratë të derivativëve apo opsioneve;
- 5.11. çdo kontratë kryesore – kontratë master;
- 5.12. një garanci e detyrimeve sipas kontratës me shkrim, dhe
- 5.13. çdo kontratë e çfarëdo lloji të përcaktuar me rregullore të BQK-së.

6. Përveç asaj që përfshihet në paragrafin 5. dhe sipas paragrafit 7. të këtij neni, asnjë kundërvlerë nuk lejohet në lidhje me kërkesat ndaj bankës pas hyrjes në fuqi të vendimit për revokim të licencës dhe emërim të likuidatorit ose brenda (3) muajve para një vendimi të këtillë.

7. Kërkesat ndaj bankës që rrjedhin nga depozitat kompensohen kundrejt çdo shume të cilën depozituesi i detyrohet bankës, që nga data kur është revokuar licenca dhe është emëruar likuidatori, si në vijim:

- 7.1. automatikisht nëse ajo shumë maturon ose është në vonesë, ose

7.2. nëse depozitori zgjedh kështu, edhe nëse shuma nuk ka maturuar ose nuk është në vonesë.

Neni 135 **Prioritetet në pagesën e kërkesave**

1. Në çdo likuidim të aseteve të bankës, kërkesat paguhen sipas hierarkisë të kategorive të përcaktuar si më poshtë:

1.1. kërkesat e siguruara deri në shumën e kolateralit të tyre, duke zbritur çdo kosto të arsyeshme të shitjes;

1.2. kreditë që i janë dhënë bankës nga BQK-ja deri në emërimin e likuidatorit apo detyrimet tjera të bankës të krijuara gjatë administrimit zyrtar apo procesit të likuidimit;

1.3. shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme, të bëra nga likuidatori dhe BQK-ja, përfshirë tarifat për shërbime profesionale në zbatimin e dispozitave të neneve të likuidimit të këtij ligji;

1.4. kërkesat nga Fondit për sigurimin e depozitave të Kosovës për depozitorët e siguruar;

1.5. kreditë që i janë dhënë bankës pas emërimit të likuidatorit;

1.6. kërkesat për depozitat e pasiguruara;

1.7. kreditë e pa siguruara që i janë dhënë bankës para emërimit të likuidatorit; dhe

1.8. kërkesat e kreditorëve për borxhin e varur / të subordinuar.

2. Nëse shuma e vënë në dispozicion për pagesa për çdo kategori të kërkesave nuk është e mjaftueshme për të bërë pagesën në tërësi, kërkesat zvogëlohen në proporcione të njëjta.

3. Pas pagesës së të gjitha pretendimeve të paraqitura, asnjë kërkesë e lejueshme që nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar me ligj ose akt nënligjor për dorëzimin e tyre nuk paguhet. Pasi paguhen të gjitha kërkesat e depozitorëve dhe kreditorëve të tjerë, të ardhurat që mbeten u shpërndahen aksionarëve të bankës sipas të drejtave të tyre.

4. Për qëllim të nën-paragrafit 1.4. të këtij neni:

4.1. depozitat nga personat fizik dhe personat juridik që tejkalojnë nivelin e mbulueshmërisë të përcaktuar sipas ligjit përkatës mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë, duhet të kenë të njëjtin prioritet në renditje të hierarkisë, që është më i lartë se renditja e dhënë për kërkesat e kreditorëve të zakonshëm të pasiguar, jopreferencial;

4.2. depozitat e siguruara dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës që zëvendësojnë të drejtat dhe obligimet e depozitorëve të siguruar në likuidim kanë të njëjtin prioritet të renditjes në hierarki, që është më i lartë se sa renditja në nën-paragrafin 4.1. të këtij neni.

Neni 136 **Raportimi përfundimtar në BQK**

Pasi të bëhet shpërndarja e të ardhurave nga shitja e aseteve të bankës, likuidatori i paraqet një raport BQK-së, që përfshin një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe burimet dhe shfrytëzimet e fondeve gjatë periudhës së likuidimit. Pas miratimit të këtij raporti nga BQK-ja, likuidimi nga BQK-ja përfundon, me ç'rast BQK-ja dhe likuidatori lirohen nga çdo përgjegjësi e mëtutjeshme në lidhje me likuidimin e një banke.

Neni 137 **Dispozitat e ndryshme të likuidimit**

1. Punonjësit profesionist, të caktuar për të përfaqësuar ose ndihmuar një likuidator ose BQK-në në lidhje me një likuidim nuk duhet të paguhen në shuma më të mëdha se sa paguhen punonjësit ose agjentët e bankave për shërbime të ngjashme, përveç kur BQK-ja mund të autorizojë pagesa në shuma më të larta, nëse BQK-ja konsideron se është e nevojshme të paguhen shuma më të larta në mënyrë që të punësohet dhe mbahet personeli i nevojshëm.

2. BQK-ja ka kompetencë të kompensojë një likuidator dhe agjentët e tij për punën e tyre që e kanë kryer sipas kushteve që BQK-ja i konsideron të përshtatshme.

NËNKAPITULLI II **DISPOZITA TË TJERA**

Neni 138 **Raporti me ligjet tjera**

1. Të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me qeverisjen korporative dhe pronësinë e shoqërive aksionare të përfshira në ligjin përkatës për shoqëritë tregtare që nuk bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, zbatohen për bankat. Ky ligj do të mbizotërojë në çdo çështje që lidhet me bankat.

2. Çështjet të cilat lidhen me mbrojtjen e konsumatorit dhe klientit që nuk janë të rregulluara me këtë ligj i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi që rregullon mbrojtjen e konsumatorit.

3. Dispozitat e ligjit përkatës për falimentimin zbatohen në lidhje me likuidimin deri në masën që nuk bie ndesh me këtë Ligj.

4. Dispozitat e ligjit përkatës për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim zbatohen në lidhje me auditimin deri në masën që nuk bie ndesh me këtë ligj.

5. Dispozitat e ligjit për lizingun zbatohen në lidhje me lizingun deri në masën që nuk bie ndesh me këtë Ligj.

Neni 139

Parandalimi i shpërlarjes së parave

1. Një bankë ose institucion financiar nuk duhet të fsheh, këmbëj ose transferojë paratë e gatshme ose prona, nëse ka ditur ose është dashur të dijë se paratë e gatshme ose prona rrjedh nga veprimtaria penale, ose ndihmon dhe mbështet ndonjë person në fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të ndonjë paraje të gatshme ose prone.

2. Bankat dhe institucionet financiare veprojnë në përputhje me ligjin përkatës për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Banka Qendrore e Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare zhvillojnë marrëdhënie bashkëpunimi në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

3. Bankat duhet të garantojnë, që çdo palë e tretë apo agjent bankar që veprojnë në emër të tyre, janë duke vepruar në pajtueshmëri me legjisllacionin në fuqi për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

Neni 140

Tarifat

1. BQK-ja mund të caktojë tarifa për procedimin e një kërkesë për licencë ose autorizim, lëshimin e licencës ose autorizimit dhe për posedimin e licencës ose autorizimit. Të gjitha tarifat janë të pa rimbursueshme.

2. BQK-ja cakton tarifa për bankat dhe institucionet financiare për shërbimet rregullative dhe të mbikëqyrjes në mënyrë që të mbulohen shpenzimet të drejtpërdrejta apo të tërthorta të realizuara për kryerjen e këtyre shërbimeve. Tarifat ndaj bankave llogariten në bazë të shumës së aktivës të tyre ose në bazë të shpenzimeve të jashtëzakonshme të bëra nga BQK-ja apo nga agjentët e saj në lidhje me veprimtaritë mbikëqyrëse rreth një banke të caktuar. Bankat duhet të paguajnë këto tarifa brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e paraqitjes së deklaratës nga BQK-ja.

3. BQK mund të rregullojë më tutje tarifat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni me akt nënligjor.

Neni 141

Regjistri kreditor

1. Regjistri i Kredive i themeluar nga BQK, shërben për mbledhjen dhe ofrimin e informacionit për të ndihmuar në zvogëlimin e rrezikut të huadhënies dhe për të përmirësuar qasjen në kredi duke siguruar mbrojtjen maksimale të të dhënave personale. Raportimi i kredive është i detyrueshëm për të gjitha institucionet financiare kredidhënëse që veprojnë në Kosovë.

2. Të gjitha institucionet financiare kredidhënëse siç janë definuara dhe përcaktuara në bazë të ligjit dhe rregulloreve të BQK-së duhet të jenë anëtarë të Regjistrit të Kredive.
3. Të gjithë anëtarët e Regjistrit të Kredive janë të obliguar të raportojnë në Regjistrin e Kredive gjithë informacionin e përcaktuar nga BQK-ja në lidhje me informacionin, mënyrën dhe afatet kohore të raportimit.
4. Bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të kenë të drejtë të kërkojnë dhe të përdorin informacionin e ruajtur në Regjistrin e Kredive, sipas mënyrës së përcaktuar nga BQK.
5. Mbrojtja e të dhënave dhe përdorimi i informacioneve nga Regjistri i Kredive duhet të bëhet në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen dhe procesimin e të dhënave personale, si dhe të instrumenteve rregullative të lëshuara nga BQK.
6. Bankat apo degët e bankave të huaja duhet të shkëmbejnë informacione në lidhje me kreditë e lëshuara ndaj klientëve të tyre në pajtim me marrëveshjet midis tyre dhe në pajtueshmëri me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.
7. BQK mund të detyrojë subjektet tjera të cilat i mbikëqyrë, të raportojnë për qëllime të regjistrit të Kredive, në pajtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 142 **Sekreti bankar**

1. Sekreti bankar nënkupton detyrimin e një banke për të mbrojtur konfidencialitetin e të gjitha informacioneve, fakteve dhe rrethanave për të cilat njoftohet gjatë ofrimit të shërbimeve për klientët ose gjatë afarizmit me klientë të veçantë. Bankat janë të detyruar nga obligimi i sekretit bankar.
2. Për qëllim të këtij ligji, klientë të një banke janë të gjithë personat që kanë kërkuar ose pranuar shërbime bankare dhe / ose financiare nga banka.
3. Anëtarët e organeve të bankës, aksionarët ose punonjësit e saj dhe personat e tjerë, të cilët për shkak të natyrës së biznesit të tyre me ose për bankën kanë qasje në informacione konfidenciale, janë të detyruar nga obligimi i sekretit bankar. Këta nuk duhet të ndajnë informacione konfidenciale mepalët e treta, t'i përdorin ato kundër interesave të bankës ose klientëve të saj, ose t'u lejojnë palëve të treta ta shfrytëzojnë atë informatë.
4. Personat të referuar në paragrafin 3. të këtij neni janë të detyruar nga obligimi i sekretit bankar edhe pas përfundimit të punës së tyre në bankë ose pas përfundimit të statusit të tyre të aksionarëve ose anëtarësimit në organet e bankës, si dhe pas përfundimit të kontratës së tyre për kryerjen e veprimtarive për bankën.
5. Obligimi i bankës për sekretin bankar nuk përfshinë rastet e mëposhtme:
 - 5.1. kur klienti në mënyrë të qartë pajtohet me shkrim që disa informacione konfidenciale mund të shpalosen;

5.2. ku kjo i mundëson bankës të realizojë interesin e saj kur ushtron shitjen e të arkëtueshmeve të klientit;

5.3. kur informacioni konfidencial i shpaloset BQK-së ose një autoriteti tjetër mbikëqyrës për qëllime të mbikëqyrjes brenda kompetencave të tyre;

5.4. ku informacioni konfidencial shkëmbehet brenda një grupi bankar me qëllim të menaxhimit të rrezikut;

5.5. kur informacioni konfidencial i shpaloset një personi juridik të krijuar në bazë të një Ligji të veçantë për të mbledhur dhe shpërndarë informacione mbi besueshmërinë e kreditimit ndaj personave juridikë dhe fizikë;

5.6. kur informacioni konfidencial për klientët që nuk kanë paguar detyrimet e tyre, i shpaloset një personi juridik që mbledhë dhe shpërndanë informacione të tilla ndërmjet institucioneve të kredidhënëse dhe / ose financiare;

5.7. kur shpalosja e informacionit konfidencial është thelbësore për mbledhjen dhe vërtetimin e fakteve në procedurë penale ose parapenale, kur kërkohet ose urdhërohet me shkrim nga gjykata kompetente ose organet e ndjekjes;

5.8. kur shpalosja e informacionit konfidencial është e nevojshme për të kryer procedurat e përmbarrimit ose likuidimit mbi pronën e një klienti, procedurat e trashëgimisë ose procedurat e tjera të të drejtave të pronës, dhe një shpalosje e tillë kërkohet me shkrim nga gjykata kompetente, përmbarruesi privat ose noteri publik në rrjedhë të kryerjes së funksioneve që iu janë besuar në bazë të ligjit;

5.9. kur interesat ose obligimet e një banke ose klientit të saj kërkojnë shpalosjen e informacionit konfidencial për të vendosur marrëdhënien juridike ndërmjet bankës dhe klientit në procedurat gjyqësore, procedurat e arbitrazhit ose procedurat e ndërmjetësimit;

5.10. ku informacioni konfidencial i shpaloset Njësisë së Inteligjencës Financiare në përputhje me ligjin përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;

5.11. ku informacioni konfidencial i shpaloset Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me ligjin që rregullon deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave;

5.12. kur informacioni konfidencial kërkohet nga autoritetet tatimore në procedurat e kryera brenda kompetencave të tyre sipas ligjit, dhe shpaloset me kërkesën e tyre me shkrim;

5.13. ku informacioni konfidencial i shpaloset institucionit përgjegjës për sigurimin e depozitave në bazë të ligjit përkatës për sigurimin e depozitave;

5.14. kur gjendja e llogarisë pasqyron paaftësinë për të kryer pagesa dhe certifikata kërkohet të vërtetohet ekzistencën e bazës së likuidimit;

5.15. shpalosja e informacionit për subjektet e sigurimeve brenda procedurës së sigurimit të të arkëtueshmeve të bankës;

5.16. shpalosja e informacionit gjatë përmbylljes së aranzhmaneve juridike që kanë efektin e sigurimit të arkëtimit të bankës, siç janë instrumentet e kredisë derivative, garancitë bankare dhe aranzhimet e ngjashme;

5.17. shpalosja e informacionit, në varësi të pëlqimit me shkrim të bordit drejtues të bankës, për një zotërues të një interesi të kualifikuar në bankë, një personi që synon të përvetësojë një interes të kualifikuar në bankë, një personi të cilit banka i është bashkuar përmes përvetësimit ose me të cilët banka bashkohet me formimin e një banke të re, me një person juridik që synon të marrë përsipër atë bankë, si dhe me auditorët, ekspertët juridikë dhe të tjerë të autorizuar nga një zotërues i një interesi të kualifikuar ose nga një zotërues i mundshëm;

5.18. shpalosja e informacionit të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarive të bankës që janë subjekt i kontraktimit nga nga jashtë, kur informacioni iu shpaloset ofruesve të veprimtarive të angazhimit nga jashtë;

5.19. kur një bankë e cila ofron shërbime të ruajtjes dhe menaxhimit të instrumenteve financiare për llogari të klientëve, përfshirë shërbimet e kujdestarisë, shpalosë informacione për mbajtësin e letrave me vlerë tek një institucion kredidhënës i cili është emetuesi i këtyre letrave me vlerë jo materiale me kërkesën e tij;

5.20. kur informacioni konfidencial u shpaloset qendrave të mirëqenies sociale me kërkesën e tyre me shkrim, në kuadër të kompetencave të tyre sipas ligjit me qëllim të marrjes së masave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (personat nën 18 vjeç) dhe personave nën kujdestari;

5.21. kur kërkohet me shkrim nga Avokatura Shtetërore me qëllim të zhvillimit të procedurave gjyqësore;

5.22. kur informacioni konfidencial i shpaloset një bashkë-huamarrësi, pengdhënësi, garantuesi ose një pjesëmarrësi tjetër në marrëdhënien kreditore, dhe vetëm informacionet mbi atë marrëdhënie kreditore;

5.23. kur informacioni konfidencial shpaloset me kërkesë me shkrim një personi që ka paguar gabimisht fonde në një llogari të klientit të një institucioni kreditor, dhe vetëm informacionet e nevojshme për të filluar procedurat gjyqësore për shlyerjen e fondeve të paguara gabimisht, dhe

5.24. nëse parashikohet me ligje të tjera.

6. Shpalosja e informacionit konfidencial nuk konsiderohet se përfshinë:

6.1. shpalosjen e informacionit në formë kolektive, në mënyrë që të dhënat personale ose të biznesit për një klient të mos mund të identifikohen, dhe

6.2. shpalosjen i informacionit publik nga regjistri i unifikuar i llogarive.

7. Institucioni kredidhënës siguron që kur lidh kontratë individuale për ofrimin e shërbimeve bankare dhe / ose financiare, të ekzistoj një dokument i veçantë me shkrim ku klienti jep pëlqim për shpalosje të informacionit sipas nën-paragrafit 5.1. të këtij neni.

8. Kur informacioni konfidencial shpaloset në bazë të një dokumentime shkrim të klientit të referuar në nën-paragrafi 5.1., të këtij neni ose në përputhje me nën-paragrafin 5.6. të këtij neni, banka siguron që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

8.1. informacioni që shpaloset është i saktë, i plotë dhe i përditësuar;

8.2. klientit i ofrohet qasje në informacionet e tij që shpaloset;

8.3. shpalosja e informacionit në këtë mënyrë është në proporcion me nevojën dhe qëllimin për të cilin po shpaloset; dhe

8.4. informacioni i pranuar në këtë mënyrë mbahet për një periudhë jo më të gjatë se sa që është e nevojshme për qëllimin për të cilin po shpaloset.

9. BQK-ja mund të miratojë aktet nënligjore shtesë për të rregulluar më tej kushtet e zbatimit të rregulluara me këtë nen.

Neni 143

Përdorimi dhe mbrojtja e informacionit konfidencial

1. BQK-ja, gjykatat, autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe personat e tjerë të përmendur në këtë ligj, do të përdorin informacionin konfidencial që kanë marrë në bazë të të njëjtit nen, ekskluzivisht për qëllimin për të cilin është dhënë dhe nuk mund t'i shpërndajnë apo zbulojnë ato te palët e treta ose mundësojnë që palët e treta të marrin dhe përdorin informacionin e tillë, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

2. Dispozitat nga paragrafi 1. i këtij neni do të aplikohen ndaj të gjithë personave fizik të cilët punojnë ose kanë punuar në BQK, gjykata, autoritetet e tjera mbikëqyrëse apo personat tjerë të përmendur në këtë ligj në cilësinë e punonjësve apo cilësi tjera.

Neni 144

Bashkëpunimi me autoritetet tjera

1. BQK mund të shkëmbejë informacione për çështjet e mbikëqyrjes me autoritetet tjera të mbikëqyrjes financiare në Kosovë dhe të shteteve tjera. Shkëmbimi i informacionit mund të përfshijë informatat konfidenciale, me kusht që BQK të ketë vlerësuar që informacioni do të përdoret për qëllime mbikëqyrëse dhe do të jetë subjekt i trajtimit të konfidencialitetit i ngjashëm me atë që BQK-ja do të kërkohej të zbatohet.

2. Për të lehtësuar përmbushjen e përgjegjësive mbikëqyrëse, BQK-ja mund të hyjë në memorandume të mirëkuptimit me autoritetet tjera të mbikëqyrjes financiare në lidhje me bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë, që mund të përfshijë çështjet për të cilat janë pajtuar BQK-ja dhe autoritetit tjetër të mbikëqyrjes financiare në lidhje me shkëmbim të informacionit dhe format tjera të bashkëpunimit dhe ndihmës.

3. BQK do të bashkëpunojë me Autoritetit Bankar Evropian në lidhje me mbikëqyrjen e bankave, dhe do t'i dërgojë autoritetit në fjalë të gjitha informacionet e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj, në përputhje me memorandumun e mirëkuptimit ose marrëveshjeve të tjera të ngjashme.

Neni 145

Shqyrtimet gjyqësore

1. Dispozitat e ligjit përkatës për konfliktet administrative zbatohet ndaj vendimeve të nxjerra nga BQK-ja, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Ligj.

2. Urdhrat dhe vendimet përfundimtare të BQK-së ose agjentëve të saj, përfshirë çdo administrator zyrtar të emëruar nga BQK-ja, menaxher special ose likuidator, sipas këtij ligji, i nënshtrohen konfliktit administrative në gjykatë në përputhje me ligjin përkatës për BQK.

3. Kërkesat e ligjit përkatës për BQK për zhdëmtimin e anëtarëve të organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore ose personelit të saj apo të një agjenti të Bankës Qendrore, mbulojnë edhe shpenzimet e përfaqësimit në një procedurë gjyqësore të inicuar kundër këtij personi në lidhje me kryerjen ose kryerjen e supozuar të detyrave zyrtare në kuadër të fushëveprimit të punësimit të tyre ose angazhimit sipas këtij ligji.

4. Parashtrimi i një padie nga paragrafi 2. i këtij neni nuk obligon pezullim automatik të pasojave ligjore të vendimeve të kundërshtuara të marra sipas të këtij ligji. Vendimet e BQK-së, si autoritet i përmbylljes, janë menjëherë të zbatueshme dhe çdo kundërshtim për pezullim të zbatimit të tij do të ishte në kundërshtim me interesin publik.

5. Kur është e nevojshme të mbrohen interesat e palëve të treta, që veprojnë në mirëbesim, të cilët kanë fituar aksione, instrumente të tjera të pronësisë, asete, të drejta ose detyrime të një banke gjatë përmbylljes së një banke për shkak të përdorimit të instrumenteve të përmbylljes ose ushtrimit të kompetencave të përmbylljes nga BQK-ja, si autoritet i përmbylljes, në bazë të Kapitullit të III të këtij ligji, anulimi i një vendimi të BQK-së nuk do të ndikojë në asnjë veprim apo transaksion administrativ të mëvonshëm të vendosur nga BQK-ja, të cilat ishin bazuar në vendimin e anuluar. Në atë rast, mjetet juridike për një vendim ose veprim të gabuar nga BQK-ja kufizohen në kompensimin e humbjes së pësuar nga aplikanti si rezultat i vendimit ose veprimit.

Neni 146

E drejta për mjete juridike

Vetëm subjekti i mbikëqyrjes mund të paraqesë ankesë ndaj akteve të nxjerra nga BQK-ja, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

NËNKAPITULLI III DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 147 Dispozitat kalimtare

1. Bankat dhe degët e bankave të huaja që kanë licencë për operim me hyrjen në fuqi të këtij ligji kanë afat përshtatjeje me kërkesat e këtij ligji brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, përshtatja e degëve të bankave të huaja me kërkesat e paragrafit 5., 6. dhe 7. të nenit 29 të këtij ligji kanë afat përshtatje brenda tre (3) viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Aktet nënligjore të nxjerra nga BQK-ja mbi licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen bankave, mbeten në fuqi deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore dhe me kusht që të mos bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 148 Licencat dhe regjistrimet në fuqi

Licencat dhe regjistrimet e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij Ligji mbesin në fuqi.

Neni 149 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Kreu I i Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, sa i përket Bankave.

Neni 150 Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-304
5 dhjetor 2024**

Shpallur me dekretin Nr. DL-16/2026, datë 20.01.2026 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu